



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLES SE PARE
PER KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
2025

Nr. Rendor	Data e regjistrimit të kërkesës	Objekti	Data e kthimit të përgjigjes	Përgjigje	Statusi i kërkesës	Tarifa
1.	07.01.2024	Kërkesë për vënie në dispozicion të një kopje të vendimit nr. 36, datë 29.03.2021.	08.01.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 1, datë 07.01.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, bashkëlidhur këtij emaili po ju dërgojmë vendimin nr. 36, datë 29.03.2021 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kundër subjektit S.Ç alias M.L, me persona të tretë P.Ç dhe M.Ç. Ju sjellim në vëmendje respektimin e: - Dispozitave ligjore të parashikuara nga Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i	Perfunduar (E-mail)	Nuk ka

				ndryshuar, konkretisht: Nenin 2 dhe nenin 11. - Udhëzimit Nr. 9, datë 15.09.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale <i>“Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audio vizive”</i>, konkretisht: Kreun I, pika 2, pika 3 dhe pika 11; Kreun III, pika 5. - Udhëzimit Nr. 31, datë 27.12.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale <i>“Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për përjashtimin nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike”</i>, konkretisht: Nenin 4, pika 5.		
2.	16.01.2025	Kërkesë për vënie në dispozicion të dokumenteve/informacioneve të mëposhtme: Në bazë të njoftimit të SPAK më datë 6 Janar 2025, pas përfundimit të aktivitetit hetimor në kuadër të procedimit penal Nr. 5, viti 2023, dhe pas një hetimi dyvjeçar ndaj 113 (njëqind e trembëdhjetë) personave, përfshirë 95 gra dhe vajza, Prokuroria e Posaçme ka	21.01.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 2, datë 16.01.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, <i>“Për të drejtën e informimit”</i>, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Me datë 06.01.2025 SPAK ka publikuar në faqen zyrtare të web-it njoftimin si më poshtë vijon: <i>“Në përfundim të aktivitetit hetimor në kuadër të procedimit penal Nr. 5, viti 2023, dhe pas një hetimi dyvjeçar ndaj 113 (njëqind e trembëdhjetë) personave, përfshirë 95 gra dhe vajza, Prokuroria e</i>	Përfunduar Deleguar pranë SPAK (E-mail)	Nuk ka

		ndarë aktet hetimore. Për 93 prej këtyre grave dhe vajzave është shpallur moskompetenca lëndore për hetim dhe gjykim, duke dërguar aktet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, ku janë kryer veprat penale. 1. Ju lutem na vendosni në dispozicion aktet e dërguara në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm. 2. Në cilat argumente mbështetet SPAK për të shpallur moskompetencën për hetim dhe gjykim të 93 grave dhe vajzave?		<i>Posaçme ka ndarë aktet hetimore. Për 93 prej këtyre grave dhe vajzave është shpallur moskompetenca lëndore për hetim dhe gjykim, duke dërguar aktet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, ku janë kryer veprat penale, etj... ”.</i> Në përgjigje të dy pyetjeve tuaja, ku ju kërkon që t’ju vihen në dispozicion aktet e dërguara në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në cilat argumente mbështetet SPAK për të shpallur moskompetencën për hetim dhe gjykim të 93 grave dhe vajzave, ju bëjmë me dije se: Së pari, në kushtet që, organi i Prokurorisë, SPAK ka shpallur moskompetencën lëndore për hetim dhe gjykim, për 93 prej grave dhe vajzave, lidhur me procedimin penal Nr. 5, të vitit 2023, aktet janë dërguar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm. Këto akte nuk janë depozituar në asnjë moment pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, që do të thotë se kjo gjykatë nuk i disponon aktet e kërkuara nga ana juaj. Së dyti, sa i përket argumenteve në të cilat mbështetet SPAK për të shpallur moskompetencën për hetim dhe gjykim të	
--	--	---	--	---	--

				93 grave dhe vajzave, në kushtet që shpallja e moskompetencës është bërë nga organi i Prokurorisë, ju duhet t'i drejtoheni autoritetit publik kompetent që ka shpallur moskompetencën, në rastin konkret Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Spak. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk është organi kompetent për të argumentuar arsyet, në të cilat është mbështetur SPAK për të shpallur moskompetencën lëndore për hetim dhe gjykim, për 93 prej grave dhe vajzave, lidhur me procedimin penal Nr. 5, të vitit 2023. Në zbatim të nenit 12, pika 2 të ligjit nr.119/2014, <i>“Për të drejtën e informimit”</i>, i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se: <i>“Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuar. Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar”</i>, ju informojmë se, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk e zotëron informacionin e kërkuar nga ana juaj dhe për këtë arsye, kërkesa juaj për informacion do i		
--	--	--	--	---	--	--

				dërgohet ditën e sotme autoritetit publik kompetent, konkretisht Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Po ashtu, në referim të nenit 12, pika 3 të ligjit nr.119/2014, <i>“Për të drejtën e informimit”</i>, i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se: <i>“Autoriteti publik, të cilit i është drejtuar kërkesa për informim, njofton kërkuar se kërkesa e tij i është dërguar një autoriteti tjetër, si dhe e informon atë për kontaktet e autoritetit ku është dërguar kërkesa.”</i>, po ju dërgojmë email-in e kontaktit të publikuar në faqen zyrtare të SPAK, në web: Info@spak.gov.al si dhe adresën e institucionit: Rruga “Jordan Misja”, Nr. 1, Tiranë 1000, Shqipëri.		
3.	21.01.2025	Kërkesë për informacion mbi dokumente apo vendime gjyqësore që lidhen me trafikimin e drogës dhe pastrimin e parave, për qëllime akademike dhe kërkimi.	27.01.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 3, datë 21.01.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, <i>“Për të drejtën e informimit”</i>, i ndryshuar, bashkëlidhur këtij email-i po ju dërgojmë: • Vendimin Nr. 12, datë 28.02.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; • Vendimin Nr. 20, datë 25.03.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

				për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; • Vendimin Nr. 42, datë 01.07.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; • Vendimin Nr. 59, datë 28.09.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Në zbatim të “Udhëzuesit standart të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median” (miratuar me vendimin nr. 716, datë 06.12.2023 të Këshillit Lartë Gjyqësor), vendimet e mësipërme ju vihen në dispozicion të paanonimizuara. Në këto kushte, ju sjellim në vëmendje respektimin e: - Dispozitave ligjore të parashikuara nga Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “<i>Për mbrojtjen e të dhënave personale</i>”, i ndryshuar, konkretisht: Nenin 2 dhe nenin 11. - Udhëzimit Nr. 9, datë 15.09.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “<i>Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audio vizive</i>”, konkretisht: Kreun I, pika 2 dhe 3; Kreun III, pika 5 dhe 6; Kreun IV, pika 4. - Udhëzimit Nr. 31, datë 27.12.2012 të		
--	--	--	--	--	--	--

				Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për përjashtimin nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike”, konkretisht: Nenin 4, pika 5.		
4.	27.01.2025	Kërkesë për informacion: 1. A është hedhur Procesi 38/123, vendimi i shkallës së parë, i cili (Vendimi 43) u shpall ne Korrik 2024, në Apel dhe nëse po a ka një Numër Akti? 2. A është Procesi që u hap paralel me Procesin 38/123 në një shkallë të tillë tashmë që mund të keni mundësi të jepni tashmë numrin e Aktit të këtij Procesi?	29.01.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 4, datë 27.01.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Kundër vendimit nr. 43, datë 08.07.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me të pandehur E.K, etj..., kanë bërë ankim të pandehurit E.K dhe Xh.Xh, si dhe Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Kjo dosje penale është rregjistruar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me nr. 13 Akti, datë rregjistrimi 20.01.2025. Për më tepër informacion në lidhje me gjykimin që po vijon në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar mund t’i drejtoheni me kërkesë për informacion kësaj gjykate. Më poshtë po ju dërgojmë adresën e email-it dhe numrin e telefonit të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, të Gjykatës së Posaçme të	Përfunduar Pranuar pjesërisht (E-mail)	Nuk ka

				Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Znj. Enida Demiraj. E-mail: enida.demiraj@gjykata.gov.al Tel: +355697230447 Sa i përket pyetjes tuaj të dytë, ku ju kërkon informacion mbi numrin e procedimit pasuror që po zhvillohet ndaj të pandehurve E.K dhe Xh.Xh, cituar në vendimin nr. 43, datë 08.07.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ju bëjmë me dije se ky procedim pasuror vijon të jetë në fazë hetimi. Bazuar në: Nenin 103, pika 1, 2 të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet shprehimisht se: “1. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose dhe vetëm i përmbajtjes së tyre nëpërmjet shtypit ose informacionit masiv; 2. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve josekrete deri në përfundimin e hetimeve paraprake”; Nenin 17 pika 2, gërma “b” të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “2. E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të	
--	--	--	--	---	--

				<i>mëposhtëm: ... b) parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale.</i>”, në kushtet që, procedimi pasuror që po zhvillohet ndaj të pandehurve E.K dhe Xh.Xh, sipas ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “<i>Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë</i>”, vijon të jetë në fazë hetimi, nuk mund t’ju jepet asnjë informacion lidhur me këtë procedim.		
5.	27.01.2025	Kërkohet vënia në dispozicion e: 1. Vendimit nr. 130, datë 06.12.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë; 2. Vendimit të argumentuar për çështjen e J.S që u arrestua në Korrik të vitit 2022, pasi iu gjet një armë pa leje, një krehër si dhe municion luftarak.	28.01.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 5, datë 27.01.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “<i>Për të drejtën e informimit</i>”, i ndryshuar, po ju dërgojmë Vendimin Nr. 130, datë 06.12.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, të ndarë në dy pjesë, në dy email-e pasi për shkak të madhësisë së dokumentit të skanuar, serveri i email-it nuk e ngarkon dot në një email të vetëm. Lidhur me kërkesën tuaj për t’ju vënë në dispozicion vendimin e arsyetuar për çështjen e shtetasit J.S, të arrestimit në Korrik të vitit 2022, pasi iu gjet një armë pa leje, një krehër si dhe municion luftarak, ju bëjmë me dije se, kjo çështje penale nuk është shqyrtuar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

				Në zbatim të “Udhëzuesit standart të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median”, miratuar me vendimin nr.716, datë 06.12.2023 të Këshillit Lartë Gjyqësor, vendimi i mësipërm ju vihet në dispozicion i paanonimizuar. Në këto kushte, ju sjellim në vëmendje respektimin e: - Dispozitave ligjore të parashikuara nga Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “<i>Për mbrojtjen e të dhënave personale</i>”, i ndryshuar, konkretisht: Nenin 2 dhe nenin 11. - Udhëzimit Nr. 9, datë 15.09.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “<i>Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audio vizive</i>”, konkretisht: Kreun I, pika 2, 3 dhe 11; Kreun III, pika 5 dhe 6; Kreun IV, pika 4 dhe 5. - Udhëzimit Nr. 31, datë 27.12.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “<i>Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për përjashtimin nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike</i>”, konkretisht: Nenin 4, pika 5.		
6.	27.01.2025	Kërkesë për vënie në dispozicion të vendimit nr. 67, datë 06.11.2024 të	28.01.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 6, datë 27.01.2025 në regjistrin përkatës të	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.		kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, bashkëlidhur këtij emaili po ju dërgojmë vendimin nr. 67, datë 06.11.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me të pandehur shtetasin F.Gj. Ju sjellim në vëmendje respektimin e: - Dispozitave ligjore të parashikuara nga Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, konkretisht: Nenin 2 dhe nenin 11. - Udhëzimit Nr. 9, datë 15.09.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audio vizive”, konkretisht: Kreun I, pika 2, 3 dhe 11; Kreun III, pika 5. - Udhëzimit Nr. 31, datë 27.12.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për përjashtimin nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike”, konkretisht: Nenin 4, pika 5.		
7.	27.01.2025	Kërkesë për informacion: 1. Sa shtetas janë dënuar me “punë në interes publik” nga	05.02.2025 (Pjesërisht)	Datë 05.02.2025: Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, përcjellë me shkresën Nr.	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		viti 2020-31.12.2024; (të dhënat e ndara sipas gjykatave në Republikën e Shqipërisë)? 2. Sa zyrtarë janë dënuar me “punë në interes publik” nga Gjykatat e Posaçme të Shkallës së Parë dhe Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nga viti 2020-31.12.2024? 3. Për çfarë veprash penale janë dënuar shtetasit shqiptarë (pika 1) dhe zyrtarët (pika 2)?	07.02.2025 (Përfunduar)	256/1 Prot., datë 23.01.2025 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, protokolluar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me nr. 308 prot., datë 27.01.2025 dhe rregjistruar në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të kësaj gjykate, po me datë 27.01.2025, me numër rendor 7, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Në vitin 2024, nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar: • I pandehuri K.H është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve</i>”, parashikuar nga neni 190/2 i Kodit Penal. -Në aplikim të nenit 63 të K.Penal është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim ndaj të pandehurit K.H duke bërë zëvendësimin e tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik, pa shpërblim. -Është urdhëruar i pandehuri K.H të kryejë 150 orë punë në interes publik dhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës. • I pandehuri L.B është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm te personave që</i>		
--	--	--	------------------------------------	--	--	--

				<i>ushtrojnë funksione publike” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 245/1 pg 1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal.</i> -Në zbatim të nenit 63 të Kodit Penal, është pezulluar ekzekutimi i dënimit me burgim ndaj të pandehurit L.B duke zëvendësuar me kryerjen e një punë në interes publik, pa shpërblim, prej 60 orësh. • I pandehuri E.S është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm te personave që ushtrojnë funksione publike” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 245/1 pg 1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal.</i> -Në zbatim të nenit 63 të Kodit Penal, është pezulluar ekzekutimi i dënimit me burgim ndaj të pandehurit E.S duke zëvendësuar me kryerjen e një punë në interes publik, pa shpërblim, prej 60 orësh. • I pandehuri S.T është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm te personave që ushtrojnë funksione publike” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 245/1 pg 2 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal.</i> -Në zbatim të nenit 63 të Kodit Penal, është pezulluar ekzekutimi i dënimit me burgim ndaj të pandehurit S.T duke zëvendësuar me kryerjen e një punë në interes publik, pa shpërblim, prej 120 orësh.		
--	--	--	--	--	--	--

				• I pandehuri B.D është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm te personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 245/1 pg 2 i Kodit Penal. -Në zbatim të nenit 63 të Kodit Penal, është pezulluar ekzekutimi i dënimit me burgim ndaj të pandehurit B.D duke zëvendësuar me kryerjen e një punë në interes publik, pa shpërblim, prej 80 orësh. • I pandehuri N.S është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm te personave që ushtrojnë funksione publike</i>” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 245/1 pg 2 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal. -Në zbatim të nenit 63 të Kodit Penal, është pezulluar ekzekutimi i dënimit me burgim ndaj të pandehurit N.S duke zëvendësuar me kryerjen e një punë në interes publik, pa shpërblim, prej 120 orësh. • I pandehuri G.L është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm te personave që ushtrojnë funksione publike</i>” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 245/1 pg 2 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal. -Në zbatim të nenit 63 të Kodit Penal, është pezulluar ekzekutimi i dënimit me burgim		
--	--	--	--	---	--	--

				ndaj të pandehurit G.L duke zëvendësuar me kryerjen e një punë në interes publik, pa shpërblim, prej 120 orësh. • I pandehuri O.M është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm te personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 245/1 pg 1 i Kodit Penal. -Në zbatim të nenit 63 të Kodit Penal, është pezulluar ekzekutimi i dënimit me burgim ndaj të pandehurit O.M duke zëvendësuar me kryerjen e një punë në interes publik, pa shpërblim, prej 60 orësh. • I pandehuri R.M është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm te personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 245/1 pg 1 i Kodit Penal. -Në zbatim të nenit 63 të Kodit Penal, është pezulluar ekzekutimi i dënimit me burgim ndaj të pandehurit R.M duke zëvendësuar me kryerjen e një punë në interes publik, pa shpërblim, prej 60 orësh. • I pandehuri E.D është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm te personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 245/1 pg 1 i Kodit Penal. -Në zbatim të nenit 63 të Kodit Penal, është		
--	--	--	--	--	--	--

				pezulluar ekzekutimi i dënimit me burgim ndaj të pandehurit E.D duke zëvendësuar me kryerjen e një punë në interes publik, pa shpërblim, prej 60 orësh. • I pandehuri I.L është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 244/2 i Kodit Penal. -Në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim duke e detyruar të pandehurin I.L të kryejë një punë në interes publik në masën 160 orë. • I pandehuri F.L është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim</i>”, parashikuar nga neni 257/a/2 të K.Penal. -Në aplikim të nenit 63 të K.Penal është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim ndaj të pandehurit F.L duke bërë zëvendësimin e tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik, pa shpërblim. -Është urdhëruar i pandehuri F.L të kryejë 80 orë punë në interes publik dhe të mbajë		
--	--	--	--	--	--	--

				kontakte me shërbimin e provës. • I pandehuri A.L është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsioni aktiv në zgjedhje</i>”, parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal. -Në zbatim të nenit 63 të Kodit Penal, është urdhëruar pezullimi i dënimit me burgim duke e detyruar të pandehurin A.L, të kryejë 80 (tetëdhjetë) orë punë në interes publik, për një periudhë kohe prej 6 (gjashtë) muajsh, ku gjatë kësaj kohe i pandehuri detyrohet të mbajë kontakte me Shërbimin të Provës, për të përcaktuar llojin e punës që i pandehuri do të kryejë, vendin e kryerjes së punës dhe ditët e javës ku do të kryhet puna në interes publik. Në vitin 2023, nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar: • I pandehuri A.Sh është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike</i>” në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 258 dhe 25 të Kodit Penal. -Në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal është pezulluar dënimi me burgim dhe detyrimin e të pandehurit A.Sh për kryerjen e një punë në interes publik, pranë Bashkisë Gramsh, për një kohë prej 120 orësh.		
--	--	--	--	--	--	--

				• E pandehura K.Xh është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike</i>” në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 258 dhe 25 të Kodit Penal. -Në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal është pezulluar dënimi me burgim dhe detyrimin e të pandehurës K.Xh për kryerjen e një punë në interes publik, pranë Bashkisë Gramsh, për një kohë prej 120 orësh. • I pandehuri A.J është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike</i>” në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 258 dhe 25 të Kodit Penal. -Në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal është pezulluar dënimi me burgim dhe detyrimin e të pandehurit A.J për kryerjen e një punë në interes publik, pranë Bashkisë Gramsh, për një kohë prej 60 orësh. • I pandehuri Q.I është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve</i>”, parashikuar nga neni 190 paragrafi i parë i Kodit Penal. -Në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal, është pezulluar ekzekutimi i dënimit me burgim për të pandehurin Q.I dhe detyrimin për kryerjen e një punë në interes publik, pa		
--	--	--	--	---	--	--

				shpërblim, për një kohë prej 40 (dyzet) orësh, e cila do të përmbushet brenda afatit prej 6 muajsh, me kusht që gjatë kësaj kohe të mbajë kontakte të rregullta me Shërbimin e Provës. • I pandehuri B.C është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm te personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 245/1 paragrafi 3 i Kodit Penal. -Në bazë të nenit 63 të Kodit Penal është pezulluar ekzekutimi i vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij, me detyrimin që i pandehuri B.C të përmbushë një punë në interes publik, me pëlqimin e tij dhe pa shpërblim, për një kohë prej 120 (njëqind e njëzet) orësh, si dhe detyrimin që i dënuari të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës. • I pandehuri Sh.K është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm te personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 245/1 paragrafi 1 i Kodit Penal. -Në bazë të nenit 63 të Kodit Penal është pezulluar ekzekutimi i vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij, me detyrimin që i pandehuri Sh.K të kryejë një punë në interes publik, me pëlqimin e tij dhe pa shpërblim, për një kohë prej 60 (gjashtëdhjetë) orësh, si dhe detyrimin që i dënuari të mbajë kontakte		
--	--	--	--	--	--	--

				me Shërbimin e Provës. • E pandehura S.M është deklaruar fajtores për kryerjen e veprës penale “<i>Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm të personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 245/1 paragrafi i dytë dhe 25 të Kodit Penal, para ndryshimeve të vitit 2021. -Bazuar në nenin 63 të Kodit Penal, është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për të pandehurën S.M dhe zëvendësimin e tij me detyrimin për të përmbushur një punë në interes publik. -E pandehura S.M është urdhëruar të kryejë 60 (gjashtëdhjetë) orë punë në interes publik, brenda një afati prej 6 (gjashtë) muajsh. Ju komunikojmë se, për vitet 2022-2020 informacionet e kërkuara nga ana juaj, do ju dërgohen në ditët në vijim, pasi këto të dhëna nuk gjenden në rregjistrat elektronik apo fizik të kësaj gjykate. Të dhënat e kërkuara nga juaj po nxirren manualisht, duke kontrolluar secilin nga vendimet e dhëna nga kjo gjykatë përgjatë viteve, proces i cili kërkon kohë. Datë 07.02.2025: Në vitin 2022, nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe		
--	--	--	--	--	--	--

				Krimin e Organizuar: • I pandehuri S.Xh është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 259 paragrafi 1, i Kodit Penal. -Në aplikim të nenit 63 të K.Penal është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim duke e detyruar të pandehurin S.Xh të kryejë një punë në interes publik në masën 240 orë. Në vitin 2021, nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar: • I pandehuri E.H është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal. -Në bazë të nenit 63 të Kodit Penal është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe zëvendësimi i tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik, prej 120 (njëqind e njëzet) orë duke u kryer kjo punë brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajsh, me kusht që i pandehuri të respektojë parashikimet e nenit 62 të K.Penal, të mbajë kontakte me Drejtorinë e Shërbimit të Provës, Korçë.		
--	--	--	--	---	--	--

				• I pandehuri Q.M është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal. - Në bazë të nenit 63 të Kodit Penal është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe zëvendësimi i tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik, prej 120 (njqind e njezete) orë duke u kryer kjo punë brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajsh, me kusht që i pandehuri të respektojë parashikimet e nenit 62 të K.Penal, të mbajë kontakte me Drejtorinë e Shërbimit të Provës, Lushnje. • I pandehuri F.A është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal. -Në bazë të nenit 63 të Kodit Penal është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe zëvendësimi i tij me detyrimin, që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik, prej 120 (njqind e njëzet) orë, duke u kryer kjo punë brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajsh, me kusht që i pandehuri të respektojë parashikimet e nenit 62 të Kodit Penal, duke mbajtur kontakte me Drejtorinë e Shërbimit të Provës, Lushnjë.		
--	--	--	--	---	--	--

			• I pandehuri G.T është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal. -Në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal, është pezulluar ekzekutimi i dënimit me burgim dhe detyrimin e të pandehurit G.T për kryerjen e një pune me interes publik, për një kohë prej 60 (gjashtëdhjetë) orë, brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajsh. • I pandehuri R.A është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal. -Në bazë të nenit 63 të K.Penal, është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe zëvendësimi i tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik, prej 60 (gjashtëdhjetë) orë, duke u kryer kjo punë brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajsh , me kusht që i pandehuri të respektojë parashikimet e nenit 62 të K.Penal, të mbajë kontakt me Drejtorinë e Shërbimit të Provës, Zyra Vendore Elbasan. • I pandehuri F.K është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsioni aktiv</i>		
--	--	--	--	--	--

				<i>i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal.</i> -Në bazë të nenit 63 të Kodit Penal është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe zëvendësimi i tij me detyrimin që i dënuari të përmbush një punë në interes publik, prej 120 (njëqind e njëzet) orë, duke u kryer kjo punë brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajsh, me kusht që i pandehuri të respektojë parashikimet e nenit 62 të K.Penal, të mbaj kontakte me Drejtorinë e Shërbimit të Provës Tiranë. • E pandehura Z.R është deklaruar fajtores për kryerjen e veprës penale <i>"Shpërdorimi i detyrës"</i>, parashikuar nga neni 248 i K.Penal. -Në aplikim të nenit 63 të K.Penal, është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim, dhe zëvendësimin e tij me detyrimin që e pandehura Z.R të përmbushë një punë në interes publik prej 120 (njëqind e njëzet) orësh duke u kryer për një afat prej 6 (gjashtë) muajsh, me kusht që e pandehura të respektojë parashikimet e nenit 62 të K.Penal dhe të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Gjirokastrë. • E pandehura M.S është deklaruar fajtores për kryerjen e veprës penale <i>"Falsifikim i</i>		
--	--	--	--	--	--	--

				<i>dokumentave shëndetësore</i>”, parashikuar nga neni 188/2 i K.Penal. -Në bazë të nenit 63 të Kodit Penal, është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe zëvendësimin me detyrimin për të përmbushur një punë në interes në publik, me pëlqimin e saj dhe pa shpërblim, për një periudhë kohë prej 60 (gjashtëdhjetë) orësh, brenda një afati prej 6 (gjashtë) muajsh, si dhe të mbajë kontakte me Drejtorinë e Shërbimit të Provës, Tiranë. • E pandehura D.H është deklaruar fajtore për kryerjen e veprës penale “<i>Falsifikim i dokumentave shëndetësore</i>”, parashikuar nga neni 188/2 i K.Penal. -Në bazë të nenit 63 të Kodit Penal, është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe zëvendësimin me detyrimin për të përmbushur një punë në interes në publik, me pëlqimin e saj dhe pa shpërblim, për një periudhë kohë prej 60 (gjashtëdhjetë) orësh, brenda një afati prej 6 (gjashtë) muajsh, si dhe të mbajë kontakte me Drejtorinë e Shërbimit të Provës, Tiranë. • I pandehuri A.P është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Falsifikim i dokumentave shëndetësore</i>”, parashikuar nga neni 188/2 i K.Penal. -Në bazë të nenit 63 të Kodit Penal, është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të dënimit		
--	--	--	--	--	--	--

				me burgim dhe zëvendësimin me detyrimin për të përmbushur një punë në interes në publik, me pëlqimin e tij dhe pa shpërblim, për një periudhë kohë prej 60 (gjashtëdhjetë) orësh, brenda një afati prej 6 (gjashtë) muajsh, si dhe të mbajë kontakte me Drejtorinë e Shërbimit të Provës, Tiranë. • E pandehura L.M është deklaruar fajtores për kryerjen e veprës penale “<i>Falsifikim i dokumentave shëndetësore</i>” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 188/2 e 25 i K.Penal. -Në bazë të nenit 63 të Kodit Penal, është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe zëvendësimin me detyrimin për të përmbushur një punë në interes në publik, me pëlqimin e saj dhe pa shpërblim, për një periudhë kohë prej 60 (gjashtëdhjetë) orësh, brenda një afati prej 6 (gjashtë) muajsh, si dhe të mbajë kontakte me Drejtorinë e Shërbimit të Provës, Tiranë. • E pandehura V.K është deklaruar fajtores për kryerjen e veprës penale “<i>Falsifikim i dokumentave shëndetësore</i>” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 188/2 e 25 i K.Penal. -Në bazë të nenit 63 të Kodit Penal, është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe zëvendësimin me detyrimin për të përmbushur një punë në interes në		
--	--	--	--	--	--	--

				publik, me pëlqimin e saj dhe pa shpërblim, për një periudhë kohë prej 60 (gjashtëdhjetë) orësh, brenda një afati prej 6 (gjashtë) muajsh, si dhe të mbajë kontakte me Drejtorinë e Shërbimit të Provës, Tiranë. • I pandehuri E.B është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale "<i>Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>", parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. -Në bazë të nenit 63 të Kodit Penal është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik prej 120 (njëqind e njëzet) orësh, duke u kryer kjo punë brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajsh me kusht që i pandehuri të respektojë parashikimet e nenit 62 të Kodit Penal, të mbajë kontakte me Drejtorinë e Shërbimit të Provës, Tiranë. • E pandehura F.M është deklaruar fajtoare për kryerjen e veprës penale "<i>Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>", parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. -Në bazë të nenit 63 të Kodit Penal është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me detyrimin që e dënuara të përmbushë një punë në interes publik prej 120 (njëqind e		
--	--	--	--	---	--	--

				njëzet) orësh, duke u kryer kjo punë brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajsh me kusht që e pandehura të respektojë parashikimet e nenit 62 të Kodit Penal, të mbajë kontakte me Drejtorinë e Shërbimit të Provës, Tiranë. • I pandehuri K.H është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale <i>"Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike"</i> kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 258 dhe 25 i Kodit Penal. -Në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim për pjesën e mbetur pa vuajtur të tij, duke e urdhëruar të pandehurin K.H që të kryejë 80 (tetëdhjetë) orë punë në interes publik. Në vitin 2020, nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar: • I pandehuri A.M është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale <i>"Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike"</i>, parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal. -Në bazë të nenit 63 të Kodit Penal, është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe zëvendësimi i tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një		
--	--	--	--	--	--	--

				punë në interes publik, prej 120 (njëqind e njëzet) orë duke u kryer kjo punë brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajsh, me kusht që i pandehuri të respektojë parashikimet e nenit 62 të K.Penal, të mbajë kontakte me Drejtorinë e Shërbimit të Provës, Tiranë. • I pandehuri V.B është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal. -Në bazë të nenit 63 të Kodit Penal është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe zëvendësimi i tij me detyrimin, që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik, prej 120 (njëqind e njëzet) orë, duke u kryer kjo punë brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajsh, me kusht që i pandehuri të respektojë parashikimet e nenit 62 të Kodit Penal, të mbajë kontakte me Drejtorinë e Shërbimit të Provës Tiranë. • I pandehuri Xh.T është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal. -Në bazë të nenit 63 të Kodit Penal, është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe zëvendësimi i tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një		
--	--	--	--	--	--	--

				punë në interes publik, prej 120 (njqind e njezete) orë duke u kryer kjo punë brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajsh, me kusht që i pandehuri të respektojë parashikimet e nenit 62 të K.Penal, të mbajë kontakte me Drejtorinë e Shërbimit të Provës, Tiranë. • I pandehuri E.N është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal. Në bazë të nenit 63 të K.Penal, është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe zëvendësimi i tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik, prej 40 (dyzet) orë, duke u kryer kjo punë brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajsh , me kusht që i pandehuri të respektojë parashikimet e nenit 62 të K.Penal, të mbajë kontakt me Drejtorinë e Shërbimit të Provës Korçë. • I pandehuri V.M është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal. -Në bazë të nenit 63 të Kodit Penal, është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe zëvendësimi i tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një		
--	--	--	--	--	--	--

				punë në interes publik, prej 120 (njëqind e njëzet) orësh duke u kryer kjo punë brenda afatit 6 (gjashtë) mujor, me kusht që i pandehuri të respektojë parashikimet e nenit 62 të K.Penal, të mbajë kontakte me Drejtorinë e Shërbimit të Provës, Durrës. • I pandehuri A.Q është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, në formën e dhënies së përfitimit të padrejtë, parashikuar nga neni 245/1/1 i Kodit Penal. -Bazuar në nenin 63 të Kodit Penal, është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim për të pandehurin A.Q, duke u detyruar i pandehuri që të përmbushë një punë me interes publik prej 100 (njëqind) orë, brenda afatit prej 6 (gjashtë) muaj. • I pandehuri L.B është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, në formën e marrjes së përfitimit të padrejtë, parashikuar nga neni 245/1/2 i Kodit Penal. -Bazuar në nenin 63 të Kodit Penal, është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim për të pandehurin L.B, duke u detyruar i pandehuri që të përmbushë një punë me interes publik prej 100		
--	--	--	--	---	--	--

				(njëqind) orë, brenda afatit prej 6 (gjashtë) muaj. • I pandehuri E.B është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal. -Në bazë të nenit 63 të Kodit Penal, është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe zëvendësimi i tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik, prej 40 (dyzet) orë, duke u kryer kjo punë brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajsh, me kusht që i pandehuri të respektojë parashikimet e nenit 62 të Kodit Penal, të mbajë kontakte me Drejtorinë e Shërbimit të Provës (Dega Territoriale e Shërbimit të Provës), Fier.		
8.	30.01.2025	Kërkesë për informacion: 1. A ka qenë shtetasi S.Ç alias M.L subjekt i GJKKO përveç çështjes së fundit penale ndaj tij me nr 138? 2. Nëse po, për çfarë veprash penale dhe cili ka qenë vendimi i gjykatës? 3. Kush ka qenë pjesë e trupës gjyqësore? 4. Lidhur me të ashtuquajturin “Operacioni	03.02.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 8, datë 30.01.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “<i>Për të drejtën e informimit</i>”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: 1) Me vendimin nr. 75, datë 20.11.2019, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët K.K, S.S dhe F.P, ndër të tjera, ka vendosur: • Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit	Përfunduar (Marrë kopja e CD-së)	60 lekë

		Forca e Ligjit”, mbi sekuestrimin e disa pasurive të këtij shtetasi, cila ka qenë vendimmarrja e Gjykatës, kush ka qenë trupë gjyqësore, dhe arsyetimi i vendimit?		M.L (S.Ç) për kryerjen e veprës penale të “Kundërshtimit të punonjësit të policisë së rendit publik” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 236/2 i K.Penal, pasi bazuar në nenin 388/1 pika “d” i K.Pr.Penale nuk provohet që i pandehuri ta ketë kryer veprën penale. • Pushimin e akuzës “Goditje për shkak të detyrës”, parashikuar nga neni 237 i K.Penal për të pandehurin M.L (S.Ç), pasi bazuar në nenin 387 të K.Pr.Penale ndjekja penale nuk duhet të vazhdojë. • Shuarjen e masës së sigurimit “arrest në burg” të paekzekutuar, dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë në ngarkim të të pandehurit M.L (S.Ç) për llogari të këtij procedimi penal, bazuar në nenin 261/1 gërma “a” të K.Pr.Penale. 2) Me vendimin nr. 36, datë 29.03.2021, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtare I.Gj, ndër të tjera, ka vendosur: • Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë. • Heqjen e sekuestros vendosur me urdhrin Nr. 157, datë 07.02.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit,	
--	--	---	--	--	--

				vleftësuar me vendimin Nr. 18, datë 12.03.2020, të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar: • Kthimin e Automjeti Land Rover, me ngjyrë blu e errët, me targë ****, në emër të shtetasit P.Ç; • Kthimin e Automjeti Land Rover, me ngjyrë të zezë, me targë ****, në emër të shtetasit M.Ç; Bashkëlidhur këtij emaili po ju dërgojmë vendimin nr. 36, datë 29.03.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me objekt “Konfiskimin e pasurive të sekuestruara vendosur me Urdhërin nr. 157 datë 07.02.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për pasuritë në zotërim të subjektit të aktit normativ S.Ç alias M.L”. Vendimin nr. 75, datë 20.11.2019, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë nuk ua dërgojmë dot në rrugë elektronike, pasi për shkak të madhësisë së dokumentit <i>serveri</i> i email-it nuk e lejon të dërgohet. Në këto kushte, mund të paraqiteni personalisht në gjykatë dhe të merrni një kopje të vendimit të hedhur në CD në rast se e dëshironi në këtë format, ose kopje fizike të vendimit. Vendimi sipas formatit që ju dëshironi, do ju vihet në dispozicion pasi të		
--	--	--	--	---	--	--

				bëni pagesën e tarifës përkatëse, në zbatim të Urdhërit Nr. 86, datë 17.04.2015 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale <i>“Për tarifat e dhënies së informacionit (dokumentacionit) të kërkuar”</i> (60 lekë për CD dhe 5 lekë për fletë për formatin A4). Në zbatim të <i>“Udhëzuesit standart të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median”</i>, miratuar me vendimin nr. 716, datë 06.12.2023 të Këshillit Lartë Gjyqësor, vendimet e mësipërme ju vihen në dispozicion të paanonimizuara. Në këto kushte, ju sjellim në vëmendje respektimin e: - Dispozitave ligjore të parashikuara nga Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 <i>“Për mbrojtjen e të dhënave personale”</i>, i ndryshuar, konkretisht: Nenin 2 dhe 11. - Udhëzimit Nr. 9, datë 15.09.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale <i>“Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audio vizive”</i>, konkretisht: Kreun I, pika 2, 3 dhe 11; Kreun III, pika 5 dhe 6. - Udhëzimit Nr. 31, datë 27.12.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale <i>“Për përcaktimin e kushteve dhe kritereve për përjashtimin nga detyrimet</i>	
--	--	--	--	--	--

				<i>përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike”, konkretisht: Nenin 4, pika 5.</i>		
9.	07.02.2025	Në vijim të komunikimit, bazuar në shkresën tuaj me Nr.Prot 2319/3, datë 06.12.2024, protokolluar në bashkinë X me Nr.Prot 2319/4 datë 16.12.2024, kërkojmë informacion nga ana juaj në lidhje me gjendjen gjyqësore të shtetasit R.I. Ju lutemi të na konfirmoni nëse është zbardhur vendimi i arsyetuar për këtë shtetas pasi R.I është nëpunës civil në administratën e bashkisë X dhe ky informacion ka rëndësi në lidhje me vijueshmerinë e marrëdhënies së tij të punës në këtë Institucion.	07.02.2025	Datë 07.02.2025 Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 9, datë 07.02.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije se, vendimi nr. 58, datë 16.10.2024, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me të pandehur R.I, etj..., akoma nuk është zbardhur nga ana e kësaj gjykate. Datë 14.02.2025 Në vijim të përgjigjes së dërguar më datë 07.02.2025, mbi kërkesën tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 9, datë 07.02.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, bashkëlidhur këtij email-i po ju dërgojmë vendimin nr. 58, datë 16.10.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me të pandehur R.I, etj...	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka
10.	13.02.2025	Kërkesë për informacion: Kisha vetëm një pyetje për	20.02.2025	Ju informojmë se, kërkesa juaj për informacion është regjistruar me datë 13.02.2025, me numër rendor 10, në	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		politikanet e dënuar dhe kriminelët e drogës, pse nuk i sekuestroni pasurinë?		regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, <i>“Për të drejtën e informimit”</i>, i ndryshuar. Në përgjigje të kërkesës tuaj, ku ju kërkon informacion se përse nuk janë sekuestruar pasuritë për politikanët e dënuar dhe kriminelët e drogës, më poshtë po ju dërgojmë disa prej rasteve që Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur konfiskimin e disa prej pasurive të zyrtarëve të dënuar, apo të shtetasve të dënuar/nën hetim për veprat penale në fushën e narkotikëve. 1) Me vendimin nr. 16, datë 18.06.2021 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndër të tjera, është vendosur konfiskimi i pasurive dhe kalimin në favor të shtetit, deri në vlerën e pajustificuar të shpenzimeve me të ardhura të ligjshme, për: 1 (një) pasuri të llojit ndërtesë dhe 1 (një) pasuri të llojit garazh, në pronësi të shtetasit A.H; 1 (një) pasuri të llojit apartament, në pronësi të shtetasve A.H, M.H dhe F.H; 1 (një) pasuri e llojit njësi, në pronësi të shtetasit F.H; si dhe për 5 (pesë) automjete. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me datë	
--	--	--	--	---	--

				08.07.2016 ka regjistruar procedimin penal nr. 134, për veprat penale “<i>Kultivimi i bimëve narkotike</i>”, “<i>Grupi i strukturuar kriminal</i>”, parashikuar nga nenet 284 dhe 333/a të Kodit Penal. Me datë 29.04.2017, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. 164 për veprën penale “<i>Trafikimi i narkotikëve</i>”, në bashkëpunim, parashikuara nga neni 283/a/2 i Kodit Penal. Nga të dhënat e grumbulluara rezultonte se disa shtetas, ndër të cilët edhe shtetasit M.H dhe F.H, ushtronin aktivitet kriminal të trafikimit të lëndëve narkotike nga Shqipëria në drejtim të Italisë. Me datë 25.09.2017 është vendosur bashkimi i procedimeve penale nr. 134 të vitit 2016 me procedimin penal nr. 164 të vitit 2017, në një procedim penal nr. 134 të vitit 2016. 2) Me vendimin nr. 57, datë 25.09.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndër të tjera, është vendosur konfiskimi dhe kalimi në favor të shtetit, i pasurisë së paluajtshme, e llojit “njësi”, në pronësi të shtetasit L.K, deri në vlerën që i		
--	--	--	--	--	--	--

				korrespondon asaj të produktit të veprës penale, sipas pjesës arsyetuese të vendimit. Me vendimin e sipërcituar i pandehuri L.K është deklaruar fajtor për kryerjen e veprave penale “<i>Shpërdorimi i detyrës</i>”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal (<i>fakti penal lidhur me procedurën e shpronësimit</i>), <i>Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose i të zgjedhurve vendorë</i>”, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal dhe “<i>Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale</i>”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287 pg 2, i Kodit Penal. 3) Me vendimin nr. 39, datë 25.06.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndër të tjera, është vendosur konfiskimi dhe kalimi në favor të shtetit i sendeve të sekuestruara: 1 (një) automjet sekuestruar të pandehurit D.Ç, 1 (një) automjet sekuestruar të pandehurit K.K alias K.V, shuma monetare sekuestruar të pandehurit N.Gj, si dhe kartëmonedhat sekuestruar të pandehurës E.F. Me vendimin e sipërcituar, gjykata, ndër të tjera ka vendosur: Deklarimin fajtor të të pandehurit D.Ç, për		
--	--	--	--	--	--	--

				kryerjen e veprave penale <i>“Trafikimi i narkotikëve”</i>, e kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 283/a pg 1, në lidhje me nenet 28/4 dhe 334/1 të Kodit Penal, <i>“Grupi i strukturuar kriminal”</i>, parashikuar nga neni 333/a, pg 1 i Kodit Penal, <i>“Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”</i>, parashikuar nga neni 278 pg 4 i Kodit Penal, <i>“Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”</i>, parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal. Deklarimin fajtor të të pandehurit K.V alias K.K, për kryerjen e veprës penale <i>“Trafikimi i narkotikëve”</i>, e kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 283/a pg 1, në lidhje me nenet 28/4 dhe 334/1 të Kodit Penal, <i>“Grupi i strukturuar kriminal”</i>, parashikuar nga neni 333/a, pg 1 i Kodit Penal, <i>“Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”</i>, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 278 pg 1, në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal. Deklarimin fajtor të të pandehurit N.Gj për kryerjen e veprave penale <i>“Trafikimi i narkotikëve”</i>, e kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal,		
--	--	--	--	--	--	--

				parashikuar nga neni 283/a pg 1, në lidhje me nenet 28/4 dhe 334/1 të Kodit Penal, “<i>Grupi i strukturuar kriminal</i>”, parashikuar nga neni 333/a, pg 1 i Kodit Penal. Deklarimin fajtores të pandehurës E.F për kryerjen e veprave penale “<i>Trafikimi i narkotikëve</i>”, e kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 283/a pg 1, në lidhje me nenet 28/4 dhe 334/1 të Kodit Penal, “<i>Grupi i strukturuar kriminal</i>”, parashikuar nga neni 333/a, pg 2 i Kodit Penal. 4) Me vendimin nr. 1, datë 09.01.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndër të tjera, është vendosur konfiskimi dhe kalimi në favor të shtetit për pasuritë: 2 (dy) apartamente, 1 (një) njësi, 1 (një) motor uji, 1 (një) varkë vetorizine, 2 (dy) automjete dhe 10 (dhjetë) llogari bankare, të lidhura me subjektin F.S. Me vendimin nr. 5736, datë 01.12.2010, Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Antverpen, dega Antvermen, dhoma 8C, ka vendosur të dënojë të pandehurin F.S për faktet së bashku në akuzat e vërtetuara, me 8 (tetë) vjet heqje lirie dhe gjobë. Nga hetimi i kryer nga		
--	--	--	--	---	--	--

				policia belge janë vërtetuar disa raste të implikimit të shtetasit F.S, në përfshirje të veprimtarisë kriminale në kuadër të grupit kriminal për veprat si: trafikim i lëndëve narkotike të llojit kokainë, mashtrim dhe falsifikim dokumentash.		
11.	17.02.2025	Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të kopjeve të vendimeve: 1. Numri i çështjeve dërguar për gjykim në këtë gjykatë nga Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, për periudhën Mars 2024-Dhjetor 2024, për veprat penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” dhe “Korrupsioni pasiv në zgjedhje”, parashikuar nga nenet 328, 328/b të Kodit Penal si dhe ato të parashikuara në Kreun X të Kodit Penal “Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve”, për të cilat Gjykata juaj është kompetente, sipas nenit 75/a të K.Pr.Penale;	25.02.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, protokolluar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me datë 14.02.2025, me nr. 594 prot., regjistruar në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve me datë 17.02.2025, me numër rendor 11, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Për periudhën Mars 2024 - Dhjetor 2024, nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë dhënë 4 (katër) vendime për veprën penale “Korrupsion aktiv në zgjedhje”, parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal dhe asnjë vendim për veprën penale “Korrupsion pasiv në zgjedhje”, parashikuar nga neni 328/b i Kodit Penal. 1. Me vendimin nr. 14, datë 05.03.2024 të GJKKO-së, janë deklaruar fajtor të pandehurit P.K dhe D.B, për kryerjen e veprës penale “Korrupsion aktiv në zgjedhje”, kryer në bashkëpunim,	Përfunduar (E-mail; Kërkuesi nuk është paraqitur për të marrë kopje të vendimeve apo të CD-së.)	Nuk ka

		2. Fazën e shqyrtimit në të cilën ndohen këto çështje në gjykimin tuaj; 3. Nëse gjykata është shprehur me vendim, lutemi të na vihen në dispozicion kopje të vendimeve përkatëse.		parashikuar nga nenet 328 dhe 25 të Kodit Penal. 2. Me vendimin nr. 25, datë 17.04.2024 të GJKKO-së, është deklaruar fajtor i pandehuri G.C, për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal. 3. Me vendimin nr. 30, datë 08.05.2024 të GJKKO-së, janë deklaruar fajtor të pandehurit E.I, P.D, M.V dhe A.B, për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 328 dhe 25 e 22 të Kodit Penal. 4. Me vendimin nr. 64, datë 28.10.2024 të GJKKO-së, është deklaruar fajtor i pandehuri A.L, për veprën penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal. Aktualisht, pranë kësaj gjykate nuk po shqyrtohet në themel asnjë dosje penale për veprat penale “Korrupsion aktiv në zgjedhje” dhe “Korrupsion pasiv në zgjedhje”, parashikuar nga nenet 328 dhe 328/b i Kodit Penal. Ndërsa veprat e tjera penale, të parashikuara në Kreun X të Kodit Penal, nuk janë në kompetencën lëndore të kësaj gjykate, sipas nenit 75/a të K.Pr.Penale. Sa i përket vendimeve të sipërcituara, mund të paraqiteni në gjykatë dhe të merrni një		
--	--	---	--	---	--	--

				kopje të vendimeve të hedhura në CD në rast se i dëshironi në këtë format, ose kopje fizike të vendimeve. Vendimet sipas formatit që ju dëshironi, do ju vihen në dispozicion pasi të bëni pagesën e tarifës përkatëse, në zbatim të Urdhërit Nr. 86, datë 17.04.2015 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale “<i>Për tarifat e dhënies së informacionit (dokumentacionit) të kërkuar</i>” (60 lekë për CD dhe 5 lekë për fletë për formatin A4). Në zbatim të “Udhëzuesit standart të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median” (miratuar me vendimin nr. 716, datë 06.12.2023 të Këshillit Lartë Gjyqësor), vendimet e mësipërme ju vihen në dispozicion të paanonimizuara. Në këto kushte, ju sjellim në vëmendje respektimin e: - Dispozitave ligjore të parashikuara nga Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “<i>Për mbrojtjen e të dhënave personale</i>”, i ndryshuar, konkretisht: Nenin 2 dhe nenin 11. - Udhëzimit Nr. 9, datë 15.09.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “<i>Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audio vizive</i>”, konkretisht: Kreun I, pika 2 dhe 3; Kreun		
--	--	--	--	---	--	--

				III, pika 5 dhe 6; Kreun IV, pika 4. -Udhëzimit Nr. 31, datë 27.12.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për përcaktimin e kushteve dhe kritereve për përjashtimin nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike”, konkretisht: Nenin 4, pika 5.		
12.	20.02.2025	Kërkesë për informacion: Ditën e sotme më 20 shkurt 2025, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë vendosi pezullimin e çështjes për të pandehurit A.V, E.D dhe R.Ç, për një periudhë kohore 1 vit, për shkak se nuk u bë i mundur njoftimi personalisht i këtyre të pandehurve për tu paraqitur në seancë paraprake. Sipas një komunikimi nga ana juaj, çështja në ngarkim të të pandehurve të sipërcituar u nda më vete. Po ashtu, na është komunikuar se i pandehuri A.Z paraqiti kërkesë për gjykim të shkurtuar dhe në këto kushte gjyqtari i çështjes vendosi të njoftojë kryetarin e gjykatës për plotësimin e	21.02.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 12, datë 20.02.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Me vendimin nr. 92, datë 03.07.2024, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndër të tjera, bazuar në nenin 103 të K.Pr.Penale ka vendosur: “Ndalimin e publikimit të pjesës përshkruese dhe arsyetuese të këtij vendimi, kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për caktimin e masave të sigurimit personal, si dhe i akteve që lidhen me këtë çështje nëpërmjet shtypit ose informacionit masiv deri në përfundimin e hetimeve paraprake.”. Pra, gjykata përcakton se ndalohet publikimi i vendimit dhe i akteve të tjera deri në përfundim të hetimeve paraprake. Në kushtet që, në seancën paraprake të datës	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		trupit gjykues me dy anëtarë të tjerë. Kur çështja për të pandehurin A.Z kaloi për gjykim, vlerësojmë se kemi të bëjmë me përfundimin e hetimeve paraprake, si dhe se të dhënat e hetimit tashmë do të bëhen publike në seancat gjyqësore të shqyrtimit të themelit të çështjes. Në vendimin e caktimit të masave të sigurimit personal për këta të pandehur, është urdhëruar ndalimi i publikimit të të dhënave deri në përfundimin e hetimeve paraprake. Ndërkohë, në kushtet e vendimarrjeve të sotme për këtë çështje nga ana e gjykatës, kërkojmë vlerësimin tuaj nëse ka përfunduar afati i ndalimit të publikimit të të dhënave të vendimit për caktimin e masës së sigurimit personal ndaj të pandehurve A.Z, E.D, R.Ç dhe A.V?		20.02.2025, i pandehuri A.Z, nëpërmjet mbrojtësit të tij, paraqiti kërkesë për gjykim të shkurtuar, gjykata, duke vlerësuar se hetimet janë të plota, bazuar në nenet 332/dh, pika 1, shkronja “c” dhe 13 të K.Pr.Penale caktoi datën e seancës gjyqësore të themelit (05.03.2025, ora 10:30) dhe njoftoi Zv/Kryetarin e gjykatës për plotësimin e trupit gjykues sipas ligjit. Pas hedhjes së shortit elektronik të datës 21.02.2025, në përbërje të trupit gjykues për shqyrtimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit A.Z, u caktuan gjyqtarët R.P dhe B.N. Për sa më sipër, ju informojmë se, afati i përcaktuar në vendimin nr. 92, datë 03.07.2024, të sipërcituar, tashmë ka përfunduar, pasi jo vetëm që kanë përfunduar hetimet paraprake, por çështja penale në ngarkim të të pandehurit A.Z po shqyrtohet në themel pranë kësaj gjykate.		
13.	24.02.2025	Kërkesë për informacion: Së pari transkriptin/proceverbalin e	24.02.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 13, datë 24.02.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr.	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		seancës gjyqësore të vlerësimit të masës së sigurisë ndaj kryebashkiakut të X, E.V, bashkëshortes së tij A.X të datës 12 shkurt 2025. Në rast se kjo nuk mundësohet a mundet gjykata të konfirmojë vërtetësinë e një pjese bisede të publikuar në faqen Facebook nga kryebashkiaku V (bashkëlidhur si foto) si e shkëputur nga ky transkript? Konkretisht dua të konfirmoj nëse gjatë seancës prokurori ka përdorur fjalën "Ndyrësirë" siç pretendohet nga V, dhe a është apo jo e saktë pjesa e proceverbalit e publikuar në rrjete e media sociale?		119/2014, <i>"Për të drejtën e informimit"</i>, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Pjesa e procesverbalit të publikuar nga personi nën hetim E.V në rrjetin e tij social "facebook" nuk është i saktë. Nga verifikimi i bërë në sistemin audio, të seancës gjyqësore për marrjen në pyetje të personave nën hetim E.V, etj., të datës 12.02.2025, konkretisht intervali kohor 6:34:02 PM – 6:34:57 PM (të cilit i referohet i hetuari E.V në postimin e tij) si dhe nga procesverbali i seancës gjyqësore, nuk rezulton që të jetë përdorur fjala "ndyrësirë" nga ana e prokurorit O.D në asnjë moment.		
14.	27.02.2025	Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të kopjeve të vendimeve: 1. Në shtator 2019, u arrestuan dy persona ndërsa një i tretë u shpall në kërkim në kuadër të operacionit ndërkombëtar anti drogë të	03.03.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 14, datë 27.02.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, <i>"Për të drejtën e informimit"</i>, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: D) Lidhur me pikën e parë të kërkesës tuaj, sa i përket operacionit "Kuito", bashkëlidhur këtij email-i po ju dërgojmë vendimin nr.	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		koduar “KUITO”. Gjatë këtij operacioni, u kapën 137 kg kokainë që u dyshua se vinte nga Ekuadori. Lidhur me këtë çështje, kërkojmë të na vihet në dispozicion, vendimi i dhënë nga GJKKO, i cili të përmbajë: a. Kush janë personat e gjykuar dhe dënuar në fund të procesit? b. Sa ka qenë dënimi përkatës dhe veprat penale për të cilat janë dënuar c. Në çfarë masash sigurie janë gjykuar shtetasit pjesë e këtij procedimi penal? 2. Kërkojmë të na vihet në dispozicion, vendimi i dhënë nga GJKKO në lidhje me operacionin “Rada” të datës 13.07.2021, në Portin e Durrësit, ku është goditur një rast trafiku ndërkombëtar droge, me informacionet në përmbajtje: a. Kush janë personat e përfshirë në këtë proces? b. Cili është vendimi i dhënë për operacionin në fjalë, pra		77, datë 02.12.2021 dhe vendimin nr. 2, datë 10.01.2023 të kësaj gjykate. Me vendimin nr. 77, datë 02.12.2021 të GJKKO-së: 1. I pandehuri A.M, gjykuar me masën e sigurimit personal “arrest në burg”, është deklaruar fajtor për veprat penale “<i>Trafikim i narkotikëve</i>” e kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, “<i>Grupi i strukturuar kriminal</i>”, parashikuar nga nenet 283/a paragrafi i parë dhe 28 pika 4, 333/a paragrafi i dytë i Kodit Penal. 2. I pandehuri A.B, gjykuar me masën e sigurimit personal “arrest në burg”, është deklaruar fajtor për veprat penale “<i>Trafikim i narkotikëve</i>” e kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, “<i>Grupi i strukturuar kriminal</i>”, parashikuar nga nenet 283/a paragrafi i parë dhe 28 pika 4, 333/a paragrafi i dytë i Kodit Penal. Me vendimin nr. 2, datë 10.01.2023 të GJKKO-së: 1) I pandehuri G.M, gjykuar me masën e sigurimit personal “arrest në burg”, është deklaruar fajtor për veprat penale “<i>Trafikimi i narkotikëve</i>”, në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, “<i>Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal</i>”, parashikuar nga nenet 283/a/1, dhe në lidhje me nenet 28/4	
--	--	--	--	--	--

		cilët të pandehur u dënuan dhe cilët u shpallën të pafajshëm? c. Në çfarë mase sigurie janë gjykuar të pandehurit? 3. Për shtetasin, E.D administrator i “A.E.F”, a rezulton të jetë gjykuar në procese të tjera në 5 vitet e fundit? Nëse po, për çfarë gjykimi bëhet fjalë? Po kompania “A.E.F” a është gjykuar në 5 vitet e fundit nga GJKKO, nëse po, cili është vendimi i marrë për të? Për sa më sipër ju lutem të na vini në dispozicion vendimet përkatëse!		dhe 334/1, 333/a/1 të Kodit Penal. II) Lidhur me pikën e dytë të kërkesës tuaj, sa i përket operacionit “Rada”, ju bëjmë me dije se: 1. Me vendimin nr. 64, datë 31.07.2021 të GJKKO-së është vendosur: 1. Rivlerësimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg” parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, të caktuar ndaj të dyshuarit B.G nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. 3081, datë 16.07.2021; 2. Caktimin ndaj të dyshuarit B.G, si masë sigurimi atë të “arrest me burg”, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale. I dyshuar për kryerjen e veprave penale “<i>Trafikim të narkotikëve</i>”, kryer në bashkëpunim të veçantë, atë të grupit të strukturuar kriminal, “<i>Grupi i strukturuar kriminal</i>”, “<i>Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal</i>”, parashikuar nga nenet 283/a, 28/4, 333/a dhe 334 të Kodit Penal. 2. Me vendimin nr. 75, datë 29.09.2021 të GJKKO-së është vendosur: Caktimin ndaj të dyshuarit E.D, si masë sigurimi atë të “arrest me burg” parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, i dyshuar për kryerje të veprave penale “<i>Trafikim të narkotikëve</i>”, kryer në bashkëpunim të veçantë, atë të grupit të strukturuar kriminal, “<i>Grupi i strukturuar kriminal</i>”, “<i>Kryerja e veprave penale nga</i>	
--	--	---	--	--	--

				<i>organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal</i>”, parashikuar nga nenet 283/a, 28/4, 333/a dhe 334 të Kodit Penal. 3. Me vendimin nr. 31, datë 09.04.2022 të GJKKO-së është vendosur: Vazhdimi i masës së sigurimit “arrest në burg” parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, caktuar ndaj personit nën hetim E.D me vendimin nr. 75, datë 29.09.2021 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Çështja penale e sipërcituar, në ngarkim të shtetasve B.G dhe E.D nuk është gjykuar në themel pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pasi Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka shpallur moskompetencën dhe i ka dërguar aktet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. III) Lidhur me pikën e tretë të kërkesës tuaj, ku ju kërkon informacion nëse rezulton që shtetasi E.D (administrator i A.E.F) apo kompania “A.E.F”, të jenë gjykuar në procese të tjera në 5 vitet e fundit pranë GJKKO-së, ju informojmë se, për shtetasin dhe kompaninë e sipërcituar nuk na rezulton që të jenë gjykuar pranë GJKKO-së për ndonjë çështje tjetër penale.		
--	--	--	--	--	--	--

				Në zbatim të “Udhëzuesit standart të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median”, miratuar me vendimin nr.716, datë 06.12.2023 të Këshillit Lartë Gjyqësor, vendimet e mësipërme ju vihet në dispozicion të paanonimizuara. Në këto kushte, ju sjellim në vëmendje respektimin e: - Dispozitave ligjore të parashikuara nga Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, konkretisht nenin 2 dhe nenin 11. - Udhëzimit Nr. 9, datë 15.09.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audio vizive”, konkretisht: Kreun I, pika 2, 3 dhe 11; Kreun III, pika 5 dhe 6; Kreun IV, pika 4 dhe 5. - Udhëzimit Nr. 31, datë 27.12.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për përjashtimin nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike”, konkretisht nenin 4, pika 5.		
15.	28.02.2025	Kërkesë për informacion dhe akte: ... Në kuadër të këtij procesi gjyqësor, në mbështetje të	11.03.2025	... Për sa më sipër, duke qenë se, sipas nenit 8 të ligjit nr. 8550, datë 18.11.1999, i ndryshuar, gjykatat nuk bëjnë pjesë në	Përfunduar (Kthyer përgjigje me shkresën nr. 825/1	Nuk ka

		nenit 8, të ligjit nr. 8550, datë 18.11.1999 “Statusi i Deputetit”, i ndryshuar, kërkojmë që të vihet në dispozicion dokumentacioni dhe informacioni si më poshtë vijon: 1. Një kopje e njehsuar me origjinalin e vendimit nr. 69, datë 11.07.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, si dhe një kopje të njehsuar të të gjitha akteve të tjera që ndodhen në dosjen gjyqësore; 2. Një kopje e njehsuar me origjinalin e vendimit nr. 60, datë 19.09.2019 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për shtetasin S.T, si dhe një kopje të njehsuar të të gjitha akteve të tjera që ndodhen në dosjen gjyqësore; 3. Listën e plotë të deputetëve, kryebashkiakëve dhe ministrave të Partisë Socialiste për periudhën 1 Shtator 2013 – 25 Shkurt 2025, për të cilët Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë		institucionet, prej të cilave deputeti ka të drejtë të kërkojë shpjegime për çdo çështje që ka të bëjë me përmbushjen e detyrës së tij, kërkesa e deputetit G.B është rregjistruar pranë kësaj gjykate me datë 28.02.2025, si kërkesë për informim, me numër rendor 15, sipas nenit 11 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar. Në kuadër të së drejtës për informim, nga ana e kësaj gjykate do ju vihen në dispozicion vetëm kopjet e njehsuara me origjinalin të vendimeve nr. 69, datë 11.07.2017 dhe nr. 60, datë 19.09.2019, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, së bashku me shënimet përkatëse lidhur me vendimmarrjen e gjykatave më të larta, si dhe informacioni në lidhje me deputetët, kryebashkiakët dhe ministrat, për të cilët kjo gjykatë ka vendosur masa sigurimi, masa sekuestro/konfiskimi, dhe deklarinimin fajtor e dënimin e tyre, për periudhën 19 Dhjetor 2019, datë në të cilën ka filluar funksionimi i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në vijim. Me vendimi nr. 46, datë 17.06.2021 Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO) ka vendosur:	prot., datë 11.03.2025.)	
--	--	--	--	---	--------------------------------------	--

		për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur masa sigurimi, masa sekuestro/konfiskimi, dhe deklarimin fajtor e dënimit e tyre. Informacioni të përfshijë emrat e deputetëve, kryebashkiakëve dhe ministrave, referencat e vendimeve gjyqësore dhe veprat penale.		• Deklarimin fajtor të të pandehurës Z.R për kryerjen e vepres penale të "<i>Shpërdorimit të detyrës</i>", të parashikuar nga neni 248 i K.Penal dhe dënimin e saj me 1 (një) vit burgim. • Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, ulet 1/3 e masës së dënimit duke u dënuar përfundimisht e pandehura Z.R me 8 (tetë) muaj burgim. • Në aplikim të nenit 63 të K.Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim, dhe zëvendësimin e tij me detyrimin që e pandehura Z.R të përmbushë një punë në interes publik prej 120 (njëqind e njëzet) orësh duke u kryer për një afat prej 6 (gjashtë) muajsh, me kusht që e pandehura të respektojë parashikimet e nenit 62 të K.Penal dhe të mbaje kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Gjyrokastër. Viti 2022 Me vendimi nr. 16, datë 01.03.2022 GJKKO ka vendosur: • Deklarimin e pafajshëm të të akuzuarit A.R, për veprën penale "<i>Fyerja</i>", parashikuar nga neni 119/2 i Kodit Penal, lidhur me publikimin në profilin e tij në facebook në datën 17.05.2020, pasi fakti	
--	--	---	--	---	--

				nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. • Deklarimin fajtor të të akuzuarit A.R për veprën penale <i>"Shpifje"</i>, parashikuar nga neni 120/1 i Kodit Penal, në dëm të viktimës akuzuese A.C, në lidhje me email e datës 19.05.2020, dërguar në adresën e Drejtorisë Qëndrore të F.I.B, dhe dënimin e tij me 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë gjobë. Me vendimi nr. 26, datë 07.04.2022 GJKKO ka vendosur: • Deklarimin fajtor të të pandehurës R.V për veprën penale <i>"Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike"</i>, të parashikuar nga neni 245/1, paragrafi i dytë i Kodit Penal, para ndryshimeve të kryera me ligjin nr.43/2021, si dhe dënimin e saj me 1 (një) vit e 3 (tre) muaj burgim. • Në bazë të nenit 406 pika 1 të K.Pr.Penale, të pandehurës R.V i ulet 1/3 e dënimit për shkak të aplikimit të gjykimit të shkurtuar, dhe përfundimisht dënohet me 10 (dhjetë) muaj burgim. • Vuajtja e dënimit të pandehurës i fillon nga dita e zbatimit të masës së sigurimit "arrest në shtëpi", datë 13.07.2021, dhe të kryhet në një burg të sigurisë së		
--	--	--	--	--	--	--

				zakonshme. • Në bazë të nenit 35 pika 1 të K.Penal, të pandehurës R.V i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një periudhë 5 vjeçare. • Në bazë të nenit 190/1, shkronjat (a) dhe (ç) të K.Pr.Penale, të nenit 36/1, shkronjat (a) dhe (ç) të K.Penal, për sendet e sekuestruara do të disponohet si më poshtë; ○ Shuma monetare prej 2000 Euro, nga shuma e sekuestruar të pandehurës R.V, të konfiskohet. ○ Aparat celular i markës Samsung S20 plus të sekuestruar të pandehurës R.V, aparat celular i markës Iphone 11 sekuestruar të pandehurës M.H, aparat celular i markës Iphone 11 sekuestruar të pandehurës F.B, të konfiskohen. Me vendimi nr. 47, datë 29.07.2022 GJKKO ka vendosur: • Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit F.T për kryerjen e veprës penale të <i>“Shkelje e barazisë së pjesmarrësve në tendera apo ankande publike”</i>, e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 258 dhe 25 i Kodit Penal pasi nuk provohet se e ka kryer këtë vepër penale.		
--	--	--	--	---	--	--

				• Deklarimin fajtor të të pandehurit F.T për kryerjen e veprës penale të “<i>Shpërdorim i detyrës</i>”, (episodi i shpërdorimit të karburantit) e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim. • Deklarimin fajtor të të pandehurit F.T për kryerjen e veprës penale të “<i>Shpërdorim i detyrës</i>”, (episodi i ndërtimeve pa leje) e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim. • Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal në bashkim të dënimeve i pandehuri F.T dënohet me një dënim të vetëm prej 3 (tre) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim. • Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit F.T i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 2 (dy) vjet e 4 (katër) muaj burgim. • Vuajta e dënimit të kryhet nga i pandehuri F.T në një burg të sigurisë së zakonshme. • Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit F.T i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 5 (pesë) vitesh.		
--	--	--	--	---	--	--

				Me vendimin Nr. 11, datë 02.02.2023 GJKKO ka vendosur: • Deklarimin fajtor të të pandehurit Q.I për kryerjen e veprës penale “<i>Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve</i>” parashikuar nga neni 190 paragrafi i parë i Kodit Penal dhe dënimin e tij në bazë të kësaj dispozite me 6 (gjashtë) muaj burgim. • Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, uljen e dënimit me 1/3 dhe dënimin përfundimtar të të pandehurit Q.I me 4 (katër) muaj burgim. • Në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për të pandehurin Q.I dhe detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik, pa shpërblim, për një kohë prej 40 (dyzet) orësh, e cila do të përmbushet brenda afatit prej 6 muajsh, me kusht që gjatë kësaj kohe të mbajë kontakte të rregullta me Shërbimin e Provës. Në seancën paraprake të datës 06.04.2023 (nr. regjistrimi 40), gjykata ka disponuar si më poshtë: • Pranimin e kërkesës së palës kërkuese, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për dërgimin në		
--	--	--	--	--	--	--

				gjyq të çështjes penale që i përket procedimit penal nr. 279, datë 27.10.2021 në ngarkim të të pandehurit F.M, akuzuar për kryerjen e veprës penale “<i>Shpërdorimi i detyrës</i>” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal dhe “<i>Shpërdorimi i detyrës</i>”, në bashkëpunim, me subjekt ushtarak-kuadër komandues, parashikuar nga neni 70/2 e 2 i Kodit Penal Ushtarak dhe 25 i Kodit Penal. • Vijimin e gjykimit nga e njëjta gjykatë, duke u shndërruar nga gjyqtare e seancës paraprake, në gjyqtare të themelit. Me vendimin nr. 90, datë 20.07.2023 GJKKO ka vendosur: • Caktimin ndaj personit nën hetim A.A, të masës së sigurimit personal “<i>arrest në burg</i>” parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, si i dyshuar për veprat penale “<i>Refuzimi për deklarin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim</i>”, “<i>Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë</i>” 6 (gjashtë) herë dhe “<i>Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale</i>” të parashikuara nga nenet 257/a, 260 dhe 287, gërmat (a) dhe (b) të		
--	--	--	--	--	--	--

				Kodit Penal, e kryer në rrethanën cilësuese “<i>në bashkëpunim</i>” sipas nenit 287, paragrafi (2) i Kodit Penal. Me vendimin nr. 57, datë 25.09.2023 GJKKO ka vendosur: • Deklarimin fajtor të të pandehurit L.K, për kryerjen e veprës penale “<i>Shpërdorimi i detyrës</i>”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal (<i>fakti penal lidhur me procedurën e shpronësimit</i>) dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me 3 (tre) vite burgim. • Deklarimin fajtor të të pandehurit L.K, për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose i të zgjedhurve vendorë</i>”, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me 6 (gjashtë) vite burgim. • Deklarimin fajtor të të pandehurit L.K, për kryerjen e veprës penale “<i>Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale</i>”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287 pg 2, i Kodit Penal dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me 8 (tetë) vite burgim. • Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve i pandehuri L.K dënohet me një dënim të vetëm prej 10		
--	--	--	--	---	--	--

				(dhjetë) vite burgim. • Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit L.K i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 6 (gjashtë) vite e 8 (tetë) muaj burgim. • Llogaritja e dënimit fillon nga data e arrestimit dhe dënimi me burgim nga i pandehuri L.K do të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme, në referim të parashikimeve të nenit 18, të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”. • Në zbatim të nenit 35 pg 1 të Kodit Penal, të pandehurit L.K i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 5 (pesë) vitesh. • Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit A.B, akuzuar për kryerjen e veprës penale “<i>Shpërdorimi i detyrës</i>”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, në referim te nenit 388, pika 1 të K.Pr.Penale. • Në bazë të nenit 375 të K.Pr.Penale, ndryshimin e kualifikimit ligjor të faktit penal, deklarimin fajtor të të pandehurit A.B, për kryerjen e veprës penale “<i>Shpërdorimi i detyrës</i>”, parashikuar nga		
--	--	--	--	---	--	--

				neni 248 i Kodit Penal, dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me 4 (katër) vite burgim. • Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit A.B i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 2 (dy) vite e 8 (tetë) muaj burgim. • Llogaritja e dënimit fillon nga data e arrestimit dhe dënimi me burgim nga i pandehuri A.B do të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme, në referim të parashikimeve të nenit 18, të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”. • Në zbatim të nenit 35 pg 1 të Kodit Penal, të pandehurit A.B i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 5 (pesë) vitesh. • Në bazë të nenit 274 dhe 190 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 36 të Kodit Penal, konfiskimin dhe kalimin në favor të shtetit, të pasurisë së paluajtshme me nr. ****, vol ****, faqe ****, Zona Kadastrale ****, lloji i pasurisë “njësi”, me sipërfaqe 789 m2, me vendndodhje në ****, në pronësi të shtetasit L.K, sekuestruar nëpërmjet vendimit për caktimin e masës së sigurimit pasuror		
--	--	--	--	---	--	--

				“sekuestro preventive” me nr. 134, datë 28.03.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, <i>deri në vlerën që i korrespondon asaj të produktit të veprës penale, sipas pjesës arsyetuese të vendimit.</i> Me vendimin nr. 61, datë 05.10.2023 GJKKO ka vendosur: • Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit L.K për kryerjen e veprës penale “<i>Shpërdorimi i detyrës</i>”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248-25 të Kodit Penal për shkak se në bazë të nenit 388/1/b të K.Pr.Penale fakti nuk përbën vepër penale. • Deklarimin fajtor të të pandehurit L.K për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë</i>”, parashikuar nga neni 260 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 vjet burgim. • Deklarimin fajtor të të pandehurit L.K për kryerjen e veprës penale “<i>Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale</i>”, e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 287/2 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 8 vjet burgim.	
--	--	--	--	---	--

				• Në aplikim të nenit 55 të K.Penal, në bashkim të dënimeve, i pandehuri L.K dënohet me 8 vjet e 6 muaj burgim. • Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit L.K i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 5 vjet e 8 muaj burgim. • Vuajtja e dënimit fillon nga momenti i arrestimit, datë 14.12.2021 dhe do të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme. • Në aplikim të nenit 35/1 të K.Penal të pandehurit L.K i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një periudhë prej 5 vitesh. • Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit A.B për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248-25 të Kodit Penal për shkak se në bazë të nenit 388/1/b të K.Pr.Penale fakti nuk përbën vepër penale. • Në bazë të nenit 261/1 dhe 389 të K.Pr.Penale deklarohet shuarja e masës së sigurimit “Arresti në burg”, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale dhe caktuar ndaj të pandehurit A.B me anë të vendimit Nr.35, datë 24.11.2022 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe		
--	--	--	--	--	--	--

				Krimin e Organizuar dhe lirimi i menjëherëshëm i të pandehurit A.B nga ambientet e IEVP, nëse nuk mbahet i arrestuar, i ndaluar, apo i dënua për ndonjë vepër tjetër penale. • Në bazë të nenit 274 dhe 190 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 36 të Kodit Penal, konfiskimin dhe kalimin në favor të shtetit të pasurive për të cilat është caktuar masa e sigurimit pasuror “sekuestro preventive” nëpërmjet vendimit me Nr.484, datë 13.12.2021 dhe Nr.130, datë 28.03.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe konkretisht: ○ Shoqëria tregtare “*****” sh.p.k, me Nipt ****, me seli qendrore në ****, së bashku me pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi të saj. ○ Shoqëria tregtare “*****” sh.p.k, me Nipt ****, me seli qendrore në ****, së bashku me pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi të saj. ○ Aksionet në zotërim të shtetasit L.K në shoqërinë tregtare “*****” sh.a, me Nipt ****, me seli në **** deri në vlerën që i korrespondon asaj të produktit të veprës penale, sipas pjesës arsyetuese të vendimit. ○ Shoqëria tregtare “*****” sh.p.k, me Nipt		
--	--	--	--	--	--	--

				****, me seli në ****; ○ Shoqëria tregtare “****” sh.p.k, me Nipt ****, me seli në ****. Me vendimin nr. 62, datë 06.10.2023 GJKKO ka vendosur: • Deklarimin fajtor të të pandehurit F.T për kryerjen e veprës penale të “<i>Shpërdorim i detyrës</i>”, e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim. • Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit F.T i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 1 (një) vit burgim. • Vuajta e dënimit i ka filluar të pandehurit F.T më datë 13.07.2023 ditën e ekzekutimit të masës së sigurimit personal “Arrest në burg” dhe për pjesën e mbetur do të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme. • Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit F.T i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 5 (pesë) vitesh. Me vendimin nr. 80, datë 01.12.2023		
--	--	--	--	---	--	--

				GJKKO ka vendosur: • Deklarimin fajtor të të pandehurit N.D, për kryerjen e veprës penale të “<i>Shpërdorimit të detyrës</i>” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 e 25 i K.Penal dhe dënimin e tij me 9 (nëntë) muaj burgim. • Deklarimin fajtor të të pandehurit N.D, për kryerjen e veprës penale të “<i>Falsifikimit të dokumentave</i>” nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, parashikuar nga neni 186 paragrafi i tretë i K.Penal, dhe dënimin e tij 1 (një) vit burgim. • Në aplikim të nenit 55 të K.Penal, bashkimin e dënimeve, duke u dënuar i pandehuri N.D, me 1 (një) vit burgim. • Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, të pandehurit N.D i ulet 1/3 e dënimit duke e dënuar përfundimisht me 8 (tetë) muaj burgim. • Në aplikim të nenit 59 të K.Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për të pandehurin N.D dhe vënien e tij në provë për një periudhë prej 1 (një) vit e 4 (katër) muaj, me kusht që gjatë kohës së provës i pandehuri të mos kryejë veprë tjetër penale dhe gjatë kësaj kohe i pandehuri detyrohet të mbajë kontakte me Drejtorinë e Shërbimit të Provës që	
--	--	--	--	--	--

				mbulon vendbanimin e tij nga e nesërnia e shpalljes së këtij vendimi. Me vendimin nr. 86, datë 27.12.2023 GJKKO ka vendosur: • Deklarimin fajtor të të pandehurit L.A për kryerjen e veprës penale “<i>Shkeljes së barazisë së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike</i>” parashikuar nga neni 258 (para ndryshimeve të vitit 2021) dhe 25 të Kodit Penal dhe bazuar në këtë dispozitë dënimin e tij me 1 (një) vit e 9 (nëntë) muaj burgim. • Deklarimin fajtor të të pandehurit L.A për kryerjen e veprës penale “Shpërdorim i detyrës” parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal, dhe bazuar në këtë dispozitë dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim. • Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal bashkimin e dënimeve duke e dënuar të pandehurin L.A me 3 (tre) vjet burgim. • Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale uljen e dënimit me 1/3 duke e dënuar përfundimisht të pandehurin L.A me 2 (dy) vjet burgim. • Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal heqjen e të drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin L.A		
--	--	--	--	---	--	--

				për një periudhë kohe prej 5 (pesë) vjet. • Vuajtja e dënimit fillon nga dita e ndalimit më datë 16.03.2023 dhe referuar ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, duhet të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme. • Deklarimin fajtor të të pandehurës E.L për kryerjen e veprës penale “Shkeljes së barazisë së barazisë së pjesëmarrësve në tender apo ankande publike” parashikuar nga neni 258 (para ndryshimeve të vitit 2021) dhe 25 të Kodit Penal dhe bazuar në këtë dispozitë dënimin e saj me 1 (një) vit e 9 (nëntë) muaj burgim. • Deklarimin fajtor të të pandehurit E.L për kryerjen e veprës penale “Shpërdorim i detyrës” parashikuar nga nenet 248 dhe 25 i Kodit Penal, dhe bazuar në këtë dispozitë dënimin e saj me 2 (dy) vjet burgim. • Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal bashkimin e dënimeve duke e dënuar të pandehurën E.L me 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim. • Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale uljen e dënimit me 1/3 duke e dënuar përfundimisht të pandehurën E.L me 1 (një) vit e 8 (tetë) muaj burgim.		
--	--	--	--	--	--	--

				• Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për të pandehurën E.L duke e vënë në provë për një periudhë kohe prej 3 (tre) vjet e 4 (katër) muaj. • Urdhërohet e pandehura që gjatë kohës së proves të mos kryejë vepër tjetër penale dhe të mbaj kontakte me Shërbimin e Provës. • Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal heqjen e të drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurën E.L për një periudhë kohe prej 5 (pesë) vjet. Viti 2024 Me vendimin nr. 6, datë 25.01.2024 GJKKO ka vendosur: • Deklarimin fajtor të të pandehurit K.H për kryerjen e veprës penale “<i>Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve</i>”, parashikuar nga neni 190/2 të K.Penal dhe dënimin e tij me 9 muaj burgim. • Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit K.H i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 6 muaj burgim. • Në aplikim të nenit 63 të K.Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të	
--	--	--	--	---	--

				vendimit me burgim ndaj të pandehurit K.H duke bërë zëvendësimin e tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik, pa shpërblim. • Urdhërohet i pandehuri K.H të kryejë 150 orë punë në interes publik dhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës. • Detyrimi për kryerjen e punës në interes publik duhet të përmbushet brenda 6 (gjashtë) muajve. Me vendimin nr. 8, datë 07.02.2024 GJKKO ka vendosur: • Deklarimin fajtor të të pandehurit S.G për kryerjen e veprës penale “<i>Shpërdorim detyre</i>” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe bazuar në këtë dispozitë dënimit e tij me 3 (tre) vjet burgim. • Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale uljen e dënimit me 1/3 duke u dënuar përfundimisht i pandehuri S.G me 2 (dy) vjet burgim. • Vuajtja e dënimit për të pandehurin S.G fillon nga data e ndalimit më datë 24.06.2023 dhe referuar ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, duhet të kryhet në një institucion të sigurisë së zakonshme.		
--	--	--	--	--	--	--

				• Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit S.G i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh. Me vendimin Nr. 13, datë 01.03.2024 GJKKO ka vendosur: • Deklarimin fajtor të të pandehurit F.F, për kryerjen e veprës penale “<i>Shpërdorimi i detyrës</i>” e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me 2 (dy) vite burgim. • Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale masës së mësipërme të dënimit i zbritet 1/3 duke u dënuar përfundimisht i pandehuri F.F me 1 (një) vit dhe 4 (katër) burgim. • Vuajtja e dënimit për të pandehurin F.F do të fillojë nga dita e marrjes formë të prerë të këtij vendimi dhe do të kryhet në një IEVP, burg i sigurisë së zakonshme. • Në zbatim të nenit 35 të K.Penal, heqjen e të drejtës për të pandehurin F.F për të ushtruar funksione publike për një afat kohor 5 vjeçar. Me vendimin Nr. 14, datë 05.03.2024 GJKKO ka vendosur: • Deklarimin fajtor të të pandehurit D.B, për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsioni</i>	
--	--	--	--	---	--

				<i>aktiv në zgjedhje</i>” kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 328 e 25 të Kodit Penal dhe në bazë të këtyre dispozitave, dënimin e tij me 2 (dy) vite burgim. • Vuajtja e dënimit për të pandehurin D.B, fillon nga dita e arrestimit të tij dt. 12.05.2023 dhe të kryhet në një IEVP, burg i sigurisë së zakonshme. Me vendimin Nr. 38, datë 13.06.2024 GJKKO ka vendosur: • Deklarimin fajtor të të pandehurës L.M, për veprën penale “<i>Shpërdorim i detyrës</i>” dhe bazuar në nenet 248, 49 të Kodit Penal, dënimin e saj me 1 (një) vjet burgim. • Në bazë të nenit 406 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurës L.M i ulet 1/3 e dënimit, për shkak të aplikimit të gjykimit të shkurtuar dhe përfundimisht dënohet me 8(tetë) muaj burgim. • Vuajtja e dënimit fillon nga dita e ekzekutimit të këtij vendimi të formës së prerë, dhe të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme. • Bazuar në nenin 35 paragrafi 2 të Kodit Penal, heqjen e së drejtës së të pandehurës L.M për të ushtruar funksione publike për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh.	
--	--	--	--	--	--

				Me vendimin nr. 65, datë 03.07.2024 GJKKO ka vendosur: • Caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, ndaj personit nën hetim I.B, i hetuar për kryerjen e veprave penale “<i>Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërore</i>” në bashkëpunim parashikuar nga neni 260 dhe 25 i Kodit Penal; “<i>Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim</i>” parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal “<i>Mashtrim</i>”, në bashkëpunim, me pasoja të rënda parashikuar nga nenet 143/2/3 i Kodit Penal, si dhe “<i>Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike</i>”, në bashkëpunim parashikuar nga neni 258/2 dhe 25 i Kodit Penal. Me vendimin Nr. 67, datë 03.07.2024 GJKKO ka vendosur: • Caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, ndaj personit nën hetim J.G, i dyshuar për kryerje të veprës penale “<i>Shpërdorimi i detyrës</i>”, parashikuar nga neni 248 i Kodit		
--	--	--	--	---	--	--

				Penal. *Aktualisht pranë kësaj gjykate po shqyrtohet në seancë paraprake (nr. 69 regj.them, datë regjistrimi 05.02.2025) kërkesa e Prokurorisë për dërgimin e çështjes në gjyq që i përket procedimit penal nr. 127/2024, në ngarkim të të pandehurve J.G, etj., i akuzuar për veprën penale “<i>Shpërdorim detyre</i>”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248-25 te Kodit Penal. Me vendimin Nr. 112, datë 06.09.2024 GJKKO ka vendosur: • Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “<i>Arrest në shtëpi</i>”, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, për shtetasin R.B, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “<i>Shpërdorimi i detyrës</i>”, e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 248 e 25 të Kodit Penal. *Aktualisht pranë kësaj gjykate po shqyrtohet në seancë paraprake (nr. 80 regj.them, datë regjistrimi 03.03.2025) kërkesa e Prokurorisë për dërgimin e çështjes në gjyq që i përket procedimit penal nr. 1, të vitit 2024, në ngarkim të të pandehurve R.B, etj., i akuzuar për veprën penale “<i>Shpërdorim detyre</i>” (më shumë se një herë sipas fakteve penale të përshkruara		
--	--	--	--	---	--	--

				në akuzë) kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248-25 të Kodit Penal. Me vendimin Nr. 56, datë 09.10.2024 GJKKO ka vendosur: • Deklarimin fajtor të të pandehurit F.T, për kryerjen e veprës penale “<i>Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim</i>”, në formën e fshehjes, parashikuar nga neni 257/a, paragrafi i dytë i K.Penal dhe në bazë të kësaj dispozite, dënimit e tij me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim. • Në zbatim të nenit 406 të K.Pr.Penale, uljen e dënimit me 1/3 e tij, duke u dënuar përfundimisht i pandehuri F.T me 1 (një) vit burgim. • Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim për të pandehurin F.T, për një periudhë kohore prej 2 (dy) vjet, me kusht që gjatë kohës së provës i pandehuri të mbajë kontakte me shërbimin e provës të vendbanimit të tij, si dhe të mos kryejë veprë penale tjetër. • Konfiskimin e pasurisë së llojit		
--	--	--	--	--	--	--

				“apartament”, me nr. pasurie ****, Z.K. ****, në ****, sekuestruar me vendimin nr. 136, datë 29.02.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe kalimin e kësaj pasurie në favor të shtetit. Me vendimin nr.125, datë 20.10.2024 GJKKO ka vendosur: • Caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, ndaj personit nën hetim I.M, i dyshuar për kryejën e veprave penale; <i>“Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”</i> në 3 (tre) raste nga të cilat në dy raste është kryer në bashkëpunim, <i>“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”</i> e kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një here, dhe <i>“Refuzimi për deklaram, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, ose i cdo personi që ka detyrimin ligjor për deklaram”</i> parashikuar nga nenet 260 dhe 25, 287/2 dhe 257/a/2 i K.Penal. Me vendimin nr.125, datë 20.10.2024 GJKKO ka vendosur: • Caktimin e masës së sigurimit personal		
--	--	--	--	---	--	--

				“Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, ndaj personit nën hetim, M.K, e dyshuar për kryerjen e veprave penale; <i>“Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”</i> në 2 (dy) raste dhe në bashkëpunim, <i>“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”</i> e kryer në bashkëpunim, dhe <i>“Refuzimi për deklaram, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, ose i cdo personi që ka detyrimin ligjor për deklaram”</i> parashikuar nga nenet 260 dhe 25, 287/2 dhe 257/a/2 i K.Penal. Me vendimin nr. 126, datë 20.10.2024 GJKKO ka vendosur: • Caktimin e masës së sigurimit <i>“Arrest në burg”</i> parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale ndaj personit nën hetim J.Ç, si i dyshuar për kryerjen e veprave penale <i>“Tregimi i sekretit shtetëror nga shtetasit”</i>, kryer më tepër se një herë (sipas episodeve respektive), parashikuar nga neni 295/1 i Kodit Penal, <i>“Përkrahja e autorit të krimit”</i>, kryer më tepër se një herë (sipas episodeve respektive), parashikuar nga neni 302/1/2 i Kodit Penal, <i>“Tregimi i sekretit shtetëror nga</i>	
--	--	--	--	---	--

				<i>shtetasit</i>”, kryer në bashkëpunim me të hetuarin A.M, parashikuar nga nenet 295/1 dhe 25 të Kodit Penal, “<i>Përkrahja e autorit të krimit</i>”, kryer në bashkëpunim me të hetuarin A.M, parashikuar nga nenet 302/1 dhe 25 të Kodit Penal, si dhe “<i>Korrupsioni aktiv në zgjedhje</i>”, parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal. Me vendimin Nr. 114, datë 15.11.2024 GJKKO ka vendosur: • Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. • Dërgimin për gjykim të çështjes penale hetuar në kuadër të procedimit penal nr. 189 i vitit 2023 i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në ngarkim të të pandehurve J.G, etj..., i akuzuar për kryerjen e veprave penale “<i>Shpërdorimi i detyrës</i>” 2 herë, dhe “<i>Refuzimi për deklaram, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nënpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrim ligjor për deklaram</i>” të parashikuara nga nenet 248 e 25 dhe 257/a paragrafi 2 i K.Penal. Me vendimin nr. 70, datë 25.11.2024		
--	--	--	--	--	--	--

				GJKKO ka vendosur: • Deklarimin fajtor të të pandehurit V.D për kryerjen e veprës penale “<i>Shpërdorimi i detyrës</i>”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248-25 i K.Penal për faktin penal të ndërtimit të pallatit të ndërtuar nga shoqëria “Fakle” sh.p.k. dhe dënimin e tij me 2 vite e 9 muaj burgim. • Deklarimin fajtor të të pandehurit V.D për kryerjen e veprës penale “<i>Shpërdorimi i detyrës</i>”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248-25 i K.Penal faktin penal të projekt zbatimit të promenadës bregdetare dhe dënimin e tij me 2 vite e 4 muaj burgim. • Në aplikim të nenit 55 të K.Penal, në bashkim të dënimeve, i pandehuri V.D dënohet me 4 vite burgim. • Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit V.D i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 2 vite e 8 muaj burgim. • Vuajtja e dënimit fillon nga momenti i ekzekutimit të vendimit dhe do të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme, ku në përlllogaritje do të mbahet në konsideratë fakti që i pandehuri nga data 06.06.2023-27.02.2024 ka qenë me masë sigurimi		
--	--	--	--	---	--	--

				“Arresti në burg” dhe nga data 27.02.2024 vijon të jetë me masë sigurimi “Arresti në shtëpi”. • Në aplikim të nenit 35/1 të K.Penal të pandehurit V.D i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një periudhë prej 5 vitesh. Me vendimin nr. 674, datë 27.11.2024 GJKKO ka vendosur: • Pranimin e kërkesës së kërkuesit/pandehurit S.B, me objekt: “<i>Revokimin e masës së sigurimit personal</i>”. • Revokimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “<i>arrest në shtëpi</i>”, parashikuar nga neni 237 të K.Pr.Penale ekzekutuar ndaj kërkuesit/pandehurit Sali Berisha, i akuzuar se ka kryer veprën penale “<i>Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendor</i>”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 260 e 25 të K.Penal, caktuar kjo masë me vendimin nr. 520, datë 30.12.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, lënë në fuqi me vendimin nr. 15, datë 25.01.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar,	
--	--	--	--	--	--

				për shkak se nuk ekzistojnë më nevojat e sigurimit. *Aktualisht pranë kësaj gjykate po shqyrtohet në seancë paraprake (nr. 26 regj.them, datë regjistrimi 15.10.2024) kërkesa e Prokurorisë për dërgimin e çështjes në gjyq që i përket procedimit penal nr. 287/2020, në ngarkim të të pandehurve S.B, etj., i akuzuar për kryerjen e veprës penale <i>“Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose të zgjedhurve vendorë”</i>, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 260 e 25 i Kodit Penal. Me vendimin nr. 106, datë 13.12.2024 GJKKO ka vendosur: • Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 255/1 të vitit 2020 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ndaj të pandehurve L.K, etj., i akuzuar për kryerjen e veprës penale <i>“Shpërdorimi i detyrës”</i>, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal. Viti 2025 Me vendimin Nr. 6, datë 15.01.2025 GJKKO ka vendosur: • Deklarimin fajtor të të pandehurës R.B, për veprën penale <i>“Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande</i>		
--	--	--	--	---	--	--

				<i>publike</i>”, në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 258, (para ndryshimeve të pësuara me ligjin nr. 43/2021, datë 23.3.2021) dhe 25 të Kodit Penal, dhe dënimin e saj 1(një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim. • Deklarimin fajtor të të pandehurës R.B, për veprën penale “<i>Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike</i>”, në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 258, (para ndryshimeve të pësuara me ligjin nr. 43/2021, datë 23.3.2021) dhe 25 të Kodit Penal, dhe dënimin e saj me 1(një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim. • Në bashkim të dënimeve, sipas nenit 55 paragrafi 1 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurës R.B me një dënim të vetëm prej 2(dy) vjetësh burgim. • Në bazë të nenit 406 pika 1 të Kodit të Proçedurës Penale, të pandehurës R.B, i ulet 1/3 e dënimit, për shkak të aplikimit të gjykimit të shkurtuar dhe, përfundimisht dënohet me 1 (një) vit e 4 (katër) muaj burgim. • Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për të pandehurën R.B, dhe vënien e saj në provë për një periudhë prej 2 (dy) vjet e 8(tetë) muaj, me kusht që		
--	--	--	--	--	--	--

				e pandehura gjatë periudhës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e saj. Afati i provës fillon nga e nesërmja e shpalljes së vendimit për pezullimin e dënimit me burgim. • Heqjen e së drejtës për të pandehurën R.B për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 5 (pesë) vjet, bazuar në nenin 35 paragrafi 2, të Kodit Penal. Me vendimin nr. 13, datë 23.01.2025 GJKKO ka vendosur: • Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 13, të vitit 2020 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, në ngarkim të të pandehurës: • I.B, i akuzuar për kryerjen e veprave penale të “<i>Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën</i>”, kryer në bashkëpunim të posaçëm, atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 135, 28/4 e 334/1 të Kodit Penal; “<i>Grupi i strukturuar kriminal</i>”, parashikuar nga neni 333/a/1 të Kodit Penal. • K.R, akuzuar për kryerjen e veprave penale të “<i>Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën</i>”, kryer në bashkëpunim të		
--	--	--	--	--	--	--

				posaçëm, atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 135, 28/4 e 334/1 të Kodit Penal; “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a/1 të Kodit Penal, dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 186/3 e 25 të Kodit Penal; etj... Me vendimin Nr. 8, datë 24.01.2025 GJKKO ka vendosur: • Deklarimin fajtor të të pandehurit E.M për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsioni aktiv në zgjedhje</i>” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 328 dhe 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim. • Dënimi të fillojë nga dita e ekzekutimit të vendimit penal dhe të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme. • Në zbatim të nenit 35 të K.Penal, heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin E.M për një periudhë 5 (pesë) vjeçare. Me vendimin Nr. 7, datë 09.02.2025 GJKKO ka vendosur: • Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “<i>Arrest në burg</i>”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të	
--	--	--	--	---	--

				Procedurës Penale, për shtetasin nën hetim E.V, me detyrë, Kryetar i Bashkisë X, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të <i>“Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”</i>, kryer në bashkëpunim (9 herë) dhe <i>“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”</i>, parashikuar nga neni 260 e 25 dhe 287/2 i Kodit Penal. Me vendimin Nr. 14, datë 10.02.2025 GJKKO ka vendosur: • Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit E.D, për kryerjen e veprës penale të <i>“Shpërdorimi i detyrës”</i>, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal, pasi në bazë të nenit 388 pika 1 gërma b) e K.Pr.Penale, “fakti nuk përbën vepër penale”. Me vendimin Nr. 18, datë 27.02.2025 GJKKO ka vendosur: • Deklarimin fajtor të të pandehurit E.K për veprën penale <i>“Shpërdorimi i detyrës”</i> të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 248 e 25 të K.Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim. • Në bazë të nenit 406, pika 1, të K.Pr.Penale, të pandehurit E.K i ulet 1/3 e dënimit dhe dënohet përfundimisht me 1	
--	--	--	--	--	--

				(një) vit burgim. • Në bazë të nenit 59 të K.Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia e të pandehurit E.K në provë, për një afat prove prej 2 (dy) vjet, gjatë së cilës i pandehuri duhet të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të mos kryejë vepër tjetër penale. • Bazuar në nenin 60, paragrafi i parë, pika 9, të K.Penal, urdhërohet i pandehuri që brenda periudhës së provës të mos shoqërohet me persona të dënuar për vepra penale. • Afati i provës fillon pas marrjes formë të prerë të vendimit, nga momenti i kontaktit të parë të të pandehurit me shërbimin e provës. • Heqjen e së drejtës të pandehurit E.K për të ushtruar funksione publike, për një kohë prej 5 (pesë) vjet, bazuar në nenin 35, paragrafi i parë, të K.Penal, zbatimi i të cilit fillon me marrjen formë të prerë (i ekzekutueshëm) të këtij vendimi. *Aktualisht pranë kësaj gjykate po shqyrtohet në seancë paraprake (nr. 7/34/124 regj.them, datë regjistrimi 21.12.2023) kërkesa e Prokurorisë për dërgimin e çështjes në gjyq që i përket procedimit penal nr. 154/2022, në ngarkim të të pandehurit		
--	--	--	--	---	--	--

				A.A, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “<i>Shpërdorim detyre</i>”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. *Aktualisht pranë kësaj gjykate po shqyrtohet në seancë paraprake (nr. 41/155 regj.them, datë regjistrimi 25.11.2024) kërkesa e Prokurorisë për dërgimin e çështjes në gjyq që i përket procedimit penal nr. 240/2021, në ngarkim të të pandehurit P.N, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “<i>Shkelje e barazise se pjesëmarrësve ne tendera apo ankande publike</i>”, parashikuar nga neni 258 (para ndryshimeve ligjore me ligjin nr. 43/2021) e 25 të Kodit Penal. *Aktualisht pranë kësaj gjykate po shqyrtohet në seancë paraprake (nr. 43/158 regj.them, datë regjistrimi 02.12.2024) kërkesa e Prokurorisë për dërgimin e çështjes në gjyq që i përket procedimit penal nr. 28/2024, në ngarkim të të pandehurit A.D, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “<i>Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim</i>”, parashikuar nga neni 257/a, paragrafi i dytë i K.Penal. *Aktualisht pranë kësaj gjykate po shqyrtohet në seancë paraprake (nr. 77		
--	--	--	--	--	--	--

				regj.them, datë regjistrimi 24.02.2025) kërkesa e Prokurorisë për dërgimin e çështjes në gjyq që i përket procedimit penal nr. 139/2024, në ngarkim të të pandehurit B.S, i akuzuar për kryerjen e veprës penale <i>“Pengime për ekzekutimin e vendimit të gjykatës”</i>, parashikuar nga neni 320 te Kodit Penal. *Aktualisht pranë kësaj gjykate po shqyrtohet në seancë paraprake (nr. 19/99 regj.them, datë regjistrimi 22.07.2024) kërkesa e Prokurorisë për dërgimin e çështjes në gjyq që i përket procedimit penal nr. 152/2020, në ngarkim të të pandehurit L.H, i akuzuar për veprën penale <i>“Shpërdorim detyre”</i>, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal. Me vendimin Nr. 22, datë 11.03.2025 GJKKO ka vendosur: • Deklarimin fajtor të të pandehurit A.B, për kryerjen e veprës penale <i>“Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”</i>, dhe në bazë të nenit 259 (para ndryshimeve të pësuara me ligjin nr.43, datë 23.03.2021) të Kodit Penal, dënimin e tij me 3(tre) vjet burgim. • Deklarimin fajtor të të pandehurit A.B, për kryerjen e veprës penale <i>“Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”</i>, dhe në bazë të nenit 259 (para	
--	--	--	--	--	--

				ndryshimeve të pësura me ligjin nr.43, datë 23.03.2021) të Kodit Penal, dënimin e tij me 3(tre) vjet e 6(gjashtë) muaj burgim. • Në bashkim të dënimeve, sipas nenit 55 paragrafi 1 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit A.B me një dënim të vetëm me 4 (katër) vjet burgim. • Në bazë të nenit 406 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit A.B i ulet 1/3 e dënimit, për shkak të aplikimit të gjykimit të shkurtuar dhe përfundimisht dënohet 2(dy) vjet e 8(tetë) muaj burgim. • Vuajtja e dënimit fillon nga dita e arrestimit datë 09.12.2023, dhe të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme. • Heqjen e së drejtës së të pandehurit A.B për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 5 (pesë) vjet, bazuar në nenin 35 paragrafi 2, të Kodit Penal.		
16.	04.03.2025	Kërkesë për vënie në dispozicion të vendimit. ... Në këto kushte, duke qenë se nga ana jonë, nuk ka qenë i mundur aksesimi i vendimit nr. 7, datë 09.02.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për	07.03.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për t'ju vënë në dispozicion vendimin nr. 7, datë 09.02.2025 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO), protokolluar në gjykatë me nr. 900 prot., datë 03.03.2025 dhe rregjistruar me datë 04.03.2025, me nr. rendor 16 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, në zbatim të ligjit nr. 119/2014,	Përfunduar Refuzuar (Kthyer përgjigja me shkresën nr. 900/1 prot., datë 07.03.2025.)	Nuk ka

		Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në formë zyrtare, po paraqesim këtë kërkesë përpara jush, duke kërkuar që brenda kuadrit ligjor të mund të na vendosni në dispozicion ne ose Gjykatës Administrative të Apelit, këtë vendim i cili është tepër i rëndësishëm për procesin gjyqësor administrativ që po zhvillohet me palë të paditur shoqërinë “*****” shpk.		<i>“Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë:</i> Në nenin 105 të K.Pr.Penale nën titullin “Marrja e kopjeve, ekstrakteve dhe vërtetimeve” parashikohet shprehimisht se: <i>“1. Gjatë procedimit dhe pas përfundimit të tij, cilido që ka interes mund të marrë, me shpenzimet e veta, kopje, ekstrakte ose vërtetime të akteve të veçanta apo të regjistrimeve audio ose audiovizive. 2. Kërkesa shqyrtohet nga prokurori, për aktet e hetimit paraprak, ose nga gjykata që ka dhënë vendimin për ato të shqyrtimit gjyqësor. 3. Lëshimi i kopjeve, ekstrakteve ose vërtetimeve nuk e heq ndalimin e publikimit”.</i> Po ashtu, sipas Udhëzuesit Standart të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median, miratuar me Vendimin Nr. 716, datë 06.12.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në nenin 12 nën titullin “Aksesi në dosjet gjyqësore”, në pikën 1 të tij, parashikohet shprehimisht se: <i>“Dosjet gjyqësore aksesohen në çdo kohë nga palët në proces, përfaqësuesit ligjorë të tyre, gjyqtari apo trupa gjykuese e çështjes, prokurori/ët i/e çështjes, si dhe çdo person ose institucion publik tjetër i autorizuar sipas ligjit”.</i> Në interpretim të dispozitave më sipër,	
--	--	---	--	--	--

				vlerësojmë se, subjektet e legjitimuara për të marrë kopje, ekstrakte ose vërtetime të akteve të veçanta nga dosjet gjyqësore janë palët në proces, përfaqësuesit ligjorë të tyre, gjyqtari apo trupa gjykuese e çështjes, prokurori/ët i/e çështjes, si dhe çdo person ose institucion publik tjetër i autorizuar sipas ligjit. Në këto kushte, çmojmë se, Shoqëria “*****” shpk, nuk përfshihet në rrethin e subjekteve proceduriale që legjitimohen për të marrë kopje të vendimit nr. 7, datë 09.02.2025 të GjKKO-së (Caktim mase sigurimi). Përveç sa më sipër, në nenin 17 pika 2, gërma “b” të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: <i>“2. E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm: ... b) parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale.”.</i> Në kushtet që, procedimi penal nr. 27 i viti 2024, rregjistruar nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në ngarkim të personave nën hetim E.V, A.X, etj., aktualisht ndodhet në fazën e hetimeve paraprake, vlerësojmë se vënia në dispozicion e vendimit nr. 7, datë		
--	--	--	--	--	--	--

				09.02.2025 të GJKKO-së, Shoqërisë “****” Shpk do të shkaktonte dëm ndaj hetimit të këtij procedimi penal. Për arsyet e sipërcituara refuzojmë kërkesën tuaj për t’ju vënë në dispozicion vendimin nr. 7, datë 09.02.2025 të GJKKO-së.		
17	04.03.2025	Kërkesë për informacion: Në njoftimin për shtyp të datës 16.03.2023, publikuar në faqen zyrtare të SPAK në lidhje me hetimet në kuadër të procedimit penal nr. 9, të vitit 2022, për veprat penale “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, “Shpërdorimi i detyrës”, “Falsifikimi i dokumentave”, “Falsifikimi i formularëve”, parashikuar nga nenet 258 paragrafi i dytë, 248, 186/2,3, 190/1 të Kodit Penal, ndër të tjera thuhet: “Gjithashtu me vendimin nr. 21, datë 14.03.2023 Gjykata ka caktuar masën e sigurimit “arrest në shtëpi”, për shtetasit: K.I, si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i formularëve”, parashikuar	07.03.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 17, datë 04.03.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “<i>Për të drejtën e informimit</i>”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Me vendimin nr. 125, datë 15.12.2023, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO) ka vendosur: “1. Deklarimin e moskompetencës lëndore lidhur me gjykimin e çështjes penale me nr. 125 regj themeltar në ngarkim të të pandehurve A.N, akuzuar për kryerjen e veprës penale “<i>Falsifikim i dokumenteve</i>”, nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, kryer në bashkëpunim e më shumë se një here, parashikuar nga neni 186/3 dhe 25 i Kodit Penal dhe K.I, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “<i>Falsifikim i vulave, stampave ose formularëve</i>”, parashikuar nga neni 190 pika 1 i Kodit Penal. 2. Dërgimin e akteve për kompetencë lëndore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të	Përfunduar Dërguar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. (E-mail)	Nuk ka

		nga neni 190/1 i Kodit Penal”. • Sa më lart kërkojmë të dimë, aktualisht a vazhdon të jetë ky shtetas në masën “arrest shtëpi”? • Nëse jo, deri në cilën datë e ka pasur këtë masë në fuqi? • A ka një masë tjetër ndaj këtij shtetasi në fuqi?		Përgjithshëm Dibër”. Në përmbajtje të këtij vendimi citohet se, i pandehuri K.I është hetuar me masë sigurimi “arrest në shtëpi”. Me shkresën nr. 72 prot., datë 08.01.2024 Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar i ka dërguar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dosjen penale me nr. 125, datë 15.12.2023, në ngarkim të të pandehurve A.N dhe K.I. Për sa më sipër, kjo gjykatë nuk disponon informacion nëse shtetasi K.I vijon të jetë me masën e sigurimi personal “arrest në shtëpi”. Në zbatim të nenit 12, pika 2 të ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: <i>“Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuar. Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar”</i>, kërkesa juaj për informacion i është dërguar ditën e sotme autoritetit publik kompetent, konkretisht Gjykatës së Shkallës së Parë të	
--	--	--	--	--	--

				Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Po ashtu, në referim të nenit 12, pika 3 të ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se: “Autoriteti publik, të cilit i është drejtuar kërkesa për informim, njofton kërkuuesin se kërkesa e tij i është dërguar një autoriteti tjetër, si dhe e informon atë për kontaktet e autoritetit ku është dërguar kërkesa.”, po ju dërgojmë email-in e kontaktit dhe numrin e telefonit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, të publikuar në faqen zyrtare gjykata.gov.al si dhe adresën e institucionit. Email: kontakt.gjykatarrethitdiber@gjykata.gov.al Tel: 0035521822507 Adresa: Rruga “Tercilio Kardinali”, Peshkopi 8301, Shqipëri.		
18.	01.04.2025	Kërkesë për vënie në dispozicion të CD-ve audio, vendimeve gjyqësore dhe intervistë: Në kuadër të përgatitjes së një dokumentari investigativ për emisionin **** në ****, me temë “Bashkëpunëtorët e	04.04.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 18, datë 01.04.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: 1. Vendimi nr. 38, datë 22.09.2006 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë;	Përfunduar (Email dhe kopje të CD-së)	60 lekë

		Drejtësisë”, ju kërkojmë vënien në dispozicion të materialeve si më poshtë: 1. CD audio me dëshmitë e dhëna nga të pandehurit bashkëpunëtorë të drejtësisë. 2. Vendimet gjyqësore për personat e mëposhtëm: • J.S • M.Sh • E.B • L.R • E.Sh • E.J • E.J • B.B • A.Ç • P.L Gjithashtu, në kuadër të trajtimit të kësaj teme, kërkojmë mundësinë e realizimit të një interviste me Kryetarin e Gjykatës, z. E.B, për të diskutuar mbi rolin e bashkëpunëtorëve të drejtësisë në hetimet dhe proceset gjyqësore në Shqipëri. Duke qenë se dokumentari synon të hedhë dritë mbi këtë mekanizëm dhe ndikimin e tij në zbardhjen e ngjarjeve		2. Vendimi nr. 70, datë 20.12.2011 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë; 3. Vendimi nr. 1, datë 16.01.2012 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë; 4. Vendimi nr. 45, datë 16.07.2012 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë; 5. Vendimi nr. 99, datë 14.07.2016 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë; 6. Vendimi nr. 67, datë 05.06.2018 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë; 7. Vendimi nr. 24, datë 19.04.2023 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; 8. Vendimi nr. 5, datë 24.01.2024 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; 9. Vendimi nr. 49, datë 31.07.2024 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, do ju vihen në dispozicion në formatin që ju dëshironi, në CD ose kopje fizike në fletë A4, pasi të bëni pagesën e tarifës përkatëse, në zbatim të Urdhërit Nr. 86, datë 17.04.2015 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave	
--	--	--	--	--	--

		kriminale, vlerësojmë maksimalisht ndihmën dhe bashkëpunimin tuaj në sigurimin e këtyre materialeve dhe intervistës.		Personale “<i>Për tarifat e dhënies së informacionit (dokumentacionit) të kërkuar</i>” (60 lekë për CD dhe 5 lekë për fletë për formatin A4), pasi për shkak të ngarkesës së dokumenteve e kemi të pamundur t’ju dërgojmë në email. Për të marrë kopjen e vendimeve të sipërcituara mund të paraqiteni në ambientet e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çdo ditë, nga e Hëna në të Premte, ora 08:00-16:00. Sa i përket vendimit gjyqësor për të pandehurin L.R, ju bëjmë me dije se dosja penale në ngarkim të të pandehurve L.R, etj., vijon të shqyrtohet në themel pranë kësaj gjykate dhe akoma nuk ka përfunduar shqyrtimi gjyqësor. Lidhur me kërkesën tuaj për t’ju vënë në dispozicion CD-të audio me dëshmitë e dhëna nga të pandehurit bashkëpunëtorë të drejtësisë, në zbatim të nenit 12, pika 2 të “Udhëzuesit standart të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median”, miratuar me vendimin nr. 716, datë 06.12.2023 të Këshillit Lartë Gjyqësor, i cili parashikon se: “<u>Si rregull, personave të interesuar për përdorimin e vendimeve gjyqësore për qëllime studimore, shkencore, statistikore, literature apo</u>	
--	--	---	--	--	--

				<u>gazetarie, i vihet në dispozicion vetëm kopja e vendimit të plotë, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.</u> Përjashtim bëjnë rastet kur në përgjigje të një kërkesë të motivuar nga persona të tjerë të përmendur në pikën 1, <u>ku argumentohet pamundësia e realizimit të qëllimit të aksesit</u> vetëm nëpërmjet konsultimit të vendimit, gjykata miraton aksesin fizik në të gjithë dosjen sipas procedurës të parashikuar në nenin 11 të këtij Udhëzuesi”, në kushtet që, dëshmitë e dhëna nga të pandehurit, duke përfshirë këtu edhe të pandehurit dëshmitarë të drejtësisë, janë cituar në vendimet e arsyetuara, të lartpërmendura, vlerësojmë se qëllimi juaj për përgatitjen e dokumentarit investigativ realizohet plotësisht nëpërmjet vënies në dispozicion të këtyre vendimeve. Për sa më sipër, refuzojmë kërkesën tuaj për t’ju vënë në dispozicion CD-të audio me dëshmitë e dhëna nga të pandehurit bashkëpunëtorë të drejtësisë. Sa i përket kërkesës tuaj për të realizuar një intervistë me Z. E.B, Kryetarin në Detyrë të kësaj gjykate, për të diskutuar mbi rolin e bashkëpunëtorëve të drejtësisë në hetimet dhe proceset gjyqësore në Shqipëri, ju bëjmë me dije se aktualisht Kryetari e ka të pamundur realizimin e një interviste të tillë, për shkak të ngarkesës në punë dhe angazhimeve të tjera profesionale.		
--	--	--	--	--	--	--

				Megjithatë, ju falënderojmë për interesin e treguar dhe mbetemi të hapur për mundësi të tjera bashkëpunimi në të ardhmen. Së fundmi, në zbatim të <i>“Udhëzuesit standart të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median”</i>, miratuar me vendimin nr. 716, datë 06.12.2023 të Këshillit Lartë Gjyqësor, vendimet e mësipërme do ju vihen në dispozicion të paanonimizuara. Në këto kushte, ju sjellim në vëmendje respektimin e: - Dispozitave ligjore të parashikuara nga Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 <i>“Për mbrojtjen e të dhënave personale”</i>, i ndryshuar, konkretisht: Nenin 2 dhe nenin 11; - Udhëzimit Nr. 9, datë 15.09.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale <i>“Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audio vizive”</i>, konkretisht: Kreun I, pika 2, 3 dhe 11; Kreun III, pika 5 dhe 6; Kreun IV, pika 4 dhe 5; - Udhëzimit Nr. 31, datë 27.12.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale <i>“Për përcaktimin e kushteve dhe kritereve për përjashtimin nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose</i>		
--	--	--	--	---	--	--

				<i>artistike</i> ”, konkretisht: Nenin 4, pika 5.		
19.	01.04.2025	Kërkesë për vënie në dispozicion të vendimit nr. 01, datë 16.01.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.	01.04.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 19, datë 01.04.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, <i>“Për të drejtën e informimit”</i>, i ndryshuar, ju bëjmë me dije se mund të paraqiteni në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për të tërhequr një kopje të vendimit nr. 01, datë 16.01.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me të pandehur L.B, etj... Kopja e vendimit do ju vihet në dispozicion në formatin që ju dëshironi, në CD ose kopje fizike në fletë A4, pasi të bëni pagesën e tarifës përkatëse, në zbatim të Urdhërit Nr. 86, datë 17.04.2015 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale <i>“Për tarifën e dhënies së informacionit (dokumentacionit) të kërkuar”</i> (60 lekë për CD dhe 5 lekë për fletë për formatin A4), pasi për shkak të ngarkesës së dokumentit e kemi të pamundur t’ju dërgojmë në email. Në zbatim të <i>“Udhëzuesit standart të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median”</i>, miratuar me vendimin nr. 716, datë 06.12.2023 të Këshillit Lartë Gjyqësor,	Përfunduar (Email dhe kopje të CD-së)	60 lekë

				vendimi i mësipërm do ju vihet në dispozicion i paanonimizuar. Në këto kushte, ju sjellim në vëmendje respektimin e: Dispozitave ligjore të parashikuara nga Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 <i>“Për mbrojtjen e të dhënave personale”</i>, i ndryshuar, konkretisht: Nenin 2 dhe nenin 11; - Udhëzimit Nr. 9, datë 15.09.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale <i>“Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audio vizive”</i>, konkretisht: Kreun I, pika 2, 3 dhe 11; Kreun III, pika 5 dhe 6; - Udhëzimit Nr. 31, datë 27.12.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale <i>“Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për përjashtimin nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike”</i>, konkretisht: Nenin 4, pika 5.		
20.	01.04.2025	Kërkesë për vënie në dispozicion të vendimeve nr. 5, datë 24.01.2024 dhe nr. 16, datë 10.09.2020 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;	01.04.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 20, datë 01.04.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, <i>“Për të drejtën e informimit”</i>, i ndryshuar, bashkëlidhur këtij email-i po ju dërgojmë vendimet e shkarkuara nga sistemi: 1. Vendimin nr. 5, datë 24.01.2024 të	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

				Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; 2. Vendimin nr. 16, datë 10.09.2020 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; Në zbatim të “Udhëzuesit standart të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median”, miratuar me vendimin nr.716, datë 06.12.2023 të Këshillit Lartë Gjyqësor, vendimet e mësipërme ju vihet në dispozicion të paanonimizuara. Në këto kushte, ju sjellim në vëmendje respektimin e: - Dispozitave ligjore të parashikuara nga Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “<i>Për mbrojtjen e të dhënave personale</i>”, i ndryshuar, konkretisht nenin 2 dhe nenin 11. - Udhëzimit Nr. 9, datë 15.09.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “<i>Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audio vizive</i>”, konkretisht: Kreun I, pika 2, 3 dhe 11; Kreun III, pika 5 dhe 6; Kreun IV, pika 4 dhe 5. - Udhëzimit Nr. 31, datë 27.12.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “<i>Për përcaktimin e kushteve dhe kritereve për përjashtimin nga detyrimet</i>		
--	--	--	--	---	--	--

				<i>përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike”, konkretisht nenin 4, pika 5.</i>		
21.	02.04.2025	Kërkesë për informacion dhe kopje të vendimeve gjyqësore: 1) Sa është numri i procedimeve të regjistruara në gjykatën tuaj për çështjet me objekt: “<i>Trafikimi i personave të rritur</i>”, parashikuar nga neni 110/a i K.Penal, “<i>Trafikimi i të miturve</i>”, parashikuar nga neni 128/b i K.Penal, “<i>Shfrytëzimi i prositucionit</i>”, parashikuar nga neni 114 i K.Penal, në rastet kur veprat penale janë kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, të ndarë sipas objektit gjatë vitit 2024; 2) Vënie në dispozicion të kopjeve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë në lidhje me veprat penale të parashikuara nga nenet 110/a, 114 dhe 128/b të	07.04.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informim drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si Drejtore Ekzekutive e Qendrës *****, të protokolluar pranë kësaj gjykate me Nr 1265 Prot., datë 28.03.2025, regjistruar në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014 “<i>Për të Drejtën e Informimit</i>”, i ndryshuar, me numër rendor 21, datë 02.04.2025, ju bëjmë me dije si më poshtë: Pas verifikimeve të bëra si në sistemin elektronik të regjistrimit të çështjeve të kësaj Gjykate, po ashtu dhe në Kryesekretarinë e Gjykatës, rezulon se gjatë vitit 2024, nga kjo gjykatë nuk është dhënë asnjë vendim penal në lidhje me veprat penale “<i>Trafikimi i personave të rritur</i>”, “<i>Trafikimi i të miturve</i>”, “<i>Shfrytëzimi i prositucionit</i>”, të parashikuara nga nenet 110/a, 128/b dhe 114 të Kodit Penal, të kryera si vepra penale në kuadër të grupit strukturuar kriminal, organizatës kriminale, organizatës terroriste apo bandës së armatosur, parashikuar nga nenet 333/a, 333, 234/a dhe 234/b të Kodit Penal. Sa i përket kërkesës për informacion lidhur	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		K.Penal, përgjatë vitit 2024; 3) Në sa prej rasteve është vendosur pranimi i fajësisë.		me numrin e procedimeve të regjistruara në gjykatë për çështjet që kanë për objekt veprat penale të sipërcituara, ju informojmë se regjistrimi i një procedimi penal nuk është kompetencë e gjykatës dhe kjo gjykatë nuk e disponon një informacion të tillë. Në zbatim të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë procedimet penale regjistrohen nga organi i prokurorisë. Nga komunikimi me verbal me zyrën homologe në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), jemi informuar se ju e keni dërguar këtë kërkesë edhe në SPAK, për këtë arsye nuk po ua dërgojmë këtyre të fundit përsëri nga ana jonë.		
22.	03.04.2025	Kërkesë për informacion me shkrim dhe kopje të njehsuar me origjinalin të akteve që lidhen me dhënien e vendimit nr. 58, datë 28.02.2025 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, i bërë publik në faqen elektronike të **** dhe në media të tjera: 1. Kopjen e ankimit të datës 13.01.2025 të shtetasit D.A.B; 2. Kopjen e vendimit të marrë nga gjyqtarja F.H në lidhje me këtë ankim; 3. Dokumentin shkresor për	11.04.2024	Drejtuar: Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Për dijeni: Shtetases O.Xh Ju bëjmë me dije se, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO) është paraqitur kërkesa, me: Kërkues: O.Xh Objekti: Kërkohet informacion me shkrim dhe kopje të njehsuar me origjinalin të akteve që lidhen me dhënien e vendimit nr. 58, datë 28.02.2025 të GJKKO-së, i bërë publik në faqen elektronike të **** dhe në media të tjera. Baza ligjore: Neni 23 dhe 30 i Kushtetutës	Përfunduar Dërguar Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me shkresën nr. 1325/1 prot., datë 11.04.2025.	Nuk ka

		regjistrimin e këtij ankimi si dhe mënyrën e përzgjedhjes së gjyqtarës F.H për marrjen në shyrtrim të tij duke dhënë vendimin nr. 58, datë 28.02.2025 duke specifikuar dhe momentin kohor të zbardhjes së vendimit dhe depozitimit në sekretari nga ana e gjykatës të vendimit të arsyetuar; 4. Kopjen e shkresës nr. 22920/1 prot, datë 27.12.2024 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.		së Republikës së Shqipërisë, nenet 2, 3 dhe 11 të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, si dhe nenet 103-105 të K.Pr.Penale, në lidhje me nenet 287, 290 dhe 291 të këtij Kodi. Kjo kërkesë është protokolluar pranë GJKKO-së me nr. 1325 prot., datë 02.04.2025 dhe njëkohësisht, me datë 03.04.2025 është rregjistruar si kërkesë për informim në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve me nr. rendor 22, në zbatim të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar. Në referim të nenit 291 të K.Pr.Penale, pika 4 dhe 5, ku parashikohet shprehimisht se: <i>“4. Kur e gjen të bazuar ankimin, gjykata urdhëron prokurorin të regjistrojë procedimin dhe të kryejë hetimet e nevojshme, duke përcaktuar edhe drejtimin e tyre, 5. Kundër vendimit palët mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit. Gjykata e apelit shqyrton ankimin në dhomë këshillimi brenda 30 ditëve nga data e marrjes së akteve.”</i>, duke qenë se shtetasja O.Xh nuk ka qenë palë në kërkesën penale me nr. 58 vendimi, datë 28.02.2025, me ankues shtetasin D.A.B, ky vendim nuk i është komunikuar kësaj shtetaseje nga ana gjykatës.	
--	--	---	--	---	--

				Në kushtet që kërkesa penale me nr. 58 vendimi, datë 28.02.2025, me ankues shtetasin D.A.B, e GJKKO-së është dërguar për gjykim pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në zbatim të nenit 12, pika 2 të ligjit nr. 119/2014, <i>“Për të drejtën e informimit”</i>, i ndryshuar, i cili parashikon se: <i>“Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuar. Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar”</i>, po ju përcjellim kërkesën për informacion të shtetases O.Xh, si autoriteti publik kompetent për shqyrtimin e kësaj kërkesë. Bashkëlidhur kësaj shkrese gjeni kërkesën e shtetases O.Xh (2 fletë) si dhe aktet bashkëlidhur (13 fletë).		
23.	14.04.2025	Kërkesë për vënie në dispozicion të vendimeve nr. 69, datë 21.11.2024 dhe nr. 4, datë 10.01.2025, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.	22.04.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 23, datë 14.04.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, <i>“Për të drejtën e informimit”</i>, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: •Vendimi nr. 69, dt. 21.11.2024, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

				Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (Kryesues gjyqtar E.B); •Vendimi nr. 4, dt. 10.01.2025, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (Kryesues gjyqtar B.N), gjenden të publikuar në faqen zyrtare të kësaj gjykate, gjykata.gov.al Në linkun e faqes zyrtare klikoni në kategorinë “Çështjet gjyqësore”, nënkategorinë “Çështjet penale”. Pasi t’ju shfaqet faqja plotësoni të dhënat përkatëse, në rastin konkret zgjidhni gjyqtarin E.B/B.N, të cilët kanë dhënë vendimet e sipërcituara, vitin 2024/2025, numrin e vendimit dhe klikoni “Kërko”. Në momentin që ju del çështja përkatëse klikoni në tabelën e vogël të emërtuar “Detaje”, tek “Informacion mbi çështjen” klikoni “Vendimi përfundimtar” dhe në fund “Shkarko vendimin”. Linku i faqes së web-it: https://gjkata.gov.al/krimet-e-r%C3%ABnda/gjkata-e-posa%C3%A7me-e-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-p%C3%ABr-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/c%C3%ABshtjet-gjq%C3%ABsore/c%C3%ABshtjet-penale/		
24.	16.04.2025	Kërkesë për vënie në dispozicion të vendimit nr.	17.04.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		339, datë 22.10.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.		24, datë 16.04.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “<i>Për të drejtën e informimit</i>”, i ndryshuar, bashkëlidhur këtij email-i po ju dërgojmë vendimin e shkarkuar nga sistemi: 1. Vendimin nr. 339, datë 22.10.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, “Vleftësim arresti në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit për shtetasin V.S (K.R)”. Ju bëjmë me dije se, për këtë shtetas nuk është dhënë vendim themeli nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, pasi është shpallur moskompetenca nga ana e Prokurorisë për Krimet e Rënda. Në kushtet që ky vendim ju vihet në dispozicion i paanonimizuar, ju sjellim në vëmendje respektimin e: - Dispozitave ligjore të parashikuara nga Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “<i>Për mbrojtjen e të dhënave personale</i>”, i ndryshuar, konkretisht nenin 2 dhe nenin 11. - Udhëzimit Nr. 9, datë 15.09.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “<i>Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audio vizive</i>”, konkretisht: Kreun I, pika 2, 3 dhe 11; - Udhëzimit Nr. 31, datë 27.12.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave	
--	--	---	--	--	--

				Personale “Për përcaktimin e kushteve dhe kritereve për përjashtimin nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike”, konkretisht nenin 4, pika 5.		
25.	02.05.2025	Kërkesë për vënie në dispozicion të vendimit nr. 4, datë 10.01.2025 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.	02.05.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 25, datë 02.05.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije se: • Vendimi nr. 4, dt. 10.01.2025, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (Kryesues gjyqtar B.N), gjendet i publikuar në faqen zyrtare të kësaj gjykate, gjykata.gov.al Në linkun e faqes zyrtare klikoni në kategorinë “Çështjet gjyqësore”, nënkategorinë “Çështjet penale”. Pasi t’ju shfaqet tabela plotësoni të dhënat përkatëse, në rastin konkret zgjidhni gjyqtarin B.N, i cili ka dhënë vendimin e sipërcituar, vitin 2025, numrin e vendimit 4 dhe klikoni “Kërko”. Në momentin që ju del çështja përkatëse klikoni “Detaje”, tek “Informacion mbi çështjen” klikoni “Vendimi përfundimtar” dhe në fund “Shkarko vendimin”. Linku i faqes së web-it: https://gjkata.gov.al/krimet-e-	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

				r%C3%ABnda/gjykata-e-posa%C3%A7me-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-p%C3%ABr-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/c%C3%ABshtjet-gjyq%C3%ABsore/c%C3%ABshtjet-penale/		
26.	07.05.2025	Kërkesë për vënie në dispozicion të vendimit nr. 69, datë 11.07.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe vendimit nr. 18, datë 15.09.2020 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.	08.05.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 26, datë 07.05.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “<i>Për të drejtën e informimit</i>”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije se mund të paraqiteni në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për të tërhequr një kopje të: • Vendimit nr. 69, datë 11.07.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë; • Vendimit nr. 18, datë 15.09.2020 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Kopjet e vendimeve do ju vihen në dispozicion në formatin që ju dëshironi, në CD ose kopje fizike në fletë A4, pasi të bëni pagesën e tarifës përkatëse, në zbatim të Urdhërit Nr. 86, datë 17.04.2015 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale “<i>Për tarifën e dhënies së informacionit (dokumentacionit) të kërkuar</i>” (60 lekë për	Përfunduar (E-mail) (Marrë kopja e CD-së)	60 lekë

				CD dhe 5 lekë për fletë për formatin A4), pasi për shkak të ngarkesës së dokumentit e kemi të pamundur t’jua dërgojmë në email. Në zbatim të <i>“Udhëzuesit standart të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median”</i>, miratuar me vendimin nr. 716, datë 06.12.2023 të Këshillit Lartë Gjyqësor, vendimet e mësipërme do ju vihen në dispozicion të paanonimizuara. Në këto kushte, ju sjellim në vëmendje respektimin e: - Dispozitave ligjore të parashikuara nga Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 <i>“Për mbrojtjen e të dhënave personale”</i>, i ndryshuar, konkretisht: Nenin 2 dhe nenin 11. - Udhëzimit Nr. 9, datë 15.09.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale <i>“Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audio vizive”</i>, konkretisht: Kreun I, pika 2, 3 dhe 11; Kreun III, pika 5 dhe 6; Kreun IV, pika 4 dhe 5. - Udhëzimit Nr. 31, datë 27.12.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale <i>“Për përcaktimin e kushteve dhe kritereve për përjashtimin nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike”</i>, konkretisht: Nenin 4, pika 5.		
--	--	--	--	--	--	--

27.	09.05.2025	Kërkesë për informacion: Për nevojat e zbatimit të projektit “Rritja e transparencës dhe e llogaridhënies mbi buxhetin e sistemit të drejtësisë” mbështetur nga BE dhe zbatuar nga Qendra ****, 2023-2026. Ju lutem na vini në dispozicion disa materiale, dokumenta si më poshtë: -Analiza vjetore e GJKKO për 2024; -Raporti vjetor i zbatimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2024; -Regjistri i realizimit të prokurimeve 2024.	13.05.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 27, datë 09.05.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije se informacionet e kërkuara nga ana juaj gjenden të publikuara në faqen zyrtare të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, më konkretisht: Tek faqja zyrtare e Gjykatave të Republikës së Shqipërisë gjykata.gov.al klikoni në rubrikën “Gjykatat Shqiptare”, nënrubrika “Gjykatat e Shkallës së Parë, Juridiksioni i Përgjithshëm” dhe në fund “Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Pasi t’ju hapet faqja e Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar shkoni tek “Programi i Transparencës” që ndodhet në anën e majtë të faqes, klikoni rubrikën “Programi i transparencës” dhe më pas nënrubrikën “Mekanzimat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi AP”, ku do të gjeni të publikuar raportin e monitorimit 12 mujor për vitin 2024, si dhe analizën vjetore të punës së gjykatës për vitin 2024. Po në “Programin e Transparencës” në	Përfudnuar (E-mail)	Nuk ka
-----	------------	--	------------	--	---------------------	--------

				nënrubrikën “Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat” gjeni të publikuar regjistrin e prokurimeve publike për vitin 2024. Linku i Programit të Transparencës në faqen zyrtare të GJKKO-së: https://gjykata.gov.al/krimet-e-r%C3%ABnda/gjykata-e-posa%C3%A7me-e-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-p%C3%ABr-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/programi-i-transparences/programi-i-transparenc%C3%ABs/		
28.	21.05.2025	Kërkesë për informacion: Kërkesë për të pasur akses në dosjen penale të E.Sh, çështja e hotel **** ose dokumentet përkatëse të çështjes së tij, që mund të jenë të disponueshme për studim akademik. Kjo kërkesë bëhet për qëllime studimore dhe në përputhje me Ligjin për të Drejtën e Informimit.	23.05.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informim, regjistruar me numër rendor 28, datë 21.05.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Nga verifikimi në Kryesekretarinë e kësaj gjykate rezulton se dosja penale, së cilës ju i referoheni në kërkesën tuaj për informim, konkretisht dosja penale me nr. 77/11 regj. themeltar, datë regjistrimi 13.04.2017, nr. vendimi 122, datë vendimi 13.11.2018, me të pandehur E.Sh, G.D, E.Q, E.Z dhe B.Sh aktualisht ndodhet për shqyrtim pranë	Përfunduar (Dërguar Gjykatës së Lartë) (E-mail)	Nuk ka

				Gjykatës së Lartë. Për këtë arsye, në zbatim të nenit 12, pika 2 të ligjit nr. 119/2014, <i>“Për të drejtën e informimit”</i>, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: <i>“Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuuesin. Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar”</i>, kërkesa juaj për informim i është përcjellë për shqyrtim ditën e sotme autoritetit publik kompetent, Gjykatës së Lartë. Në referim të nenit 12, pika 3 të ligjit nr.119/2014, <i>“Për të drejtën e informimit”</i>, i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se: <i>“Autoriteti publik, të cilit i është drejtuar kërkesa për informim, njofton kërkuuesin se kërkesa e tij i është dërguar një autoriteti tjetër, si dhe e informon atë për kontaktet e autoritetit ku është dërguar kërkesa.”</i>, po ju dërgojmë email-et e kontaktit të Gjykatës së Lartë, të publikuara në faqen zyrtare të Gjykatave të Republikës së Shqipërisë, gjykata.gov.al si dhe adresën e institucionit. Email: info@gjykataelarte.gov.al		
--	--	--	--	--	--	--

			ida.vodica@gjykataelarte.gov.al Adresa: Rruga “Ibrahim Rugova”, Tiranë, Shqipëri Po ashtu, bashkëlidhur këtij email-i po ju dërgojmë vendimin nr. 122, datë 13.11.2018, me të pandehur E.Sh, G.D, E.Q, E.Z dhe B.Sh, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, të shkarkuar nga sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Në zbatim të “Udhëzuesit standart të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median”, miratuar me vendimin nr. 716, datë 06.12.2023 të Këshillit Lartë Gjyqësor, vendimi i mësipërm ju vihet në dispozicion i paanonimizuar. Në këto kushte, ju sjellim në vëmendje respektimin e: - Dispozitave ligjore të parashikuara nga Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, konkretisht: Nenin 2 dhe nenin 11. - Udhëzimit Nr. 9, datë 15.09.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audio vizive”,		
--	--	--	--	--	--

				konkretisht: Kreun I, pika 2 dhe 3; Kreun III, pika 5 dhe 6. - Udhëzimit Nr. 31, datë 27.12.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për përcaktimin e kushteve dhe kritereve për përjashtimin nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike”, konkretisht: Nenin 4, pika 5.		
29.	26.05.2025	Kërkesë për vënie në dispozicion të vendimit nr. 8, datë 07.02.2007 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.	28.05.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 29, datë 26.05.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, bashkëlidhur këtij email-i po ju dërgojmë vendimin nr. 8, datë 07.02.2007, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me të pandehur Xh.T, të shkarkuar nga sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Në zbatim të “Udhëzuesit standart të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median”, miratuar me vendimin nr. 716, datë 06.12.2023 të Këshillit Lartë Gjyqësor, vendimi i mësipërm ju vihet në dispozicion i paanonimizuar. Në këto kushte, ju sjellim në vëmendje respektimin e: - Dispozitave ligjore të parashikuara nga Ligji Nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

				<i>dhënave personale</i>”, konkretisht: Nenin 2, nenin 43, pika 1 dhe 2, nenin 99, pika 2. - Udhëzimit Nr. 9, datë 15.09.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “<i>Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audio vizive</i>”, konkretisht: Kreun I, pika 2, 3 dhe 11; Kreun III, pika 5 dhe 6; Kreun IV, pika 4 dhe 5.		
30.	27.05.2025	Kërkesë për informacion: Në kuadrin e një studimi të ndërmarrë për përmbushjen nga ana e Shqipërisë të detyrimeve që lidhen me Kapitullin 23 të negociatave për anëtarësimin në BE, ju drejtohem me këtë kërkesë për informacion për çështjet e sjella për gjykimin në GJKKO e magjistratëve të shkarkuar nga KPK, që i janë referuar SPAK. Do ju ishim mirënjohës nëse në informacion mund të përfshini statistikën në lidhje me numrin e çështjeve të sjella për gjykim, të atyre të gjykuara, si edhe nëse kanë rezultuar me vendim fajësie, apo pafajësie.	29.05.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 30, datë 27.05.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “<i>Për të drejtën e informimit</i>”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: A. Dosje penale të shqyrtuara në themel: 1. Me vendimin nr. 43, datë 26.06.2023 Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndër të tjera, ka vendosur: Deklarimin fajtor të të pandehurit B.D, për kryerjen e veprës penale “<i>Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim</i>”, parashikuar nga neni 257/a, paragrafi i dytë i K.Penal. 2. Me vendimin nr. 60, datë 17.10.2024	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

				Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndër të tjera, ka vendosur: Deklarimin fajtor të të pandehurit F.L për kryerjen e veprës penale <i>“Refuzimi për deklarin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”</i>, parashikuar nga neni 257/a/2 i K.Penal. 3. Me vendimin nr. 26, datë 17.03.2025 Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndër të tjera, ka vendosur: Deklarimin fajtor të të pandehurit G.Z, për kryerjen e veprës penale të <i>“Refuzimi për deklarim, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”</i>, parashikuar nga neni 257/a paragrafi i dytë i Kodit Penal. (I larguar me dorëheqje.) 4. Aktualisht pranë kësaj gjykate vijon gjykimi i dosjes penale nr. 137/59/15/6, datë regjistrimi 22.12.2022, me të pandehur Sh.S, i akuzuar për kryerjen e veprave penale <i>“Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rreme i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”</i>,		
--	--	--	--	---	--	--

				parashikuar nga neni 257/a/2 i K.Penal. B. Dosje penale të shqyrtuara në seancë paraprake (kërkesa për pushim) 1. Me vendimin nr. 117, datë 22.10.2024 Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndër të tjera, ka vendosur: Pushimin e çështjes penale që i përket procedimit penal me Nr. 137/4 të vitit 2021, të regjistruar nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, në ngarkim të shtetasit A.Th, për veprën penale “Refuzim për deklarin, mosdeklarim, fshehja ose deklarim i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrim ligjor për deklarin”, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal. 2. Lidhur me shtetasin B.I, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin nr. 42, datë 13.01.2025 ndër të tjera, ka vendosur: Pushimin e procedimit penal me nr. 137/6, të vitit 2021 për veprën penale “<i>Refuzimi për deklarin, mosdeklarim, fshehja ose deklarim i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarin</i>”, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal.		
--	--	--	--	--	--	--

				(I larguar me dorëheqje.) 3. Lidhur me shtetasin A.Z, pranë kësaj gjykate po shqyrtohet në seancë paraprake kërkesa për pushim, për veprën penale <i>“Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”</i> , me nr. 102 regjistri, datë 23.05.2025 regjistrimi.		
31.	28.05.2025	Kërkesë për informacion: 1. Nga viti 2020 deri më tani, sa ankime janë bërë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë me objekt, ankim ndaj vendimit të mosfillimit të hetimit? (e ndarë sipas viteve) 2. Për të njëjtën periudhë kohore, në sa raste Gjykata e Posaçme ka vendosur të prish vendimin e mosfillimit të hetimeve?	04.06.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 31, datë 28.05.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, <i>“Për të drejtën e informimit”</i> , i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Për vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023 ju është kthyer më parë përgjigje sipas të njëjtës kërkesë për informacion të dërguar nga ana juaj, regjistruar me numër rendor 22, datë 14.10.2024 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, përgjigje e cila ju është kthyer me email-in e datës 24.10.2024, ora 11:31. Për vitin 2024 pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka përfunduar shqyrtimi i 72 (shtatëdhjetë e dy) kërkesave penale, me objekt <i>“Ankim kundër vendimit</i>	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

				të prokurorit për mosfillim të procedimit penal”, sipas nenit 291/2 të K.Pr.Penale. Ndër të cilat, në 1 (një) rast është vendosur shfuqizimi pjesërisht i vendimit të Prokurorisë së Posaçme për mosfillimin e procedimit penal dhe urdhërimin e Prokurorisë së Posaçme për regjistrimin e procedimit penal dhe kryerjen e hetimeve të nevojshme dhe në 2 (dy) raste është vendosur pranimi i ankimit dhe urdhërimin e Prokurorisë së Posaçme për regjistrimin e procedimit penal dhe kryerjen e hetimeve të nevojshme. Për vitin 2025, deri më 28.04.2025 pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë regjistruar 37 (tridhjetë e shtatë) kërkesa penale, me objekt “Ankim kundër vendimit të prokurorit për mosfillim të procedimit penal”, sipas nenit 291/2 të K.Pr.Penale. Shqyrtimi i këtyre kërkesave penale ka përfunduar dhe në 1 (një) rast është vendosur pranimi i ankimit dhe detyrimin e Prokurorisë së Posaçme për regjistrimin e procedimit penal dhe vazhdimin e hetimeve. Për kërkesat e regjistruara pas datës 28.04.2025 deri më tani, duke pasur parasysh afatin kohor për shqyrtimin e këtyre kërkesave penale, të parashikuar në nenin 291, pika 3 të K.Pr.Penale, si dhe faktin që këto kërkesa shqyrtohen në dhomë	
--	--	--	--	---	--

				këshillimi, nuk disponojmë informacion lidhur me këtë periudhë.		
32.	30.05.2025	Kërkesë për vënien në dispozicion të kopjes së vendimit nr. 14, dt. 05.03.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.	02.06.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 32, datë 30.05.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, bashkëlidhur këtij email-i po ju dërgojmë vendimin nr. 14, dt. 05.03.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të shkarkuar nga sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve të kësaj gjykate. Vendimi nr. 14, dt. 05.03.2024, me të pandehur D.A.B, etj., dhënë nga trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët E.Ç, F.H dhe I.Gj, gjendet i publikuar edhe në faqen zyrtare të kësaj gjykate, gjykata.gov.al Më poshtë po ju ilustrojmë edhe mënyrën se si mund të kërkon vendime në këtë faqe. Linku i faqes së web-it: https://gjykata.gov.al/krimet-e-r%C3%ABnda/gjykata-e-posa%C3%A7me-e-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-p%C3%ABr-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/c%C3%ABshtjet-gjyq%C3%ABsore/c%C3%ABshtjet-penale/ Në linkun e faqes zyrtare klikoni në kategorinë “Çështjet gjyqësore”,	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

				nënkategorinë “Çështjet penale”. Pasi t’ju shfaqet tabela plotësoni të dhënat përkatëse, zgjidhni gjyqtarin kryesues që ka shqyrtuar çështjen përkatëse, në rastin konkret gjyqtarin E.Ç, vitin në të cilin është dhënë vendimi, në këtë rast vitin 2024, numrin e vendimit përkatës, nr. 14 dhe klikoni “Kërko”. Në momentin që ju del çështja përkatëse klikoni “Detaje” dhe më pas klikoni “Vendimi përfundimtar”, ku do të gjeni të publikuar vendimin.		
33.	02.06.2025	Kërkesë për informacion: 1. Statistikë – Numri total i masave të sigurimit personal të vendosura nga gjykata në vitin 2024 dhe 2025. 2. Numri i masave të sigurimit personal “arrest me burg”. 3. Llojet e veprave penale për të cilat është kërkuar “arrest me burg”. 4. Numri i masave të sigurimit personal për masa alternative: a) Detyrim paraqitje; b) Garanci pasurore; c) Arrest shtëpie; d) Ndalim i daljes jashtë	04.06.2025	Në përgjigje të shkresës suaj nr. 2728/1 Prot, datë 29.05.2025, protokolluar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me nr. 2196 Prot. datë 30.05.2025, me lëndë: “Kërkesë për informacion, z. A.B.”, regjistruar me datë 02.06.2025, me numër rendor 33 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, nëpërmjet së cilës është kërkuar informacion në lidhje me statistikën e masave të sigurimit për vitet 2024 dhe 2025 për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ju lutem gjeni më poshtë informacionin e kërkuar: 1. Statistikë – Numri total i masave të sigurimit personal të vendosura nga	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		vendit; e) Ndalim i kontaktit me persona të caktuar, etj. 5. Numri i personave të cilëve u është caktuar “arrest me burg” dhe që më pas janë shpallur të pafajshëm në vendimin përfundimtar. 6. Kohëzgjatja mesatare e paraburgimit për këta persona. 7. Nëse është e mundur, të dhëna mbi kërkesat për dëmshpërblim për paraburgim të padrejtë.		gjykata ne vitin 2024 dhe 2025? • Për vitin 2024 janë vendosur 346 masa sigurimi • Për vitin 2025, deri me 30.05.2025 janë vendosur 142 masa sigurimi 2. Numri i masave te sigurimit personal “arrest me burg”? • Për vitin 2024 janë vendosur 262 masa sigurimi personal “arrest me burg”. • Për vitin 2025, deri me 30.05.2025 janë vendosur 85 masa sigurimi personal “arrest me burg”. 3. Llojet e veprave penale për të cilat është kërkuar “arrest me burg”? • 78/2, 22, 28/4, 333/a/1 dhe 334 të K.Penal, • 80, 28/4, 333/a/1 e 334 të K.Penal, • 186 pg 2 dhe 190 pg 2 të K.Penal; • 244-25 dhe 287/2 të K.Penal; • 245/1/4-25 të K.Penal; • 248,295/a,259 dhe 287/2 të K.Penal; • 257/a/2 të K.Penal; • 278/1, 28/4, 333/a/1 dhe 334 K.Penal;		
--	--	---	--	--	--	--

				• 289/2 të K.P 248 të K.Penal; • 283/a, 28 pika 4, 333/a/1 dhe 334/1 të K.Pebal; • 298 pg 2, 28 pika 4, 333/a , 334 pika 1 dhe 244 pg 2 të K.Penal; 4. Numri masave të sigurimit personal për masa alternative: • Detyrim paraqitje • Për vitin 2024 janë vendosur 36 masa sigurimi personal “Detyrim paraqitje”. • Për vitin 2025, deri me 30.05.2025 janë vendosur 35 masa sigurimi personal “Detyrim paraqitje”. • Garanci pasurore • Për vitin 2024 nuk janë vendosur masa sigurimi personal “Garanci pasurore”. • Për vitin 2025, deri me 30.05.2025 nuk janë vendosur masa sigurimi personal “Garanci pasurore”. • Arrest shtëpie • Për vitin 2024 janë vendosur 38 masa sigurimi personal “Arrest shtëpie”. • Për vitin 2025, deri me 30.05.2025 janë vendosur 20 masa sigurimi personal “Arrest shtëpie”.		
--	--	--	--	--	--	--

				• Ndalim i daljes jashtë vendit. • Për vitin 2024 janë vendosur 6 masa sigurimi personal “Ndalim i daljes jashtë vendit”. • Për vitin 2025, deri me 30.05.2025 nuk janë vendosur masa sigurimi personal “Ndalim i daljes jashtë vendit”. • Pezullimi ushtrimit të një detyre a shërbimi publik. • Për vitin 2024 janë vendosur 4 masa sigurimi personal “Pezullim ushtrim detyre”. • Për vitin 2025, deri me 30.05.2025 janë vendosur 2 sigurimi personal “Pezullim ushtrim detyre”. 5. Numri i personave të cilëve u është caktuar “arrest me burg” dhe më pas janë shpallur të pafajshëm në vendimin përfundimtar. • Ju informojmë se asnjë prej personave ndaj të cilëve është caktuar masat e sigurimit “arrest në burg”, për periudhën 2024-2025 nuk është shpallur i pafajshëm me vendim përfundimtar deri më tani. Theksojmë faktin që pjesa me e madhe e këtyre personave vijojnë të jenë në gjykim përpara kësaj gjykate.		
--	--	--	--	--	--	--

				6. Kohëzgjatja mesatare e paraburgimit për këta persona. - Në lidhje me kohëzgjatjen e paraburgimit, ju bëjmë me dije se për çdo çështje penale aktet janë dorëzuar në gjykatë brenda afatit kohor të parashikuar nga neni 263, pika 1 të K.Pr.Penale dhe po ashtu vendimet janë dhënë nga kjo gjykatë brenda afateve të parashikuara nga neni 263, pika 2 të K.Pr.Penale. Kohëzgjatja mesatare e paraburgimit për personat ndaj të cilëve është caktuar masë sigurimi, për periudhën 2024-2025, aktualisht është e pamundur të përllogaritet, pasi këta persona vijojnë të jenë në gjykim përpara kësaj gjykate. 7. Nëse është e mundur, të dhëna mbi kërkesat për dëmshpërblim për paraburgim të pa drejtë? - Në lidhje me kërkesën, Gjykata e posaçme nuk disponon informacion mbi dëmshpërblimin për paraburgim të padrejtë pasi, këto kërkesa shqyrtohen nga gjykatat administrative.		
34.	05.06.2025	Kërkesë për informacion: ... Për rastet e identifikuar si më poshtë vijon: 1. Tenderi për barnat e sëmundjeve tumorale,	16.06.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 34, datë 05.06.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

	raportuar nga media si rsati i modifikimit të dokumenteve të tenderit nga ish-ministri i shëndetësisë z. I.B. (Viti 2015); 2. Tenderi me vlerë 1.100.000 lekë për sigurimin e rojes private për 72 ditë për QSUT, raportuar nga media si i dhënë nga ish-ministri i shëndetësisë z. I.B me prokurim të drejtpërdrejtë dhe pa garë mes kompanive. (Viti 2016); 3. Tenderi për blerjen e materialeve të konsumit, implante ortopedike, me vlerë rreth 2.000.000 Euro; 4. Koncesioni i “Check Up”, raportuar nga media si aferë korruptive e kryer nga znj. V.N, përmes shoqërisë tregtare ****; 5. Çështja e A.Ç. (A.), ish-drejtuese e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, raportuar nga media si subjekt i përfshirë në disa afera korruptive sa i takon përfitimit me barna të skaduara, receta fiktive dhe	ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: I) Sa i përket rasteve të identifikuara në kërkesën tuaj, nga pika 1 deri tek pika 7, konkretisht: tenderi për barnat e sëmundjeve tumorale; tenderi me vlerë 1.100.000 lekë për sigurimin e rojes private për 72 ditë për QSUT; tenderi për blerjen e materialeve të konsumit, implante ortopedike, me vlerë rreth 2.000.000 euro; koncesioni i “Check Up”, raportuar nga media si aferë korruptive e kryer nga znj. V.N, përmes shoqërisë tregtare ****; çështja e A.Ç (A.), ish-drejtuese e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor; tenderi për laboratorët mjekësor që i korrespondojnë procedimit penal nr. 18, datë 31.01.2022, të regjistruar pranë SPAK dhe tenderi për blerjen e respiratorëve gjatë pandemisë Covid 19, ju informojmë se pas verifikimeve të kryera në Kryesekretarinë e kësaj gjykate, deri më tani, nuk rezulton që të jetë regjistruar ndonjë kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq apo kërkesë për pushim çështje lidhur me çështjet e sipërcituara. II) Lidhur çështjen e K.R, ish-zëvendës Ministri i Shëndetësisë, dhe I.B, ish-Ministër i Shëndetësisë, ju informojmë se: Me datë 29.03.2024 pranë kësaj gjykate është regjistruar kërkesa e paraqitur nga		
--	---	--	--	--

	afera të tjera; 6. Tenderi për laboratorët mjekësorë që i korrespondon procedimit penal nr. 18, datë 31.01.2022, të regjistruar pranë SPAK; 7. Tenderi për blerjen e respiratorëve gjatë pandemisë Covid 19; 8. Çështja e K.R, ish-zëvendës Ministër i Shëndetësisë, dhe I.B, ish-Ministër i Shëndetësisë, raportuar nga media si i përfshirë në afere korruptive në çështjen e hemodializës dhe check-up-it falas; 9. Çështja e L.Sh dhe J.D ish-zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë, raportuar nga media si të përfshira në afere korruptive, kërkohet informacion i detajuar në përgjigje të pyetjeve të mëposhtme: 1. Cila prej çështjeve të sipërcituara është regjistruar pranë GJKKO dhe cili është numri dhe viti i regjistrimit të çështjes? 2. Në ngarkim të cilit subjekt	Prokuroria e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me objekt “Dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. 13 të vitit 2020 ndaj të pandehurve I.B, K.R, I.Rr, M.S, S.K, P.M, A.Gj, G.B dhe N.A (A.)”, e cila është hedhur në short me datë 02.04.2024. Theksojmë se dosja penale, e sipërcituar, lidhet me Kontratën e Koncesionit/Partneritet Publik Privat, me objekt “Për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterilë, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale”, zhvilluar nga Autoriteti kontraktues Ministria e Shëndetësisë. Me vendimin Nr. 13/69, datë 23.01.2025, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur: I. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. II. Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 13, të vitit 2020 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të		
--	---	---	--	--

		është dhënë akuza dhe për llogari të cilit subjekt po zhvillohet gjykimi dhe cili është objekti i gjykit? 3. Cila është faza e gjykit për secilën prej çështjeve dhe a është marrë ende vendimi përfundimtar? Në rast se po, lutemi në specifikimin e alternativeve të mëposhtme: a) Vendim pafajësie duke na vënë në dispozicion dispozitivin e vendimit; b) Vendim fajësie duke na vënë në dispozicion dispozitivin e vendimit; c) Vendim për mbylljen e çështjes duke na vënë në dispozicion dispozitivin e vendimit. 4. Nëse ka një vendimmarrje përfundimtare, a është ushtruar ankim ndaj vendimit përfundimtar? Dokumentet dhe informacionet mund të na vihen në dispozicion në formë fizike (hard copy) ose elektronike.		Organizuar, në ngarkim të të pandehurve: 1. I.B, akuzuar për kryerjen e veprave penale të “<i>Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën</i>”, kryer në bashkëpunim të posaçëm, atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 135, 28/4 e 334/1 të Kodit Penal; “<i>Grupi i strukturuar kriminal</i>”, parashikuar nga neni 333/a/1 të Kodit Penal; 2. K.R, akuzuar për kryerjen e veprave penale të “<i>Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën</i>”, kryer në bashkëpunim të posaçëm, atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 135, 28/4 e 334/1 të Kodit Penal; “<i>Grupi i strukturuar kriminal</i>”, parashikuar nga neni 333/a/1 të Kodit Penal, dhe “<i>Falsifikimi i dokumenteve</i>”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 186/3 e 25 të Kodit Penal; 3. I.Rr, akuzuar për kryerjen e veprave penale të “<i>Vjedhjes</i>”, me pasojë të rëndë, e kryer në bashkëpunim të posaçëm, atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 134, paragrafi tretë dhe 28/4 e 334/1 të Kodit Penal; “<i>Grupi i strukturuar kriminal</i>”, parashikuar nga neni 333/a/1 të Kodit Penal; 4. M.S, akuzuar për kryerjen e veprave penale të “<i>Falsifikimit të dokumentave</i>”	
--	--	---	--	---	--

				kryer në bashkëpunim dhe “<i>Shpërdorimit të detyrës</i>” kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 186/3 – 25 dhe 248 - 25 të Kodit Penal; 5. S.K, akuzuar për kryerjen e veprave penale të “<i>Falsifikimit të dokumentave</i>” kryer në bashkëpunim dhe “<i>Shpërdorimit të detyrës</i>” kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 186/3 – 25 dhe 248 - 25 të Kodit Penal; 6. P.M, akuzuar për kryerjen e veprave penale të “<i>Falsifikimit të dokumentave</i>” kryer në bashkëpunim dhe “<i>Shpërdorimit të detyrës</i>” kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 186/3 – 25 dhe 248 - 25 të Kodit Penal; 7. A.Gj, akuzuar për kryerjen e veprave penale të “<i>Falsifikimit të dokumentave</i>” kryer në bashkëpunim dhe “<i>Shpërdorimit të detyrës</i>” kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 186/3 – 25 dhe 248 - 25 të Kodit Penal; 8. G.B, akuzuar për kryerjen e veprave penale të “<i>Falsifikimit të dokumentave</i>” kryer në bashkëpunim dhe “<i>Shpërdorimit të detyrës</i>” kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 186/3 – 25 dhe 248 - 25 të Kodit Penal; 9. N.A (A.), akuzuar për kryerjen e veprave		
--	--	--	--	--	--	--

				penale të “<i>Falsifikimit të dokumentave</i>” kryer në bashkëpunim dhe “<i>Shpërdorimit të detyrës</i>” kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 186/3 – 25 dhe 248 - 25 të Kodit Penal, <u>trupit gjykues të themelit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Tiranë.</u> III. Së bashku me kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për dërgimin e çështjes në gjyq, dërgohet edhe kërkesa e të pandehurve K.R, I.Rr, M.S, S.K, P.M, A.Gj, G.B dhe N.A (A.), për gjykim të shkurtuar. IV. Fashikulli i gjykimit përmban të gjitha aktet e kryera gjatë hetimit paraprak të procedimit penal nr. 13, të vitit 2020 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, si dhe ato të marra në seancë paraprake, të paraqitura nga të pandehurit dhe mbrojtësit. V. Kundër vendimit për dërgimin e çështjes në gjyq nuk lejohet ankim. Me datë 03.02.2025 pranë kësaj gjykate është regjistruar dosja penale për gjykimin e çështjes së sipërcituar (themel) me nr. 66 regjistri themeltar, e cila është hedhur në short me datë 05.02.2025. Trupi gjykues që ka marrë në shqyrtim këtë dosje penale, me vendimin e ndërmjetëm nr.		
--	--	--	--	---	--	--

				66 akti, datë 28.05.2025 ka vendosur: Ndarjen e çështjes penale në ngarkim të të pandehurve, 1. K.R, 2. I.Rr, 3. M.S, 4. S.K, 5. P.M, 6. A.Gj, 7. G.B, 8. N.A. (A.) me akuzat respektive, nga ajo e të pandehurit I.B, për shkak të pranimi të gjyqësorit të shkurtuar për ata të parët. Ngarkohet sekretaria gjyqësore për formimin e fashikullit të ri, të gjyqësorit dhe të kryejë kalimin e çështjes penale për rishortim për të pandehurin I.B. Aktualisht gjykimi i dosjes penale në ngarkim të të pandehurve K.R, I.Rr, M.S, S.K, P.M, A.Gj, G.B dhe N.A (A) po zhvillohet me procedurën e gjyqësorit të shkurtuar dhe ndodhet në fazën e paraqitjes së konkluzioneve përfundimtare nga ana e Prokurorisë. Ndërsa, sa i përket dosjes penale në ngarkim të të pandehurit I.B, pra dosjes së ndarë, me nr. 99 regjistri themeltar, datë regjistrimi 28.05.2025, aktualisht, Kryesekretaria e kësaj gjykate është në pritje të përfundimit të fotokopjimit të dosjes, e cila përmban 602 (gjashtëqind e dy) volume hetimore dhe 8 (tetë) volume gjyqësore, si dhe dorëzimit të dosjes në sekretari, në mënyrë që dosja të hidhet në short. III) Lidhur me çështjen e L.Sh dhe J.D, ju informojmë se:		
--	--	--	--	--	--	--

				Me datë 17.07.2023 pranë kësaj gjykate është rregjistruar kërkesa e paraqitur nga Prokuroria e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me objekt “Dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. 10/1 të vitit 2023, me të pandehur J.D, L.Sh, V.T dhe S.Sh”, e cila është hedhur në short me datë 18.07.2023. Procedimi penal nr. 10/1 i viti 2023, ka lidhje me faktin penal të korrupsionit të evidentuar në procedurën e tenderit të shpallur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për LOT 1, “<i>Supervizim për rikonstruksionin e disa Qendrave Shëndetësore në Qarqe Tiranë dhe Durrës, me fond limit 805.872 lekë</i>”. Trupi gjykues i kësaj dosje penale, me vendimin e datës 13.09.2023, në seancë paraprake, ka vendosur: • Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin e Organizuar. • Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 10/1 të vitit 2023, të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, në ngarkim të të pandehurve: 1. J.D, e bija e S. dhe e S., e datëlindjes ****, lindur në ****, banuese në ****, me	
--	--	--	--	---	--

				kombësi dhe shtetësi shqiptare, me gjendje civile “e martuar”, me gjendje gjyqësore “e padënuar”; <u>e akuzuar</u> për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë</i>”, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal. 2. L.Sh, e bija e Dh. dhe e R., e datëlindjes ****, lindur në ****, banuese në ****, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, me gjendje civile “e martuar”, me gjendje gjyqësore “e padënuar”; <u>e akuzuar</u> për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë</i>”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 245 e 25 të Kodit Penal. 3. V.T, i biri i R. dhe i F., i datëlindjes ****, lindur në **** dhe banues në ****, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, me gjendje civile “i martuar”, me gjendje gjyqësore “i padënuar”; <u>i akuzuar</u> për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë</i>”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 245 e 25 të Kodit Penal. 4. S.Sh, i biri i L. dhe i M., i datëlindjes ****, lindur në **** dhe banues në ****,		
--	--	--	--	--	--	--

				me kombësi dhe shtetësi shqiptare, me gjendje civile “beqar”, me gjendje gjyqësore “i padënuar”; <u>i akuzuar</u> për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendor</i>”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 245 e 25 të Kodit Penal. trupit gjykues të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar, i përbërë nga gjyqtarja e seancës paraprake, duke i’u drejtuar Zëvendëskryetares së Gjykatës për plotësimin e trupit gjykues. • Së bashku me kërkesën e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për dërgimin e çështjes në gjyq, dërgohet dhe kërkesa e të pandehurve J.D, L.Sh, V.T dhe S.Sh, për gjykim të shkurtuar. • Fashikulli i gjykimit përmban të gjitha aktet e kryera gjatë hetimit paraprak të procedimit penal nr. 10/1 të vitit 2023 të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar të paraqitura nga prokurori në Gjykatë, duke përfshirë dhe deklaratimet e marra në atë fazë, si dhe ato të marra në seancë paraprake.		
--	--	--	--	---	--	--

			• Kundër këtij vendimi, për dërgimin e çështjes në gjyq, nuk lejohet ankim. Me datë 15.09.2023 është hedhur shorti për anëtarët e trupit gjykues për gjykimin e kësaj çështje penale (themel). Me vendimin nr. 75, datë 13.11.2023 Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur: 1. Deklarimin fajtor të të pandehurës J.D, për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë</i>”, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 4 (katër) vjet burgim. • Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, uljen e dënimit me 1/3, duke e dënuar përfundimisht të pandehurën J.D me 2 (dy) vjet e 8 (tetë) muaj burgim. • Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, heqjen e të drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurën J.D për 5 (pesë) vjet. • Bazuar në nenin 33 të Kodit Penal si dhe nenin 15 të Ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, vuajtja e dënimit për të pandehurën J.D do të fillojë të llogaritet nga dita e arrestimit të saj dhe	
--	--	--	---	--

				do të kryhet në një nga Institucionet për të dënuarit e rritur dhe të sigurisë së zakonshme. 2. Deklarimin fajtor të të pandehurës L.Sh, për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë</i>”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 245 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e saj me 1 (një) vit burgim. • Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, uljen e dënimit me 1/3, duke e dënuar përfundimisht të pandehurën L.Sh me 8 (tetë) muaj burgim. • Bazuar në nenin 33 të Kodit Penal si dhe nenin 15 të Ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, vuajtja e dënimit për të pandehurën L.Sh do të fillojë të llogaritet nga dita e arrestimit të saj dhe do të kryhet në një nga Institucionet për të dënuarit e rritur dhe të sigurisë së zakonshme. 3. Deklarimin fajtor të të pandehurit V.T, për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë</i>”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 245 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1		
--	--	--	--	--	--	--

				(një) vit burgim. • Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, uljen e dënimit me 1/3, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin V.T me 8 (tetë) muaj burgim. • Bazuar në nenin 33 të Kodit Penal si dhe nenin 15 të Ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, vuajtja e dënimit për të pandehurin V.T do të fillojë të llogaritet nga dita e ndalimit të tij dhe do të kryhet në një nga Institucionet për të dënuarit e rritur dhe të sigurisë së zakonshme. 4. Deklarimin fajtor të të pandehurit S.Sh, për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë</i>”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 245 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim. • Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, uljen e dënimit me 1/3, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin S.Sh me 8 (tetë) muaj burgim. • Bazuar në nenin 33 të Kodit Penal si dhe nenin 15 të Ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, vuajtja e		
--	--	--	--	--	--	--

				dënimin për të pandehurin S.Sh do të fillojë të llogaritet nga dita e ndalimit të tij dhe do të kryhet në një nga Institucionet për të dënuarit e rritur dhe të sigurisë së zakonshme. - Lidhur me provat materiale, sipas akteve që ndodhen në fashikullin e gjykimit, në respektim të nenit 36 të Kodit Penal dhe 190 të Kodit të Procedurës Penale, - 1 (një) celular i markës Samsung “Note 20 Ultra” me nr. IMEI **** dhe nr. IMEI ****, të mbetet pjesë e fashikullit të gjykimit, për efekt të procedimit penal të ndarë. - Shuma monetare në vlerën 330,000 (treqind e tridhjetë mijë) lekë, të konfiskuara të pandehurës J.D, të kalojë në favor të shtetit. 5. Shpenzimet proceduriale të kryera gjatë fazës së hetimit paraprak, seancës paraprake dhe gjatë gjykimit, i’u ngarkohen të pandehurve në mënyrë solidare. 6. Kundër vendimit lejohet apel brenda afatit ligjor, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Po ashtu, ju informojmë se, kundër vendimit nr. 75, datë 13.11.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për		
--	--	--	--	--	--	--

				Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kanë bërë ankim të pandehurit J.D dhe V.T, nëpërmjet mbrojtësve, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 19, datë 10.05.2024, ka vendosur: Ndryshimin e vendimit nr. 75, datë 13.11.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si më poshtë: - Deklarimin fajtor të të pandehurës J.D, për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, e parashikuar nga neni 259, paragrafi dytë i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 4 (katër) vjet burgim. - Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, uljen e dënimit me 1/3, duke e dënuar përfundimisht të pandehurën J.D me 2 (dy) vjet e 8 (tetë) muaj burgim. - Në aplikim të nenit 35 pika 1 të Kodit Penal, heqjen e të drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurën J.D për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh. - Deklarimin fajtor të të pandehurës L.Sh, për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsioni</i>	
--	--	--	--	---	--

				<i>aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 244, paragrafi dytë, në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal dhe dënimin e saj me 1 (një) vit burgim. - Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, uljen e dënimit me 1/3, duke e dënuar përfundimisht të pandehurën L.Sh me 8 (tetë) muaj burgim. - Deklarimin fajtor të të pandehurit V.T, për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 244, paragrafi dytë, në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim. - Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, uljen e dënimit me 1/3, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin V.T me 8 (tetë) muaj burgim. - Deklarimin fajtor të të pandehurit S.Sh, për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 244, paragrafi dytë, në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim. - Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, uljen e dënimit me 1/3, duke e dënuar		
--	--	--	--	--	--	--

				përfundimisht të pandehurin S.Sh me 8 (tetë) muaj burgim. - Lënien në fuqi të vendimit për pjesët e tjera të tij. - Shpenzimet gjyqësore në apel i ngarkohen të pandehurve apelues solidarisht.		
35.	12.06.2025	Kërkesë për informacion: Lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, lutemi nga gjykatat tuaja përcjelljen e informacioneve të kërkuara për vitin 2024, në pikat e mëposhtme: 1.Rubrika: Offenders – (Shkelësit) Plotësimi i informacionit të kërkuar për këtë rubrikë nevojitet në përputhje me nënçështjet e referuara në tabelë për secilën nga pikat e mëposhtme: -Pika 4 “Persons convicted of trafficking in persons (preferably convicted in the court of first instance)” – (Personat e dënuar për	16.06.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 35, datë 12.06.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të GJKKO-së, referuar ligjit nr. 119/2014, “<i>Për të drejtën e informimit</i>”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Pas verifikimeve të kryera në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve të kësaj Gjykate, po ashtu edhe në Kryesekretarinë e Gjykatës, rezulton se gjatë vitit 2024, nga kjo gjykatë nuk është dhënë asnjë vendim dënimi për veprat penale që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore, sipas pyetësorit të Zyrës ****, duke përfshirë këtu, veprat penale si: “<i>Trafikimi i personave të rritur</i>”, parashikuar nga neni 110/a i K.Penal; “<i>Përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruar nga personat e trafikuar</i>”, parashikuar nga neni 110/b i K.Penal; “<i>Veprimet që lehtësojnë trafikimin</i>”, parashikuar nga neni 110/c i K.Penal; “<i>Shfrytëzim i prostitucionit</i>”, parashikuar nga neni 114 i K.Penal i	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		<i>trafikim të qenieve njerëzore</i>); -Pika 5 “Persons convicted of trafficking in persons by forms of exploitation”- <i>(Personat e dënuar për trafikim të qenieve njerëzore, sipas formave të shfrytëzimit);</i> -Pika 6 “With reference to Question 4, please list the citizenships and number of persons convicted of trafficking in persons. Please start with the citizens of your own country”. – <i>(Në referim të pyetjes 4, listoni shtetësinë e personave të dënuar për trafikim të qenieve njerëzore duke filluar nga shtetasit shqiptarë).</i> 2.Rubrika: Court Case - <i>(Çështje gjyqësore)</i> Referuar kësaj rubrike, lutemi përcjelljen e një informacioni të përmbledhur mbi një çështje të rëndësishme gjyqësore të përfunduar me dënim për trafikim të qenieve njerëzore, gjatë vitit 2024, i		K.Penal; “<i>Mbajtja e lokaleve për prostitucion</i>”, parashikuar nga neni 115 i K.Penal; “<i>Trafikimi i të miturve</i>”, parashikuar nga neni 128/b i K.Penal. Bashkëlidhur po ju dërgojmë edhe pyetësin e plotësuar për GJKKO-në.		
--	--	--	--	---	--	--

		cili duhet të përmbajë: -Detaje mbi fazën hetimore dhe operacionin e shpëtimit; - Profili i viktimave (gjinia, mosha, kombësia, prejardhja socio-ekonomike, çdo faktor tjetër relevant); - Profili i shkelësit; - Lloji i shfrytëzimit dhe mjetet e përdorura; - Rrethana rënduese (nëse ka).				
36.	13.06.2025	Kërkesë për informacion: 1. Sa është numri i çështjeve nën gjykim për të moshuarit që ju kanë humbur vitet e punës dhe kanë hapur padi për pensionet? 2. Sa vendime u dhanë për vitin 2024 për padi pensioni? 3. Statistika në lidhje me paditë për paditë për kompesim burgimi të padrejtë? Sa janë aktualisht dhe sa kanë qenë vitin e kaluar?	19.06.2025	Në përgjigje të shkresës suaj nr. 2957/2 Prot, datë 09.06.2025, protokolluar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me nr. 2389 Prot. datë 11.06.2025, me lëndë: “Kërkesë për informacion, znj. A.H.”, regjistruar me datë 13.06.2025, me numër rendor 36 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju lutem gjeni më poshtë informacionin e kërkuar: 1. Sa është numri i çështjeve nën gjykim për të moshuarit që ju kanë humbur vitet e punës dhe kanë hapur padi për pensionet? • Ju bëjmë me dije se, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas nenit 75/a të K.Pr.Penale, ka në kompetencën e saj	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

				lëndore gjykimin e: a) krimeve të parashikuara nga nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 244, paragrafi 2, 244/a, 245, 245/1, paragrafët 2 dhe 4, 257, 258, paragrafi 2, 259, paragrafi 2, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, 328 dhe 328/b të Kodit Penal; b) çdo vepre penale të kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal; c) akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj; ç) akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.		
--	--	--	--	---	--	--

				Gjykimi i çështjeve mbi paditë e pensioneve nuk është në kompetencën lëndore të kësaj gjykate. 2. Sa vendime u dhanë për vitin 2024 për padi pensioni? • Ju lutemi referohuni përgjigjes më sipër të pyetjes nr. 1. 3. Statistika në lidhje me paditë për padi për kompesim burgimi të padrejtë? Sa janë aktualisht dhe sa kanë qenë vitin e kaluar? • Ju informojmë se, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk disponon informacion mbi dëmshpërblimin për burgim të padrejtë pasi, këto kërkesa shqyrtohen nga gjykatat administrative.		
37.	18.06.2025	Kërkesë për informacion: Kërkohet informacion për veprat penale në kuadër të zgjedhjeve parlamentare të dt. 11 Maj 2025, si vijon: 1. Numrin e çështjeve dërguar për gjykim pranë Gjykatës Tuaj nga Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, për periudhën Maj – Qershor	24.06.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, protokolluar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me datë 12.06.2025, me nr. 2390 prot., regjistruar në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të kësaj Gjykate me datë 18.06.2025, me numër rendor 37, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Për periudhën kohore 01.05.2025 - 12.06.2025 (datë në të cilën është depozituar	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		2025 (deri në datën e mbërritjes së kësaj shkrese), për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, për të cilat Gjykata Juaj është kompetente, sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale. 2. Ankime të vendimeve të SPAK-ut nga subjektet e legjitimuar në Gjykatën Tuaj lidhur me këto çështje (si psh ankime ndaj vendimeve të mosfillimit të procedimit penal). 3. Fazën e shqyrtimit në të cilën ndodhen këto çështje pranë Gjykatës Tuaj. 4. Nëse gjykata është shprehur me vendime lidhur me këto çështje, lutemi të na vihen në dispozicion fotokopje të anonimizuara (sa i takon identitetit të të pandehurve/personave në hetim) të vendimeve përkatëse.		kërkesa juaj pranë GJKKO-së), nga verifikimet e kryera në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve të kësaj Gjykate, po ashtu edhe në Kryesekretarinë e Gjykatës, rezulton se nuk është paraqitur asnjë kërkesë me objekt “Dërgimin e çështjes në gjyq” apo “Pushim çështje” për veprat penale të parashikuara në Kreun X të Kodit Penal <i>“Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve”</i>. Lidhur me kërkesat penale me objekt <i>“Ankim kundër vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal”</i>, parashikuar nga neni 291, pika 2 i K.Pr.Penale, të paraqitura pranë kësaj gjykate, gjatë periudhës kohore 01.05.2025 - 12.06.2025, për të cilat ka përfunduar shqyrtimi gjyqësor, ju informojmë se vetëm në një rast rezulton që kallëzimi të jetë bërë për veprën penale <i>“Korrupsion aktiv në zgjedhje”</i> (lidhur me zgjedhjet parlamentare të datës 11 Maj 2025), parashikuar nga neni 328 i K.Penal dhe <i>“Shpërdorim detyre”</i>, parashikuar nga neni 248 i K.Penal, kërkesë e cila është rrëzuar nga ana e gjykatës. Neni 291, pika 3 i K.Pr.Penale parashikon shprehimisht se: <i>“Ankimi shqyrtohet nga gjyqtari që gjykon kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake në dhomë këshillimi, brenda 30 ditëve nga depozitimi në sekretarinë e gjykatës të</i>	
--	--	--	--	--	--

				<i>kopjes së akteve që përmban fashikulli i vendimit të mosfillimit të procedimit. Prokurori, jo më vonë se 15 ditë nga paraqitja e ankimit, i dërgon gjykatës një kopje të akteve që përmban fashikulli i vendimit të mosfillimit, si dhe ka të drejtë të paraqesë parashtrime me shkrim lidhur me bazueshmërinë e ankimit”.</i> Për sa më sipër, duke qenë se kërkesat penale me objekt “Ankim kundër vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal” i përkasin fazës së hetimeve dhe shqyrtohen nga gjykata në dhomë këshillimi, ju informojmë se vendimet e gjykatës mbi këto kërkesa penale nuk mund t’ju vihen në dispozicion. Po ashtu, ju bëjmë me dije se për kërkesat e tjera penale me objekt “Ankim kundër vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal”, të paraqitura gjatë të njëjtës periudhë kohore, për të cilat akoma nuk ka përfunduar shqyrtimi gjyqësor, në kushtet që këto kërkesa shqyrtohen në dhomë këshillimi, nuk disponojmë informacion lidhur me përmbajtjen e kallëzimeve		
38.	20.06.2025	Kërkesë për vënien në dispozicion të kopjes së vendimit nr. 36, datë 20.05.2025 të Gjykatës së	27.06.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj me objekt “Kërkesë për informacion”, depozituar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.		Organizuar me datë 19.06.2025, protokolluar me nr. 2507 Prot., datë 19.06.2025 dhe regjistruar në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të kësaj gjykate me datë 20.06.2025, me numër rendor 38, sipas ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Në zbatim të nenit 382, pika 4 të K.Pr.Penale, i cili parashikon shprehimisht se: “Afati i parashikuar për të arsyetuar vendimin me shkrim, sipas pikave 2 dhe 3, të këtij neni, mund të zgjatet në raste përjashtimore, për shkaqe të përligjura. Në këtë rast njoftohet kryetari i gjykatës”, me shkresën nr. 70 Regj.Them., datë 16.06.2025 kryesuesi i trupit gjykues që ka gjykuar çështjen penale në ngarkim të të pandehurit A.Z, gjyqtari E.Ç ka njoftuar kryetarin e gjykatës për zgjatjen e afatit të arsyetimit të vendimit nr. 36, datë 20.05.2025, të kërkuar nga ana juaj. Për sa më sipër, ju informojmë se vendimi i arsyetuar me nr. 36, datë 20.05.2025 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me të pandehur A.Z, sapo të depozitohet në kryesekretarinë e gjykatës do të publikohet në faqen zyrtare të gjykatës, gjykata.gov.al dhe do t’ju vihet në dispozicion.	
--	--	--	--	--	--

39.	25.06.2025	Kërkesë për informacion: ... Kërkohet nga ana e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar informacion nëse av. E.K ka pasur ndonjë çështje apo seancë gjyqësore si avokate pranë kësaj gjykate në datën 05.06.2025.	30.06.2025	Në përgjigje të kërkesës për informacion të depozituar nga ana juaj me datë 20.06.2025, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si përfaqësues i kërkuës D.C, protokolluar pranë kësaj gjykate me nr. 2523 prot., datë 20.06.2025 dhe regjistruar në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të kësaj gjykate me datë 25.06.2025, me numër rendor 39, referuar ligjit nr. 119/2014, <i>“Për të drejtën e informimit”</i> , i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Avokatja E.K ka marrë pjesë në seancën gjyqësore të datës 05.06.2025, ora 14.00, të zhvilluar pranë kësaj gjykate, në cilësinë e mbrojtëses, përfaqësueses së zgjedhur me prokurë të posaçme për subjektin L.S.B. alias G.N.B. (J.) dhe personin e lidhur me subjektin, shtetasen A.S.B, në kuadër të shqyrtimit të kërkesës për konfiskim pasurie nr. 11/31 regj. themeltar, datë regjistrimi 09.04.2024, me palë kërkuese Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe subjekt shtetasin L.S.B. alias G.N.B. (J.).	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka
40.	30.06.2025	Kërkesë për vënie në dispozicion të vendimeve të ndërmjetme:	30.06.2023	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 40, datë 30.06.2025 në regjistrin përkatës të	Përfunduar (Dërguar)	Nuk ka

		Vënien në dispozicion të vendimeve të ndërmjetme për pezullim të afateve të paraburgimit që janë dhënë për çeshtjet: numër 30, regjistruar në vitin 2023 me të pandehur P.K., Dh.A.B. Çështjen numër 49, regjistruar në vitin 2024 me të pandehur J.G., etj. Çështjen numër 70, e regjistruar në vitin 2023 me të pandehur A.B, L.K., etj. Çështjen me numër 72, e regjistruar në vitin 2023 me të pandehur L.K., etj.		kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Vendimet e ndërmjetme për pezullim të afateve të paraburgimit në dosjet penale të kërkuara nga ana juaj, të shqyrtuara pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin janë të zbardhuara në procesverbalet e seancave gjyqësore të dosjeve përkatëse, të cilat aktualisht kjo gjykatë nuk i disponon fizikisht pasi janë dërguar për gjykim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Lartë, më konkretisht: 1. Dosja penale nr. 30/104 regj.themeltar, datë regjistrimi 22.09.2023, nr. 14 vendimi, datë vendimi 05.03.2024, me të pandehur Dh.A.B. dhe P.K. ndodhet në Gjykatën të Lartë; 2. Dosja penale nr. 70 regj.themeltar, datë regjistrimi 03.03.2023, nr. 61 vendimi, datë vendimi 05.10.2023, me të pandehur L.K., A.B., P.A., etj... ndodhet në Gjykatë të Lartë; 3. Dosja penale nr. 72 regj.themeltar, datë regjistrimi 03.04.2023, nr. 57 vendimi, datë vendimi 25.09.2023, me të pandehur L.K, A.B, P.A, etj... ndodhet në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe	Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.)	
--	--	---	--	---	--	--

				Krimin e Organizuar; 4. Dosja penale nr. 49/127 regj.themeltar, datë regjistrimi 02.12.2024, nr. 25 vendimi, datë 13.03.2025, me të pandehur J.G., J.B. dhe V.Gj. ndodhet në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Për sa më sipër, në zbatim të nenit 12, pika 2 të ligjit nr. 119/2014, <i>“Për të drejtën e informimit”</i>, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: <i>“Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuar. Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar”</i>, kërkesa juaj për informacion i është përcjellë për shqyrtim ditën e sotme autoriteteve publike kompetente, Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykatës së Lartë. Në referim të nenit 12, pika 3 të ligjit nr.119/2014, <i>“Për të drejtën e informimit”</i>, i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se: <i>“Autoriteti publik, të cilit i është drejtuar kërkesa për informim, njofton kërkuar se kërkesa e tij i është dërguar një autoriteti</i>		
--	--	--	--	---	--	--

				tjetër, si dhe e informon atë për kontaktet e autoritetit ku është dërguar kërkesa.”, po ju dërgojmë kontaktet e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykatës së Lartë, të publikuara në faqet e tyre zyrtare, si dhe adresat e institucioneve. 1) Email: enida.demiraj@gjykata.gov.al Nr. cel: +355697230447 Adresa: Rruga "Jordan Misja" 2) Email: info@gjykataelarte.gov.al ida.vodica@gjykataelarte.gov.al Adresa: Rruga “Ibrahim Rugova”, Tiranë, Shqipëri.		
41.	02.07.2025	Kërkesë për dokumentacionin e çështjes “A.”: ... Për të siguruar saktësinë dhe thellësinë maksimale të këtij raporti, do të isha shumë mirënjohëse për ndihmën tuaj në sigurimin e dokumentacionit dhe dosjeve përkatëse që lidhen me këtë çështje, si dhe çdo informacion tjetër që do të përmirësonte kuptimin tim mbi proceset gjyqësore, provat (siç janë wiretaps dhe dekriptimi i aplikacioneve Sky dhe EncroChat, dhe implikimet e saj të gjera.	04.07.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 41, datë 02.07.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas ligjit nr. 119/2014, “<i>Për të drejtën e informimit</i>”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Në nenin 105 të K.Pr.Penale nën titullin “Marrja e kopjeve, ekstrakteve dhe vërtetimeve” parashikohet se: “1. <i>Gjatë procedimit dhe pas përfundimit të tij, cilido që ka interes mund të marrë, me shpenzimet e veta, kopje, ekstrakte ose vërtetime të akteve të veçanta apo të regjistrimeve audio ose audiovizive. 2. Kërkesa shqyrtohet nga</i>	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		Besoj se ky kontribut në bazën e të dhënave S. do të shërbejë si një burim i vlefshëm për studiuesit dhe praktikuesit e ligjit ndërkombëtar, duke theksuar gjithashtu rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar në çmontimin e ndërmarrjeve komplekse kriminale.		<i>prokurori, për aktet e hetimit paraprak, ose nga gjykata që ka dhënë vendimin për ato të shqyrtimit gjyqësor. 3. Lëshimi i kopjeve, ekstrakteve ose vërtetimeve nuk e heq ndalimin e publikimit”.</i> Në interpretim të kësaj dispozite, vlerësojmë se, me togëfjalëshin “cilido që ka interes” sipas nenit 105 të K.Pr.Penale, ligjvënësi nënkupton prokurorin, të dyshuarin, personin nën hetim, të pandehurin, kallëzuesin, viktimën ose trashëgimtarët e tij, palët private pra paditësin ose të paditurin në padinë civile në procesin penal. Në këto kushte, çmojmë se ju nuk përfshihen në rrethin e subjekteve procedurale që legjitimohen për të marrë ekstrakte apo vërtetime të akteve të veçanta nga dosja për të cilën ju kërkon informacion. Po ashtu, sipas Udhëzuesit Standart të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median, miratuar me Vendimin Nr. 716, datë 06.12.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në nenin 12 nën titullin “Aksesi në dosjet gjyqësore”, në pikën 1 dhe 2 të tij, parashikohet se: “1. Dosjet gjyqësore aksesohen në çdo kohë nga palët në proces, përfaqësuesit ligjorë të tyre, gjyqtari apo trupa gjykuese e çështjes, prokurori/ët i/e çështjes, si dhe çdo person ose institucion publik tjetër i autorizuar sipas ligjit”. 2. Si	
--	--	--	--	---	--

				<i>rregull, personave të interesuar për përdorimin e vendimeve gjyqësore për qëllime studimore, shkencore, statistikore, literature apo gazetarie, i vihet në dispozicion vetëm kopja e vendimit të plotë, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi...”.</i> Përveç parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, vlerësojmë se ky udhëzues, në nenin 12 të tij e përcakton qartë se cilët janë subjektet që mund të kenë akses në çdo kohë në dosjet gjyqësore. Në interpretim të pikës 1 të nenit 12, të sipërcituar, vlerësojmë se ju nuk përfshihen në rrethin e subjekteve të autorizuar sipas ligjit, për të pasur akses në dosjen penale për të cilën ju kërkon informacion. Personave të interesuar për përdorimin e vendimeve gjyqësore për qëllime studimore, shkencore, statistikore, literature apo gazetarie, si rregull i vihet në dispozicion vetëm kopja e vendimit të plotë. Në këto kushte, për arsyet e sipërcituara, refuzojmë kërkesën tuaj për t’ju vënë në dispozicion aktet që përmban dosja penale e kërkuar nga ana juaj.		
42.	08.07.2025	Kërkesë për informacion: 1) Numri i trajnimeve të marra dhe gjyqtrëve të trajnuar në raste të lidhura me	10.07.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 42, datë 08.07.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

	kriptovalutat për periudhën kohore 2020 - Qershor 2025. 2) Numri i procedurave të gjyqësore të përfunduara me vendim (dënime) që përfshijnë asetet virtuale për periudhën kohore 2020 - Qershor 2025. 3) Numri i procedurave të gjyqësore të përfunduara me vendim (shfajësime) që përfshijnë asetet virtuale për periudhën kohore 2020 - Qershor 2025. Përveç një liste pyetjesh që iu dërguan institucioneve përkatëse bazuar në ligjin për qasje në dokumente publike, ne kemi hartuar një pyetësor të detajuar për t'u diskutuar me një zyrtar të caktuar nga institucioni juaj. Do ta vlerësonim shumë mbështetjen tuaj në lehtësimin e këtij procesi duke koordinuar një takim me zyrtarin përkatës. Për shkak të kohës shumë të		Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas ligjit nr. 119/2014, <i>“Për të drejtën e informimit”</i>, i ndryshuar, ju bëj me dije si më poshtë: Së pari, lidhur me kërkesën tuaj mbi numrin e trajnimeve të marra dhe gjyqtarëve të trajnuar në raste të lidhura me kriptovalutat, ju informoj se gjyqtarët, Z. E.B, Znj E.D dhe Znj. F.D kanë marrë pjesë në një trajnim lidhur me këtë temë në Republikën Çeke, po ashtu gjyqtarja, Znj. F.H ka marrë pjesë në dy trajnime lidhur me kriptovalutat. Duke qenë se, në sistemin gjyqësor shqiptar akoma nuk ka një praktikë të konsoliduar në lidhje me trajtimin e aseteve virtuale, kriptomonedhave, nga ana e gjyqtarëve të kësaj gjykate është kërkuar që të shtohet numri i trajnimeve lidhur me këtë temë. Së dyti, për periudhën kohore 2020 – Qershor 2025 në asnjë prej vendimeve të themelit të dhëna nga kjo gjykatë, vendime dënimi apo pafajësie nuk ka pasur konfiskime të aseteve virtuale, kriptomonedhave. Në vijim të kësaj përgjigje, ju informojmë se për periudhën kohore 2024 – 2025, mbi kërkesat e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vendosje “sekuestro preventive”, sipas Kodit të Procedurës Penale, gjykata, në disa raste	
--	---	--	--	--

		kufizuar për kryerjen e hulumtimit dhe hartimin e raportit, do ta vlerësonim shumë organizimin e intervistës brenda dy javësh.		ka disponuar me vendim për sekuestrimin e asetëve virtuale, kriptomonedhave. Për shkak se, kërkesat për vendosje “sekuestro preventive”, të sipërcituara, i përkasën fazës së hetimeve, gjykata nuk mund t’ju japë informacion mbi këto kërkesa (Neni 17 “Kufizime”, pika 2, gërma “b” e ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar). Së treti, sa i përket kërkesës suaj për takim me një zyrtar të kësaj gjykate për të diskutuar dhe për t’ju përgjigjur një pyetësori të hartuar nga ana juaj në lidhje me kriptovalutat, ju informojmë se aktualisht gjyqtarët e kanë të pamundur të realizojnë një takim të tillë për shkak të ngarkesës në punë në këtë periudhë dhe faktit që një pjesë e gjyqtarëve tashmë janë me leje vjetore. Pavarësisht sa më sipër, ju informoj se gjyqtari B.N, i cili ka shqyrtuar kërkesa penale për vendosje “sekuestro preventive” mbi asetet virtuale, kriptomonedha, ka shprehur gatishmërinë për t’ju përgjigjuar pyetësorit të hartuar nga ana juaj, nëse mund të na e dërgoni elektronikisht nëpërmjet email-it, pasi siç e shpreha dhe më sipër, aktualisht e ka të pamundur t’ju takojë personalisht.		
--	--	---	--	--	--	--

43.	28.08.2025	Në vijim të komunikimeve tona të mëparshme dhe bazuar në përgjigjet tuaja të datave 10.12.2024, 12.12.2024 dhe 08.01.2025, ju drejtohem me një kërkesë të përditësuar dhe të zgjeruar mbi procedimin pasuror ndaj të pandehurve E.K dhe Xh.Xh, të iniciuar paralelisht me procesin penal të vendimit nr. 43, datë 08.07.2024, në bazë të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”. Kërkoj konkretisht: 1. Numrin e Aktit të procedimit pasuror të hapur sipas ligjit nr. 10192. 2. Statusin aktual të këtij procedimi – nëse vijon të jetë në fazë hetimi apo është përmbyllur. 3. Vendimin gjyqësor (nëse ekziston) të këtij procedimi pasuror. 4. Arsyen e vonesës në	02.09.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 43, datë 28.08.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas ligjit nr. 119/2014, “<i>Për të drejtën e informimit</i>”, i ndryshuar, ju bëj me dije si më poshtë: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, më datë 31.07.2023, ka regjistruar Procedimin Pasuror Nr. 13, që bën fjalë për pasuritë në zotërim të shtetasve E.K, Xh.Xh, etj. Procedimi pasuror nr. 13, i vitit 2023, është regjistruar mbi bazën e referimit të dërguar nga Byroja Kombëtare e Hetimit, për shtetasit e mësipërm dhe personave të afërm të cilët bazuar në nenin 3, pika 1, gërma “a” dhe pika 2, gërma “a”, janë subjekte të hetimit pasuror të Ligjit Nr. 10192, datë 03.12.2009 “<i>Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar, Trafikimit, Korrupsionit dhe Krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë</i>”, i ndryshuar. Me datë 25.04.2025 pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është regjistruar me nr. 30 regjistri themeltar,	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka
-----	------------	---	------------	---	---------------------	--------

		marrjen e vendimit, nëse procedimi nuk është përmbyllur ende. 5. Ndikimin juridik dhe praktik që ky procedim pasuror ka mbi mundësinë e dëmshpërblimit të viktimave, përfshirë qytetarët gjermanë të dëmtuar nga aktivitetet e call center-it. Bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ju rikujtoj se kufizimi i së drejtës për informacion është i lejueshëm vetëm kur është i domosdoshëm, proporcional dhe kur publikimi i informacionit shkakton dëm të qartë dhe të rëndë. Ligji kërkon vlerësim rast pas rasti, jo refuzim të përgjithshëm. Fakti që vendimet për sekuestrim pasuror merren në “dhomë këshillimi” sipas nenit 12 të ligjit nr. 10192 nuk përbën përjashtim automatik nga e drejta për informim. Kjo është formë procedurale, jo bazë për fshehje. Nëse ekziston një vendim gjyqësor, kërkoj të më konfirmoni nëse ai mund	kërkesa e Prokurorisë së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me objekt: “Konfiskimin e pasurive”, kundër pasurive të shtetasve E.K dhe Xh.Xh, persona të tretë: L.L, F.L dhe S.T. Aktualisht, pranë kësaj gjykate po shqyrtohet në seancë gjyqësore kërkesa për konfiskim e sipërcituar dhe ndodhet në fazën e njohjes së avokatëve me provat dhe aktet e depozituara nga organi i Prokurorisë. Duke qenë se, nga ana e Gjykatës akoma nuk ka një vendim përfundimtar mbi pasuritë e shtetasve të mësipërm, pasi pranë kësaj gjykate vijon të shqyrtohet kërkesa për konfiskim (përshtuar më sipër), po ju vendosim në dispozicion një informacion të përmbledhur mbi pasuritë e sekuestruara me vendimet nr. 16, datë 22.04.2025 dhe nr. 44, datë 17.12.2024 të GJKKO-së, të shqyrtuara në dhomë këshillimi. A) Me datë 18.04.2024 Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Sekuestrim i pasurive”, kundër pasurive të shtetasve E.K dhe Xh.Xh, persona të tretë: L.L, F.L dhe S.T. Në dhomë këshillimi, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe		
--	--	---	---	--	--

		të publikohet sipas legjislacionit në fuqi. Duke qenë se kërkesat e mia janë bërë që në nëntor 2024 dhe janar 2025, tani që jemi në fund të gushtit 2025, është legjitime të kërkohej një rivlerësim i statusit dhe transparencës. Nuk kërkoj akte sekrete, por një njoftim mbi statusin dhe qasje në vendime që nuk janë më konfidenciale. Ky informacion është i domosdoshëm për të vlerësuar nëse sistemi gjyqësor shqiptar po vepron në mënyrë të integruar dhe efektive për të garantuar drejtësi për viktimat.		Krimin e Organizuar me vendimin nr. 16, datë 22.04.2024 ka vendosur sekuestrimin e: 1) 1 (një) pasurie “Ndërtesë”, 3 (tre) pasuri “Apartament”, 1 (një) pasuri “Njësi”, 1 (një) pasuri “Garazh” dhe 1 (një) pasuri “Truall”, në emër të shtetasit E.K; 2) 1 (një) pasurie “Garazh”, 3 (tre) pasuri “Apartament” dhe 4 (katër) pasuri “Pemëtores”, në emër të shtetasve E.K dhe L.L; 3) 8 (tetë) llogarive bankare të subjektit E.K; 4) 3 (tre) pasurive “Apartament” dhe 1 (një) pasurie “Garazh”, në emër të shtetasve Xh.Xh dhe S.T. B) Me datë 13.12.2024 Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Sekuestrim i pasurive”, kundër pasurive të shtetasve E.K dhe L.L. Në dhomë këshillimi, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin nr. 44, datë 17.12.2024 ka vendosur sekuestrimin e: 1) 1 (një) pasurie “Apartament”; 2) Subjektit tregtar “*****” sh.p.k., me ortak 100% të kuotave shtetasin E.K. * Lidhur me pikën 5 të kërkesës suaj, ku ju	
--	--	---	--	--	--

				kërkoni informacion mbi ndikimin juridik dhe praktik që ky procedim pasuror ka mbi mundësinë e dëmshpërblimit të viktimave, përfshirë qytetarët gjermanë të dëmtuar nga aktivitetet e call center-it, ju informojmë se: Kjo pikë e kërkesës suaj, e cila ka të bëjë me vlerësimin e ndikimit juridik dhe praktik të një procedimi pasuror, është në tejkalim të drejtës për informim. Në nenin 2, pika 2 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: <i>“Informacion publik” është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdolloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik.</i> Në zbatim të kësaj dispozite ligjore, Zyra e Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbi kërkesën e kërkuesve, jep informacion mbi çështjet penale që shqyrtohen pranë kësaj gjykate, gjithmonë dhe në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, statistika, etj..., pra, jep informacion mbi të dhënat ekzistuese, jo vlerësime, siç kërkohet në rastin konkret nga ana juaj. Për sa më sipër, çmojmë se kjo pikë e		
--	--	--	--	--	--	--

				kërkesës nuk përfshihen në objektin e “informacionit publik”, në kuptim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.		
44.	28.08.2025	Kërkesë për informacion: Në kuadër të hulumtimeve tona gazetareske për ****, mbi konfiskimin e pasurive dhe kompensimin e viktimave sipas Ligjit Nr. 10192/2009 (“Ligji Antimafia”), ju drejtojmë këtë kërkesë për informacion mbi pikat e mëposhtme: 1. Cilat janë mekanizmat konkretë që zbatohen nga institucioni juaj për kompensimin e viktimave në rastet e konfiskimit të pasurive? 2. Si zbatohet në praktikë neni 37 i ligjit të sipërpërmendur, veçanërisht në lidhje me alokimin e fondeve për personat e dëmtuar? 3. Cila është vlera totale e fondeve të shpërndara nga pasuritë e konfiskuara që nga viti 2019, dhe si është bërë	02.09.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 44, datë 28.08.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëj me dije si më poshtë: Sa ju përket dy pyetjeve të para, konkretisht: 1. Cilat janë mekanizmat konkretë që zbatohen nga institucioni juaj për kompensimin e viktimave në rastet e konfiskimit të pasurive? 2. Si zbatohet në praktikë neni 37 i ligjit nr. 10 192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, veçanërisht në lidhje me alokimin e fondeve për personat e dëmtuar? Ju informojmë se pyetjet e dërguara nga ana juaj janë, kanë të bëjnë me interpretim të dispozitave ligjore dhe praktikave, dhe janë	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		shpërndarja e tyre? Kjo kërkesë mbështetet në Programin e Transparencës së institucionit tuaj si dhe në nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), që garanton të drejtën për akses në informacion me interes publik. Ju lutemi të na përgjigjeni me shkrim brenda afatit ligjor të parashikuar. Ju falënderojmë paraprakisht për bashkëpunimin në funksion të transparencës institucionale dhe informimit publik.		në tejkallim të drejtës për informim. Në nenin 2, pika 2 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: <i>“Informacion publik” është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdolloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik.</i> Në zbatim të kësaj dispozite ligjore, Zyra e Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbi kërkesën e kërkuësve, jep informacion mbi çështjet penale që shqyrtohen pranë kësaj gjykate, gjithmonë dhe në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, statistika, etj..., pra, jep informacion mbi të dhënat ekzistuese. Për sa më sipër, çmojmë se pyetjet e dërguara nga ana juaj nuk përfshihen në objektin e “informacionit publik”, në kuptim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar. Sa i përket pyetjes së tretë, konkretisht: 3. Cila është vlera totale e fondeve të shpërndara nga pasuritë e konfiskuara që nga viti 2019, dhe si është bërë	
--	--	--	--	---	--

				shpërndarja e tyre? Ju informojmë se përllogaritja e vlerës totale të fondeve të shpërndara nga pasuritë e konfiskuara apo shpërndarja e këtyre fondeve nuk është në kompetencën e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Në nenin 35, pika 1, të ligjit nr. 10 192, datë 03.12.2009 <i>“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”</i>, parashikohet shprehimisht se: <i>“Për mbikëqyrjen e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, si dhe për marrjen e vendimeve për destinacionin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara ngrihet dhe funksionon Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar. Ky komitet mblidhet pranë ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike”</i>. Po ashtu, në pikën 1, të nenit 37, të po këtij ligji, parashikohet shprehimisht se: <i>“Të ardhurat e përfituara nga zbatimi i këtij ligji shërbejnë për ngritjen e fondit të posaçëm për parandalimin e kriminalitetit dhe edukimin ligjor. Fondi i posaçëm është një</i>		
--	--	--	--	---	--	--

				<i>zë më vete në buxhetin e Agjencisë dhe administrohet me vendim nga Komiteti.”.</i>		
45.	01.09.2025	Kërkesë për informacion: Në bazë të ligjit nr. 119 dt. 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, neni 3, kërkojmë të na vendosen në dispozicion të dhënat për dënimet përfundimtare (dispozitivi) për të gjithë të gjykuarit që kanë qenë funksionarë apo zyrtarë publikë, të cilët janë dënuar prej vitit 2020 e në vijim nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për gjithë veprat penale që kanë të bëjnë me korrupsionin pasiv, me shpërdorimin e detyrës, falsifikimin e dokumenteve, me shkeljen e barazisë në tendera, apo çdo vepër tjetër penale. Më konkretisht, kërkojmë të na vendosen në dispozicion të dhënat për emrin e çdo të gjykuarit të dënuar për veprat penale të sipërcituara, dënimin e dhënë ndaj tij duke	15.09.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 45, datë 01.09.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO), sipas ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, bashkëlidhur këtij email-i po ju dërgojmë listën me dispozitivët e vendimeve të GJKKO-së për funksionarët publikë dhe zyrtarët e nivelit të lartë, të dënuar pranë kësaj gjykate, për periudhën kohore 2020 - Korrik 2025.	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		paqyruar edhe aplikimin e pezullimit të masës së dënimit dhe vendosjen në shërbim prove e secilit prej tyre, kur është disponuar edhe me pezullimin e ekzekutimit të masës së dënimit. Nëse është e mundur të na informoni dhe me kërkimin përfundimtar të SPAK, për secilin prej këtyre të gjykuarve. Të dhënat mund të dërgohen me CD me postë ose në variant të printuar ose me transferim elektronik (e-mail) sipas dëshirës suaj.				
46.	03.09.2025	Kërkesë për informacion dhe kopje aktesh: (Këtë të mërkurë (dt. 03.09.2025), në faqen zyrtare të GJKKO, është afishuar lista e gjyqtarëve të caktuar nga shorti për shqyrtimin e disa çështjeve gjyqësore. Mes të cilave evidentohet edhe emri i gjyqtarës I.Gj, si gjyqtare e përcaktuar përmes shortit për seancën paraprake ndaj shtetasit I.M... etj).	17.09.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 46, datë 03.09.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas ligjit nr. 119/2014, <i>“Për të drejtën e informimit”</i>, i ndryshuar, më poshtë gjeni analizën dhe informacionin e detajuar. 1. Veprimet paraprake të kryera për regjistrimin e çështjeve në sistem Në materialin Excel të bashkëngjitur gjenden të dhënat e gjeneruara nga databaza gjatë procesit të regjistrimit të çështjeve në	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		Kërkojmë, vënien në dispozicion të materialit audio dhe video të procedurës së hedhjes së shortit ku Gj. është caktuar/shortuar si gjyqtare paraprake për çështjen në fjalë. Kërkojmë procesverbalet përkatëse, të kësaj procedure për rastin specifik që interesohemi. Kush është personi përgjegjës që ka për detyrë hedhjen e shortit? Kush është kompania që menaxhon shortin? A është evidentuar ndonjë papajtueshmëri apo konflikt interesi gjatë kësaj procedure? A kanë qenë të gjithë gjyqtarët të pranishëm dhe nëse jo, kërkojmë një listë me emrat e gjyqtarëve prezent dhe gjyqtarëve që kanë munguar?	sistem, hedhjes në short, si edhe palët e regjistruara për çështjen dhe gjyqtarët e përjashtuar. 2. Veprimet paraprake për përjashtimin e gjyqtarëve Në sistem, lista e gjyqtarëve të përjashtuar është pasqyruar qartë dhe, siç evidentohet edhe në screenshot-in e bashkëngjitur, për çështjen me nr. akti 138, gjyqtari E.Ç rezulton i përjashtuar. (Gjyqtari E.Ç është përjashtuar si gjyqtar i hetimit paraprak.) Sqarime mbi tre tabelat e materialit në Exel: 1. Regjistrimi i çështjes në sistem Nga tabela DosjePenaleSP138 rezulton se çështja me nr. 138 është regjistruar më datë 29-08-2025, ora 15:08. Veprimet e kryera përfshijnë regjistrimin e të dhënave kryesore të dosjes: Nr. Çështjes (138), si dhe nenet përkatëse ("260 KP"), Nr të pandehurve (5 te pandehur: I.M, M.K, E.Ç, F.K, P.Xh), Organi Dërgues (Prokuroria), Përshkrimi i Akuzës (Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetëror ose i të zgjedhurve vendorë, në 3 raste, "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", e kryer në bashkëpunim, "Refuzim për deklaram, mosdeklaram, fshehja ose deklarimi i rremë i		
--	--	---	---	--	--

				pasurive interesave private të personave të zgjedhur dhe nënpunësve publikë", parashikuar nga nenet 260 dhe 25, 287/2 dhe 257/a/2 të Kodit Penal.), Rigjykim (Jo), Rihetim (Jo), DataParaqitjes (8/29/2025), DataRegjistrimit (8/29/2025) . 2. Palët e regjistruara në çështjen nr. 138 Nga tabela Palët del se në këtë çështje janë regjistruar 5 të pandehur: I.M, lindur më ****, Vendlindja ****, Vendbanim në ****. M.K, lindur më ****, Vendbanim në ****. E.Ç, lindur më ****. F.K, lindur më ****, Vendbanim në ****. P.Xh, lindur më ****, me banim në ****. Të gjithë janë regjistruar si të pandehur (TipiPandehurit = “F”) në të njëjtën datë dhe orë me regjistrimin e çështjes (29-08-2025 15:08:27). 3. Përjashtimi i gjyqtarëve Nga tabela Përjashtuarit, rezulton se për këtë çështje: Më datë 02-09-2025, ora 15:47, është regjistruar përjashtimi i gjyqtarit E.Ç. (Gjyqtari E.Ç është përjashtuar si gjyqtar i	
--	--	--	--	--	--

				hetimit paraprak.) Bashkëlidhur këtij email-i gjeni dhe etiketat e shortit për dosjet penale në seancë paraprake, të shortuara pranë kësaj gjykate me datë 03.09.2025. Po ashtu, në përgjigje të pyetjeve të dërguara nga ana juaj, ju referojmë në Vendimin nr. 554, datë 29.12.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, konkretisht në, Pikën II “Ndarja e çështjes me short elektronik dhe kodi unik i organizimit të shortit”, ku parashikohet se: 1. Zhvillimi i shortit në njësi përpunimi dhe ruajtje kryhet nëpërmjet algoritmeve që vërtetojnë autenticitetin e shortit, integritetin e të dhënave, sigurinë dhe auditimin e tyre. 2. Sistemi i shortit përdor algoritme për autentifikimin e gjykatës që kërkon procesin e shortimit. Çdo gjykatë përdor “çelësa të ndarë” (shared key) për të gjeneruar kod unik të çastit (One Time Password). Kjo procedurë synon garantimin e procedimit të mesazheve të dërguara vetëm nga gjykatat dhe çdo mesazh i tillë ka një autentifikimin të paimitueshëm në rast të gjurmimeve në rrjet (Man In The Middle Attacks). 3. Të dhënat e shortimeve ruhen të plota, në	
--	--	--	--	---	--

				mënyrë historike, të lidhura në mënyrë unike të paimitueshme me mesazhet sekuenciale, duke bërë procesin e auditueshëm dhe të dhënat e pa modifikueshme. 4. Sistemi elektronik i shortimit auditohet në mënyrë të automatizuar, nëpërmjet verifikimit të ekuivalencës së rezultatit të ruajtur lokalisht me atë në sistemin qendror dhe verifikimit të kodeve për të garantuar integritetin e bllokut të informacionit të ruajtur. 5. Sistemi elektronik i shortimit prodhon raporte periodike të auditimit ose mbi bazë të kërkesave për auditim (gjurmim) nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ose Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Pikën III “Procedurat dhe rregullat e ndarjes së çështjeve me short”, ku parashikohet se: 1. Çështjet gjyqësore, me paraqitjen në gjykatë, regjistrohen menjëherë në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve nga sekretaria gjyqësore, sipas kategorive të sistemit, nën mbikëqyrjen e kryesekretarit dhe kancelarit. 2. Kryetari i Gjykatës merr masa për organizmin e ndarjes së çështjeve		
--	--	--	--	---	--	--

				gjyqësore nëpërmjet shortit elektronik, duke përcaktuar orën në të cilën realizohet procedura e shortit elektronik. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të internetit të gjykatës. 3. Ndarja e çështjeve me short, si rregull, realizohet çdo ditë pune në rrugë elektronike me anë të sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore. 4. Në rast pamundësie të realizimit të shortit brenda ditës së punës, çështjet e regjistruara shorthohen jo më vonë se dita e nesërme e punës. 5. Në short përfshihen të gjitha çështjet e regjistruara në sistemin e menaxhimit të çështjeve deri në momentin e orës së publikuar të shortit. 6. Procesi i shortimit për ndarjen e çështjeve realizohet në sallë gjykimi dhe shfaqet në kohë reale në monitorët e vendosur në ambientet e hyrjes së gjykatës për aq sa është e mundur. 7. Raporti i shortimit është publik dhe pasqyrohet menjëherë në faqen zyrtare të internetit të gjykatës. 8. Shorti elektronik cakton gjyqtarin e çështjes, i cili është kryetari i trupit gjykues ose gjyqtarin relator, në rastet		
--	--	--	--	---	--	--

				kur çështja gjykohet me trup gjykues. 9. Çështjet gjyqësore u ndahen në mënyrë të barabartë gjyqtarëve, sipas organizimit të brendshëm të gjykatës. 10. Barazia në ndarjen e çështjeve nënkupton ndarjen në numër të barabartë mes gjyqtarëve të seksionit përkatës, të çështjeve të regjistruara për short, pavarësisht nga ngarkesa individuale e çdo gjyqtari në kohën e hedhjes së shortit. 11. Në çështjet penale me të mitur në konflikt me ligjin ose të mitur viktimë nga vepra penale, shorti për caktimin e gjyqtarit të çështjes, hidhet ndërmjet gjyqtarëve të seksionit përkatës. Në mungesë të këtij të fundit, shorti hidhet ndërmjet gjyqtarëve të caktuar për gjykimin e këtyre çështjeve penale. 12. Tërësia e veprimeve të shortimit në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve dokumentohet dhe vendoset në çdo rast në dosjen gjyqësore dhe bëhet pjesë përbërëse e saj. 13. Kancelari i gjykatës mbikëqyr procesin e shortimit dhe nënshkruan kalimin e praktikës së regjistrimit të çështjes, sipas formës standarde bashkëlidhur kësaj rregulloreje.		
--	--	--	--	--	--	--

				14. Ndarja e çështjeve gjyqësore me short pezullohet gjatë procesit të mbartjes së dosjeve si dhe gjatë lejes vjetore në muajin gusht. Afati i pezullimit përcaktohet me vendim të arsyetuar të Kryetarit të Gjykatës. 15. Këshilli i Lartë Gjyqësor publikon periodikisht manualin e përdorimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, përfshirë rubrikën e shortimit elektronik. Pikën V “Përjashtimi i gjyqtarit nga shorti”, ku parashikohet se: 1. Përjashtohet nga shorti gjyqtari, i cili ndodhet përpara njërës prej pengesave ligjore të tilla si: a. Gjyqtari që ka dhënë ose që ka marrë pjesë në dhënien e vendimit në një shkallë gjykimi përjashtohet nga shorti në shkallët e tjera; b. Gjyqtari që ka dhënë ose ka marrë pjesë në dhënien e vendimit përjashtohet nga shorti në rigjykim, përveçse kur është urdhëruar ndryshe nga një gjykatë më e lartë; c. Gjyqtari që ka shqyrtuar në themel kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, përjashtohet nga shorti për të gjykuar kërkesat në seancë paraprake		
--	--	--	--	---	--	--

				dhe kërkesat në gjykimin në themel të çështjes; d. Gjyqtari i seancës paraprake përjashtohet nga shorti për kërkesat në gjykimin në themel të çështjes, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe. 2. Kryetari i Gjykatës, pas kërkesës së motivuar të gjyqtarit, mund të përjashtojë nga shorti pjesërisht apo tërësisht gjyqtarin, gjatë lejes së papaguar, me afat deri në 30 ditë. Në këto raste Kryetari i Gjykatës disponon me vendim të arsyetuar. 3. Kryetari i gjykatës përjashton gjyqtarin nga shorti, menjëherë me miratimin e dorëheqjes me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor. 4. Kryetari i gjykatës, me vendim të arsyetuar, përjashton nga shorti gjyqtarin që mungon në detyrë për shkaqe të justifikuara, vetëm për ato çështje që lidhen me afate të ngutshme shqyrtimi. Në çdo rast shkaku i mungesës duhet të ketë lindur dhe t'i jetë bërë i ditur kryetarit para hedhjes së shortit. 5. Në rast nevojë të diktuar nga ngarkesa e pabarabartë e punës midis gjyqtarëve, kur mekanizmi i rindarjes së çështjeve		
--	--	--	--	---	--	--

				nuk mund të realizohet, kryetari me vendim të arsyetuar, përjashton plotësisht ose pjesërisht gjyqtarin nga ndarja me short e çështjeve, deri në sigurimin për aq sa është e mundur, e një ngarkese pune të barabartë midis gjyqtarëve. 6. Kryetari i gjykatave të mëdha mund të marrë një ngarkesë pune, jo më pak se 50% të ngarkesës së çdo gjyqtari, ndërsa kryetari i gjykatave të një madhësie mesatare e atyre të vogla, një ngarkesë pune jo më pak se 75% të ngarkesës së punës së një gjyqtari. Pikën VI “Ndarja e çështjeve me short manual”, ku parashikohet se: 1. Në rastin kur sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve nuk funksionin në mënyrë të dokumentuar, për më shumë se dy ditë pune, ndarja e çështjeve realizohet përmes shortit manual. 2. Ndarja e çështjeve me short manual realizohet nga Kancelari, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Gjykatës, si dhe pjesëmarrjen e gjyqtarëve të gjykatës, pasi janë njoftuar paraprakisht për zhvillimin e shortit manual. 3. Në çdo rast shorti manual i çështjeve		
--	--	--	--	---	--	--

				kryhet duke respektuar parimin e transparencës, ndarjes së barabartë të çështjeve mes gjyqtarëve të së njëjtit seksion, si dhe caktimit rastësor të gjyqtarëve. Procedura e ndarjes së çështjeve me short manual dokumentohet në procesverbal dhe publikohet në faqen e internetit të gjykatës. Në çdo rast një kopje e procesverbalit të dokumentimit të procedurës së shortit manual bëhet pjesë e fashikullit të gjykimit.		
47.	03.09.2025	Kërkesë për informacion: Që prej vendimit të parë të GJKKO të shkallës së parë sa vendime pranimit të kërkesave të Prokurorisë së Posaçme janë marrë deri më tani? (Kërkesa për masa sigurie, dërgimi marrje në pyetje, kërkesa për letërporosi). Sa kërkesa të SPAK janë refuzuar nga GJKKO. Ju lutem na vini në dispozicion ndarjen e vendimeve sipas tipologjisë së kërkesave (Kërkesa për masa sigurie, dërgimi marrje në pyetje, kërkesa për letërporosi).	16.09.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 47, datë 03.09.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas ligjit nr. 119/2014, <i>“Për të drejtën e informimit”</i>, i ndryshuar, ju bëj me dije si më poshtë: Numri i kërkesave penale, masa sigurimi dhe ekzekutim letërporosie të shqyrtuara pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për periudhën kohore 2020 – Gusht 2025, është si në vijim. • Për vitin 2020 ka përfunduar shqyrtimi i: ➤ 56 kërkesave për caktim mase sigurimi; ➤ 32 kërkesave për verifikimin e kushteve	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

				dhe kritereve të caktimit të masës (marrje në pyetje); ➤ 21 kërkesave për vleftësimin e arrestit në flagrancë/ndalimit; ➤ 15 kërkesave për rivlerësimin e masës së sigurimit të vendosur nga gjykata jokompetente; ➤ 49 kërkesave për ekzekutim letërporosie; • Për vitin 2021 ka përfunduar shqyrtimi i: ➤ 40 kërkesave për caktim mase sigurimi; ➤ 45 kërkesave për verifikimin e kushteve dhe kritereve të caktimit të masës (marrje në pyetje); ➤ 16 kërkesave për vleftësimin e arrestit në flagrancë/ndalimit; ➤ 5 kërkesave për rivlerësimin e masës së sigurimit të vendosur nga gjykata jokompetente; ➤ 72 kërkesave për ekzekutim letërporosie; • Për vitin 2022 ka përfunduar shqyrtimi i: ➤ 36 kërkesave për caktim mase sigurimi; ➤ 43 kërkesave për verifikimin e kushteve dhe kritereve të caktimit të masës (marrje në pyetje);		
--	--	--	--	---	--	--

				➤ 11 kërkesave për vleftësimin e arrestit në flagrancë/ndalimit; ➤ 6 kërkesave për rivlerësimin e masës së sigurimit të vendosur nga gjykata jokompetente; ➤ 49 kërkesave për ekzekutim letërporosie; • Për vitin 2023 ka përfunduar shqyrtimi i: ➤ 49 kërkesave për caktim mase sigurimi; ➤ 67 kërkesave për verifikimin e kushteve dhe kritereve të caktimit të masës (marrje në pyetje); ➤ 12 kërkesave për vleftësimin e arrestit në flagrancë/ndalimit; ➤ 5 kërkesave për rivlerësimin e masës së sigurimit të vendosur nga gjykata jokompetente; ➤ 44 kërkesave për ekzekutim letërporosie; • Për vitin 2024 ka përfunduar shqyrtimi i: ➤ 47 kërkesave për caktim mase sigurimi; ➤ 91 kërkesave për verifikimin e kushteve dhe kritereve të caktimit të masës (marrje në pyetje); ➤ 11 kërkesave për vleftësimin e arrestit në flagrancë/ndalimit;	
--	--	--	--	---	--

				➤ 4 kërkesave për rivlerësimin e masës së sigurimit të vendosur nga gjykata jokompetente; ➤ 69 kërkesave për ekzekutim letërporosie; • Për vitin 2025 ka përfunduar shqyrtimi i: ➤ 27 kërkesave për caktim mase sigurimi; ➤ 48 kërkesave për verifikimin e kushteve dhe kritereve të caktimit të masës (marrje në pyetje); ➤ 12 kërkesave për vleftësimin e arrestit në flagrancë/ndalimit; ➤ 1 kërkesë për rivlerësimin e masës së sigurimit të vendosur nga gjykata jokompetente; ➤ 64 kërkesave për ekzekutim letërporosie; Në lidhje me kërkesën tuaj për numrin e vendimeve të pranimi të kërkesave të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për kërkesat penale të sipërcituara, fillimisht ju sqarojmë se: Në kërkesat penale me objekt “Verifikimin e kushteve dhe kritereve të caktimit të masës (marrje në pyetje)”, “Vleftësimin e arrestit në flagrancë / ndalimit” dhe “Rivlerësimin e masës së sigurimit të vendosur nga gjykata jokompetente”, gjykata në dispozitivin e		
--	--	--	--	---	--	--

				vendimit nuk shprehet për pranimin apo rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë. Me konkretisht, në kërkesat me objekt “Verifikimin e kushteve dhe kritereve të caktimit të masës (marrje në pyetje)”, gjykata në zbatim të nenit 248 të K.Pr.Penale merr në pyetje personin e arrestuar dhe më pas vendos sipas rastit për vazhdimin e zbatimit / zëvendësimin / revokimin e masë së sigurimit, të caktuar me vendimin e caktimit të masës së sigurimit. Në kërkesat me objekt “Vleftësimin e arrestit në flagrante apo ndalimit”, gjykata në zbatim të nenit 259 të K.Pr.Penale zhvillon seancën e vleftësimit dhe më pas vendos sipas rastit për vleftësimin e ligjshëm / të paligjshëm të arrestit në flagrancë apo ndalimit / caktimin e masës së sigurimit / moscaktimin e asnjë mase sigurimi personal. Në kërkesat me objekt “Rivlerësimin e masës së sigurimit të vendosur nga gjykata jokompetente”, gjykata në zbatim të nenit 88 të K.Pr.Penale rivlerëson masën e sigurimit të caktuar nga gjykata jokompetente dhe më pas vendos për caktimin e masës së sigurimit / moscaktimin e asnjë mase sigurimi personal / vazhdimin e masës së sigurimit të vendosur nga gjykata jokompetente. Ndërsa, sa i përket kërkesave me objekt		
--	--	--	--	---	--	--

				“Caktim mase sigurimi” dhe “Ekzekutim letërporosie”, ju bëjmë me dije se vendimmarrja e gjykatës mbi pranimin apo rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar nuk është e pasqyruar në asnjë prej statistikave të nxjerra nga kjo gjykatë pasi janë kërkesa që i përkasin fazës së hetimeve paraprake, duke mbajtur parasysh këtu faktin se faza e hetimeve për procedimet penale të regjistruara nga SPAK dhe që shqyrtohen pranë kësaj gjykate, zgjat në kohë, për shkak të kompleksitetit të këtyre procedimeve. Po ashtu, po ju dërgojmë edhe analizat vjetore të Gjykatës për vitet 2024, 2023, 2022 dhe 2021 (për vitin 2020, për shkak të pandemisë Covid-19 nuk është bërë analiza vjetore), ku mund të gjeni të dhëna statistikore, të cilat mund t’ju vijnë në ndihmë.		
48.	24.09.2025	Kërkesë për informacion: Në kuadër të një studimi, ju lutem kërkoj informacion numrin e “masave të sigurisë” të miratura nga GJKKO me kërkesë të SPAK, për periudhën Janar 2020 deri ne Dhjetor 2024.	06.10.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj, regjistruar me datë 24.09.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të kësaj gjykate, me numër rendor 48, sipas ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ku ju kërkon informacion mbi numrin e masave të sigurisë të miratuara nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO) me kërkesë të Prokurorisë së	Përfunduar (Kthyer përgjigja me shkresën nr. 4581 prot., datë 06.10.2025)	Nuk ka

		Informacioni kërkohet i ndarë specifikisht në “masat e sigurisë”: - Arrest me burg (numri total vit pas viti) - Arrest shtëpie (numri total vit pas viti) - Detyrim paraqitje (numri total vit pas viti). Duke ju falenderuar paraprakisht për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të një përgjigje me firmë dhe vule nga institucioni juaj.		Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për periudhën Janar 2020 – Dhjetor 2024, ju informojmë si më poshtë: - Për vitin 2020 nga GJKKO janë vendosur: ➤ 142 masa sigurimi personal me karakter shtrëngues “arrest në burg”; ➤ 43 masa sigurimi personal me karakter shtrëngues “arrest në shtëpi”; ➤ 67 masa sigurimi personal me karakter shtrëngues “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”; - Për vitin 2021 nga GJKKO janë vendosur: ➤ 179 masa sigurimi personal me karakter shtrëngues “arrest në burg”; ➤ 29 masa sigurimi personal me karakter shtrëngues “arrest në shtëpi”; ➤ 21 masa sigurimi personal me karakter shtrëngues “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”; - Për vitin 2022 nga GJKKO janë vendosur: ➤ 211 masa sigurimi personal me karakter shtrëngues “arrest në burg”; ➤ 37 masa sigurimi personal me karakter		
--	--	---	--	---	--	--

				shtrëngues “arrest në shtëpi”; ➤ 15 masa sigurimi personal me karakter shtrëngues “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore; 4. Për vitin 2023 nga GJKKO janë vendosur: ➤ 212 masa sigurimi personal me karakter shtrëngues “arrest në burg”; ➤ 51 masa sigurimi personal me karakter shtrëngues “arrest në shtëpi”; ➤ 41 masa sigurimi personal me karakter shtrëngues “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore; 5. Për vitin 2024 nga GJKKO janë vendosur: ➤ 262 masa sigurimi personal me karakter shtrëngues “arrest në burg”; ➤ 38 masa sigurimi personal me karakter shtrëngues “arrest në shtëpi”; ➤ 36 masa sigurimi personal me karakter shtrëngues “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore;		
49.	24.09.2025	Kërkesë për vënie në dispozicion të vendimit nr. 610, datë 30 tetor 2024, me kërkuar G.N dhe J.P.	25.09.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 49, datë 24.09.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së	Përfunduar (E-mail) (Refuzuar)	Nuk ka

				Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëj me dije si më poshtë: Procedimi penal në ngarkim të personave nën hetim G.N dhe J.P, për të cilët keni kërkuar vënien në dispozicion të vendimit nr. 610, datë 30.10.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, vijon të jetë në fazë hetimesh. Për këtë arsye, në referim të nenit 17, pika 2, gërma “b” e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “2. E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm: ... b) parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale”, refuzojmë kërkesën tuaj për t’ju vënë në dispozicion vendimin nr. 610, datë 30.10.2024 të kësaj gjykate, me kërkesë personat nën hetim G.N dhe J.P.		
50.	01.10.2025	Datë 01.10.2025 Kërkesë për vënie në dispozicion të: Vendimit datë 25 tetor 2024	06.10.2025	Përgjigja e datës 06.10.2025 Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 50, datë 01.10.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së	Përfunduar (E-mail) (Refuzuar)	Nuk ka

	me kërkues R.R, me objekt shuarjen e masës së sigurisë caktuar me vendimin nr. 89 datë 20.11.2022 dhe nr. 37 datë 20 prill 2023. Për çeshtjen në fjalë është dhënë vendim në themel në datën 18 tetor 2024. Datë 06.10.2025 Së pari ju falenderoj për pergjigjen shteruese! Së dyti, sqaroj se kërkesa ime për informacion, bazohet në një dispozitiv publik i cili gjendet në faqen e internetit të Gjykatës së Posaçme, si vijon me poshtë: NR. AKTI 424 NR. VENDIMI _ Gjykata Në kthim nga dhoma e këshillimit gjykata, Vendos: 1. Konstatimin e humbjes së fuqisë së paraburgimit, konkretisht të masës së		Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju informojmë si më poshtë: Në kërkesën tuaj ju keni kërkuar vënien në dispozicion të vendimit të datës 25 tetor 2024, me kërkues R.R, me objekt “Shuarjen e masës së sigurisë, caktuar me vendimin nr. 89, datë 20.11.2022 dhe nr. 37, datë 20.04.2023”. Fillimisht saktësojmë se, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me datë 25.10.2024 nuk është dhënë asnjë vendim penal, me kërkues R.R dhe objekt “Shuarjen e masës së sigurisë, caktuar me vendimin nr. 89, datë 20.11.2022 dhe nr. 37, datë 20.04.2023”, siç citoni ju në kërkesën tuaj. Me datë 24.10.2025 pranë kësaj gjykatë është shqyrtuar kërkesa me kërkues R.R, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “<u>Trafikimi i narkotikëve</u>” kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 283/a/1 dhe 28/4 të Kodit Penal, atribuar me datë 18.07.2023, me objekt “Konstatim i humbjes së fuqisë së paraburgimit”. Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë për		
--	---	--	---	--	--

	sigurimit “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale caktuar ndaj personit nën hetim R.R me vendimin Nr.89, datë 20.11.2022 dhe Nr.37, datë 20.04.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, për shkak të kalimit të afateve të paraburgimit gjatë hetimeve paraprake, lidhur me faktin penal të atribuar me urdhër “Për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale” mbajtur më datë 31.10.2022 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. 2. Vazhdimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, caktuar ndaj personit nën hetim R.R, me vendimin Nr.308, datë 20.07.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për “faktin e ri penal” të atribuar nga	Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin nr. 597, datë 24.10.2024, ka vendosur: 1. Konstatimin e humbjes së fuqisë së paraburgimi, konkretisht të masës së sigurimit “<i>Arrest në burg</i>”, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale caktuar ndaj personit nën hetim R.X.R, me Vendimin Nr. <u>308</u>, datë <u>21.07.2023</u> të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe zgjatuar me vendimin Nr. <u>439</u>, datë <u>16.07.2024</u> të kësaj Gjykate, për shkak të kalimit të afateve të paraburgimit gjatë hetimeve paraprake. 2. Bazuar në nenin 266 pika 1 të K.Pr.Penale caktimin ndaj personit nën hetim R.X.R, të masës së sigurimit personal “<i>Arrest në shtëpi</i>” parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale. 3. Detyrohet personi nën hetim R.X.R të mos largohet nga banesa e tij me adresë: ****. 4. Detyrimin e personit nën hetim R.X.R, të mos komunikojë me persona të tjerë me përjashtim të atyre që bashkëjetojnë me të. 5. Zbatimi dhe mbikëqyrja e kësaj mase të bëhet nga oficerët e policisë gjyqësore që		
--	---	---	--	--

		prokuroria më datë 18.07.2023, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Trafikimi i narkotikëve” kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 283/a/1 dhe 28/4 i K.Penal, afati i cili përfundon më datë 21.07.2024. 3. Ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në bashkëpunim me policinë gjyqësore për ekzekutimin e këtij vendimi. 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njofitmit të këtij vendimi. U shpall sot në Tiranë, më datë 25.10.2023 SEKRETARE GJYQËSORE		mbulojnë vendbanimin e personit nën hetim R.X.R. 6. Ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në bashkëpunim me policinë gjyqësore për ekzekutimin e këtij vendimi. 7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njofitmit të këtij vendimi. <u>* Theksojmë se në këtë procedim penal, për të cilin është dhënë vendimi i sipërcituar, shtetasi R.R është i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Trafikimi i narkotikëve” kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 283/a/1 dhe 28/4 të Kodit Penal, atribuar me datë 18.07.2023.</u> <u>Po ashtu, ju bëjmë me dije se ky procedim penal aktualisht vijon të jetë në fazë hetimesh.</u> Çështja penale që ju citoni në kërkesën tuaj për informacion, për të cilën GJKKO ka dhënë vendimin nr. 61, datë 18.10.2024 i përket një procedimi penal tjetër, i ndryshëm nga procedimi i sipërcituar. Me vendimin nr. 61, datë 18.10.2024		
--	--	---	--	---	--	--

		D.N Vendimi mban datën 25 tetor 2023. Duke kërkuar ndjesë për gabimin në kerkesen për informacion pasi është shënuar viti 2024. Sa me sipër, lutem të verifikoni edhe njëherë.		GJKKO, ndër të tjera, ka vendosur: 1. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit R.R, akuzuar për kryerjen e veprës penale “<u>Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje</u>”, e kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, në dëm të shtetasve/viktimave A.N, A.L (P.M), për episodet e faktit penal para ngjarjes së datës 01.11.2019, parashikuar nga neni 80, në lidhje me nenet 28/4 dhe 334/1, në referim të nenit 388, pika 1, shkronja d) të K.Pr.Penale, pasi nuk provohet që e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. 1.1 Deklarimin fajtor të të pandehurit R.R, për kryerjen e veprës penale “<u>Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje</u>”, e kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, në dëm të shtetasve/viktimave A.N, A.L (P.M), V.M (M.), G.M dhe A.M (M.), për episodet e faktit penal pas ngjarjes së datës 01.11.2019, parashikuar nga neni 80, në lidhje me nenet 28/4 dhe 334/1 të Kodit Penal, dhe në bazë të këtyre dispozitave dënimit e tij me 7 (shtatë) vite burgim. 1.2 Deklarimin fajtor të të pandehurit R.R, për kryerjen e veprës penale “<u>Grupi i strukturuar kriminal</u>”, parashikuar nga neni 333/a pg 2 i Kodit Penal, dhe në bazë të	
--	--	--	--	---	--

				kësaj dispozite dënimit e tij me 3 (tre) vite burgim. 1.3 Deklarimin fajtor të të pandehurit R.R, për kryerjen e veprës penale “<u>Shkatërrimi i pronës me eksploziv</u>”, (për faktin penal të ndodhur në datë 30.05.2020), parashikuar nga neni 152 pg 1 të Kodit Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim. 1.4 Deklarimin fajtor të të pandehurit R.R, për kryerjen e veprës penale “<u>Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit</u>”, parashikuar nga neni 278 pg 1 i Kodit Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me 5 (pesë) vite e 6 muaj, burgim. 1.5 Deklarimin fajtor të të pandehurit R.R, për kryerjen e veprës penale “<u>Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit</u>”, (për faktin penal të ndodhur në datë 19.04.2023), parashikuar nga neni 278 pg 1 i Kodit Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me 5 (pesë) vite burgim. 1.6 Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve i pandehuri R.R dënohet me një dënim të vetëm prej 9 (nëntë) vite burgim. 1.7 Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të		
--	--	--	--	--	--	--

				Procedurës Penale, të pandehurit R.R i ulet 1/3 e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 6 (gjashtë) vite burgim. 1.8 Llogaritja e dënimit fillon nga data e arrestimit, dhe dënimi me burgim nga i pandehuri R.R do të vuhet në një burg të sigurisë së lartë, në referim të parashikimeve të nenit 16, pika 1, shkronja a) të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”. Për sa më sipër, në referim të nenit 17, pika 2, gërma “b” e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “2. E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm: ... b) parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale”, refuzojmë kërkesën tuaj për t’ju vënë në dispozicion vendimin nr. 597, datë 24.10.2024 të kësaj gjykate, me kërkesë personin nën hetim R.R. Përgjigja e datës 10.10.2025 Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë si më poshtë: Me vendimin nr. 424, dt. 25.10.2023		
--	--	--	--	--	--	--

				Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur: 1. Konstatimin e humbjes së fuqisë së paraburgimi, konkretisht të masës së sigurimit “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale caktuar ndaj personit nën hetim R.R me Vendimet Nr. 89, datë 20.11.2022 dhe Nr. 37, datë 20.04.2023 të Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, për shkak të kalimit të afateve të paraburgimit gjatë hetimeve paraprake, lidhur faktin penale të atribuara më urdhër “Për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale” mbajtur më datë 31.10.2022 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. 2. Vazhdimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, caktuar ndaj personit nën hetim R.R, me vendimin Nr. 308, datë 21.07.2023 të Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për “faktin e ri penal” të atribuar nga prokuroria më datë 18.07.2023, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të <u>“Trafikimi i narkotikëve” kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të</u>	
--	--	--	--	--	--

				<u>strukturuar krimina l, parashikuar nga nenet 283/a/1 dhe 28/4 i Kodit Penal, afati i cili përfundon më më datë 21.07.2024.</u> 3. Ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar në bashkëpunim me policinë gjyqësore për ekzekutimin e këtij vendimi. 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimi në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin të Organizuar brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmeja e njoftimit të këtij vendimi. Ju bëjmë me dije se, në përmbajtjen e këtij vendimi janë parashtruar jo vetëm rrethanat e çështjes të procedimit penal, për të cilin është dhënë vendimi i themelit nr. 61, datë 18.10.2024, më të pandehur R.R, etj (cituar dispozitivi në përgjigjen e datës 06.10.2025), por edhe rrethanat e çështjes të procedimit penal të regjistruar për faktin e ri penal, të atribuar nga prokuroria më datë 18.07.2023, ku shtetasi R.R është i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “<i>Trafikimi i narkotikëve</i>”, kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 283/a/1 dhe 28/4 të K.Penal, duke përfshirë këtu edhe komunikime në aplikacionin “Sky ECC”.		
--	--	--	--	--	--	--

				Siç jeni informuar edhe në përgjigjen e datës 06.10.2025 ky procedim penal aktualisht vijon të jetë në fazë hetimesh paraprake. Për sa më sipër, në referim të nenit 17, pika 2, gërma “b” e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “2. <i>E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm: ... b) parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale</i>”, refuzojmë kërkesën tuaj për t’ju vënë në dispozicion vendimin nr. 424, datë 25.10.2024 të kësaj gjykate, me kërkuar personin nën hetim R.R.		
51.	10.10.2025	Kërkesë për informacion: • Numri i çështjeve për kontrabandë me migrantë për periudhën 2021–2025, sipas vitit. • Numri i çështjeve për kontrabandë me migrantë me vendim fajësie për periudhën 2021–2025, sipas vitit, përfshirë: • Numrin e rasteve dhe personave me dënim me burgim, sipas gjinisë dhe kombësisë;	21.10.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 51, datë 10.10.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju informojmë si më poshtë: I. Numri i vendimeve të dhëna nga GJKKO për periudhën 2021 – 2025 (deri aktualisht), për veprën penale “<i>Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve</i>”, parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal:	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		• Numrin e rasteve dhe personave me gjobë, sipas gjinisë dhe kombësisë; • Numrin e rasteve dhe personave me dënim të pezulluar, sipas gjinisë dhe kombësisë. • Numri i rasteve dhe personave me vendim pafajësie për kontrabandë me migrantë për periudhën 2021–2025, sipas vitit, gjinisë dhe kombësisë.		1. Për vitin 2021 janë dhënë 4 vendime (20 persona të gjykuar); 2. Për vitin 2022 janë dhënë 2 vendime (23 persona të gjykuar); 3. Për vitin 2023 janë dhënë 3 vendime (20 persona të gjykuar); 4. Për vitin 2024 janë dhënë 2 vendime (2 persona të gjykuar); 5. Për vitin 2025 (deri aktualisht) është dhënë 1 vendim (4 persona të gjykuar). II. Numri i personave të deklaruar fajtorë për veprën penale “<i>Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve</i>”, parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal, për periudhën 2021 – 2025 (deri aktualisht): 1. Për vitin 2021 janë deklaruar fajtor 19 persona dhe për 1 person është pushuar çështja dhe është caktuar masa mjekësore “Mjekim i detyrueshëm në një institucion mjekësor”. 2. Për vitin 2022 janë deklaruar fajtorë 19 persona; 3. Për vitin 2023 janë deklaruar fajtorë 19 persona; 4. Për vitin 2024 janë deklaruar fajtorë 2 persona; 5. Për vitin 2025 (deri aktualisht) janë	
--	--	---	--	--	--

				deklaruar fajtorë 4 persona. III. Numri i personave të dënuar me burgim për veprën penale “<i>Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve</i>”, parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal, sipas gjinisë dhe kombësisë: 1. Për vitin 2021 janë dënuar me burgim 18 meshkuj dhe 1 femër, të gjithë me kombësi shqiptare. 2. Për vitin 2022 janë dënuar me burgim 16 meshkuj dhe 1 femër, të gjithë me kombësi shqiptare. 3. Për vitin 2023 janë dënuar me burgim 17 meshkuj, nga të cilët 16 me kombësi shqiptare dhe 1 me kombësi egjiptiane; 4. Për vitin 2024 janë dënuar me burgim 2 meshkuj, të dy me kombësi shqiptare; 5. Për vitin 2025 (deri aktualisht) janë dënuar me burgim 4 meshkuj, nga të cilët 2 me kombësi turke, 1 me kombësi irakiane dhe 1 me kombësi egjiptiane. IV. Numri i personave të dënuar me burgim për veprën penale “<i>Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve</i>”, parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal, për të cilët është pezulluar ekzekutimi i dënimit me burgim, duke u vënë në provë, në	
--	--	--	--	---	--

				zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, sipas gjinisë dhe kombësisë: 1. Për vitin 2022 është pezulluar ekzekutimi i dënimit me burgim, duke u vënë në provë për 2 femra, të dyja me kombësi shqiptare; 2. Për vitin 2023 është pezulluar ekzekutimi i dënimit me burgim, duke u vënë në provë për 2 persona, nga të cilët 1 mashkull dhe 1 femër, të dy me kombësi shqiptare; Ndërsa për vitet 2021, 2024 dhe 2025 (deri aktualisht) nuk ka pasur raste të pezullimit të ekzekutimi të dënimit me burgim. V. Për periudhën kohore 2021 – 2025 (deri aktualisht) nuk ka pasur asnjë rast të dënimit me gjobë për veprën penale “<i>Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve</i>”, parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal. VI. Numri i personave të deklaruar të pafajshëm për veprën penale “<i>Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve</i>”, parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal, sipas gjinisë dhe kombësisë:		
--	--	--	--	--	--	--

				1. Për vitin 2022, janë deklaruar të pafajshëm 4 persona, nga të cilët 2 meshkuj dhe 2 femra, të gjithë me kombësi shqiptare. 2. Për vitin 2023, është deklaruar i pafajshëm 1 mashkull, me kombësi iraniane. Ndërsa për vitet 2021, 2024 dhe 2025 (deri aktualisht) nuk ka pasur persona të deklaruar të pafajshëm për veprën penale “<i>Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve</i>”, parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal.		
52.	15.10.2025	Kërkesë për informacion: Sa vendime janë disponuar gjatë pesë viteve të fundit për vepra penale të parashikuara në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale të cilat gjithashtu janë të lidhura me dëmtimin e mjedisit dhe çfarë është vendosur? Çfarë ka vendosur gjykata gjatë pesë viteve të fundit për vepra penale të parashikuara në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale të cilat gjithashtu janë të lidhura me dëmtimin e mjedisit dhe çfarë është vendosur? Cila është kohëzgjatja e	22.10.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 52, datë 15.10.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas ligjit nr. 119/2014, “<i>Për të drejtën e informimit</i>”, i ndryshuar, ju informojmë si më poshtë: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për periudhën kohore 2020 – 2025 (deri aktualisht) nuk ka dhënë asnjë vendim për veprat penale që lidhen me dëmtimin e mjedisit, të parashikuara në Kreun IV të Kodit Penal, nën titullin “<i>Vepra penale kundër mjedisit</i>”, konkretisht:	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		gjkimeve gjatë pesë viteve të fundit lidhur me këto vepra penale? Informacioni i mësipërm të paraqitet i individualizuar për çdo vit.		➤ “<i>Ndotja e ajrit, e ujërave dhe e tokës</i>”, parashikuar nga neni 201 i Kodit Penal; ➤ “<i>Menaxhimi i mbetjeve</i>”, parashikuar nga neni 201/a i Kodit Penal; ➤ “<i>Transportimi i mbetjeve</i>”, parashikuar nga neni 201/b i Kodit Penal; ➤ “<i>Aktivitetet e rrezikshme</i>”, parashikuar nga neni 201/c i Kodit Penal; ➤ “<i>Materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme</i>”, parashikuar nga neni 201/ç i Kodit Penal; ➤ “<i>Dëmtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër</i>”, parashikuar nga neni 202 i Kodit Penal; ➤ “<i>Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër</i>”, parashikuar nga neni 202/a i Kodit Penal; ➤ “<i>Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore</i>”, parashikuar nga neni 202/b i Kodit Penal; ➤ “<i>Substancat ozonholluese</i>”, parashikuar nga neni 203 i Kodit Penal; ➤ “<i>Peshkimi i ndaluar</i>”, parashikuar nga neni 204 i Kodit Penal; ➤ “<i>Prerja e paligjshme e pyjeve</i>”, parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal; ➤ “<i>Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë</i>”, parashikuar nga neni 206 i Kodit Penal; ➤ “<i>Shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor</i>”, parashikuar nga neni 206/a i Kodit Penal;	
--	--	---	--	--	--

				➤ “Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor”, parashikuar nga neni 206/b i Kodit Penal; ➤ “Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve”, parashikuar nga neni 207 i Kodit Penal; ➤ “Braktisja e kafshës të shoqërimit”, parashikuar nga neni 207/a i Kodit Penal; ➤ “Vrasja me dashje e kafshës së shoqërimit”, parashikuar nga neni 207/b i Kodit Penal; ➤ “Këqtrajtimi i kafshës”, parashikuar nga neni 207/c i Kodit Penal; ➤ “Ndeshjet ndërmjet kafshëve”, parashikuar nga neni 207/ç i Kodit Penal;		
53.	16.10.2025	Gjatë ndjekjes së seancave gjyqësore të çështjes “Plumbi i Artë”, ka rezultuar që në raste të shpeshta, seanca gjyqësore të mos zhvillohen. Shkak kryesor i “ngërçit” të krijuar për vijueshmërinë e seancave efektive, rezulton të jetë mungesa e avokatëve konkretisht për gjatë muajve: korrik, shtator dhe deri më 14 tetor nuk ka patur zhvillim të 8 seancave për të njëjtën arsye. Do të luteshim të kishim komentimin tuaj në mënyrë që raportimi jonë të jetë sa më i	27.10.2025	Datë 16.10.2025 Ju informojmë se kërkesa e dërguar nga ana juaj nëpërmjet email-it, me datë 15.10.2025, ora 17:06, në referim të nenit 11 të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, është regjistruar me datë 16.10.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të kësaj gjykate me numër rendor 53. Në referim të nenit 15, pika 1 të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj,	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

	saktë dhe afër së vërtetës. Çështjet për të cilat në kërkojmë qëndrimin tuaj janë: 1. A janë marrë masa nga ana juaj që zhvillimet e këtij procesi gjyqësor të vijnë normalisht? 2. Nëse po, lutemi të dimë cilat janë masat. 3. Në gjykimin tuaj çfarë masash paraprake mund të merreshin/merren nga trupa gjyqësore në mënyrë që procesi gjyqësor mos të pengohet për shkak të mungesës së avokatëve të pandehurve, qoftë kjo dhe për procese të tjera që janë në gjykim nga GJKKO. Duke ju falënderuar për ndihmën e dhënë në sqarimin e rrethanave të sipërcituara, na lejoni t'ju vëmë në dijeni nëse ne nuk marrim asnjë koment nga ana juaj, deri ditën e nesërme 16 tetor 2025, ne do e konsiderojmë këtë fakt se ju refuzoni të përgjigjeni gjetjeve tona.	<i>përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe.</i>”, ju komunikojmë se, pasi të shqyrtohet kërkesa juaj edhe nga trupi gjyqësor i çështjes penale për të cilën keni paraqitur kërkesën, do ju kthehet përgjigje brenda afatit ligjor të parashikuar nga ky nen. Datë 27.10.2025 Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 53, datë 16.10.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas ligjit nr. 119/2014, “<i>Për të drejtën e informimit</i>”, i ndryshuar, pas konsultimit me Kryetarin në Detyrë të kësaj gjykate, z. E.B dhe trupin gjyqësor që ka në shqyrtim çështjen penale në ngarkim të të pandehurve N.D etj., gjyqtarët, znj. E.T, z. A.A dhe z. B.S, ju informojmë si më poshtë: Sa i përket dy pyetjeve të para: 1. A janë marrë masa nga ana juaj që zhvillimet e procesit gjyqësor të çështjes “Plumbi i Artë” të vijnë normalisht? 2. Nëse po, lutemi të dimë cilat janë masat. Ju bëjmë me dije se, trupi gjyqësor që po shqyrton çështjen penale në ngarkim të të pandehurve N.D, etj... në mënyrë të	
--	---	---	--

				vazhdueshme ka marrë masa konkrete për të vijuar gjykimin normal të kësaj çështje, në rastet kur avokatët e të pandehurve nuk janë paraqitur apo janë larguar nga seanca gjyqësore, të tilla si: 1. Janë caktuar avokat kryesisht për të gjithë të pandehurit e kësaj dosje penale, me përjashtim të të pandehurit A.P, avokatët e zgjedhur të të cilit janë paraqitur rregullisht në gjykim; 2. Janë paralajmëruar avokatët e caktuar kryesisht nga gjykata, të cilët nuk janë paraqitur në gjykim, që në rast se nuk paraqiten në gjykim do të kërkohet marrja e masave nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë; 3. Janë vendosur gjopa ndaj avokatëve, të cilët në mënyrë të përsëritur nuk janë paraqitur në gjykim apo janë larguar nga seanca pa leje të gjykatës, duke u bërë kështu shkak për shtyrjen e seancave gjyqësore; 4. Janë pezulluar afatet e paraburgimit për të gjithë të pandehurit. Sa i përket pyetjes së tretë: 3. Në gjykimin tuaj çfarë masash paraprake mund të merreshin/merren nga trupa gjyqësore në mënyrë që procesi gjyqësor mos të pengohet për shkak të mungesës së	
--	--	--	--	---	--

				avokatëve të të pandehurve, qoftë kjo dhe për procese të tjera që janë në gjykim nga GJKKO. Masat që mund të merren nga gjykata në rastet kur avokatët nuk paraqiten në seancë gjyqësore, me qëllim që të mos pengohet zhvillimi i procesit gjyqësor janë të parashikuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, konkretisht në: Nenin 49, pika 5, 6 dhe 7 të K.Pr.Penale, ku parashikohet shprehimisht se: “5. Kur kërkohet prania e mbrojtësit dhe mbrojtësi i zgjedhur ose i caktuar nuk është siguruar, nuk është paraqitur ose e ka lënë mbrojtjen, gjykata ose prokurori zbaton paragrafin 4, të nenit 350, të këtij Kodi. Nëse mungesa e tij është e përligjur, gjykata ose prokurori mund të caktojnë si zëvendësues një mbrojtës tjetër, i cili ushtron të drejtat dhe merr përsipër detyrimet e mbrojtësit. 6. Mbrojtësi i caktuar mund të zëvendësohet vetëm për shkaqe të përligjura. Ai i pushon funksionet kur i pandehuri zgjedh mbrojtësin e tij. 7. Kur mbrojtja nuk mund të sigurohet sipas kësaj dispozite dhe pikës 3, të nenit 49, mbrojtja garantohet nga institucionet që administrojnë ndihmën juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi.”. Nenin 265, pika 1, gërma “b” të K.Pr.Penale, ku parashikohet shprehimisht	
--	--	--	--	--	--

				se: “1. Afatet e parashikuara nga neni 263 pezullohen me vendim të ankimueshëm të gjykatës:... b) për kohën që shqyrtimi gjyqësor është pezulluar ose shtyrë për shkak të mosparaqitjes ose të largimit të një a më shumë mbrojtësve, që lënë pa ndihmë një a më shumë të pandehur.”. Nenin 350, pika 4 të K.Pr.Penale, ku parashikohet shprehimisht se: “4. Kur mbrojtësi i njoftuar rregullisht nuk paraqitet në seancë dhe nuk ka pengesa që e përjashtojnë nga përgjegjësia për t’u paraqitur ose nëse mbrojtësi ikën nga seanca pa leje, gjykata mund të caktojë ndaj tij gjobë nga 5 000 deri në 100 000 lekë dhe mund ta urdhërojë të paguajë shpenzimet e seancës.”.		
54.	28.10.2025	Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të kopjeve të vendimeve: Kërkohet informacion i përditësuar lidhur me çështjet penale të regjistruara në kuadër të zgjedhjeve parlamentare të datës 11 Maj 2025, konkretisht: 1. Numrin e çështjeve të dërguara për gjykim pranë Gjykatës së Posaçme nga	06.11.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, protokolluar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me datë 27.10.2025, me nr. 4891 prot., regjistruar në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të kësaj Gjykate me datë 28.10.2025, me numër rendor 54, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, për sa ju përket dosjeve apo kërkesave penale të regjistruara pranë kësaj gjykate që lidhen me zgjedhjet parlamentare të datës 11 Maj 2025, në vijim të përgjigjes së mëparshme të dërguar nga	Përfunduar E-mail (Pranuar pjesërisht)	Nuk ka

		Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), që lidhen me veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, për të cilat gjykata juaj është kompetente, sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, deri në datën që mban kjo shkresë. 2. Të dhëna mbi ankimet e paraqitura nga subjektet e legjitimuara, ndaj vendimeve të SPAK-ut (p.sh., ankime ndaj vendimeve për mosfillimin e procedimit penal), të depozituara pranë gjykatës tuaj në lidhje me këto çështje deri në datën që mban kjo shkresë. 3. Informacion mbi fazën e shqyrtimit gjyqësor në të cilën ndodhen aktualisht këto çështje. Nëse gjykata është shprehur me vendime lidhur me këto çështje, të cilat nuk rezultojnë të jenë kthyer për hetime të mëtejshme tek SPAK, ju		ana jonë, ju bëjmë me dije si më poshtë: I. Aktualisht po shqyrtohet në themel dosja penale me nr. 112 regj.themeltar, datë regjistrimi 30.07.2025, që i përket procedimit penal nr. 60/1, të vitit 2025, me të pandehur: 1. P.B, i akuzuar për veprën penale “<i>Korrupsion aktiv në zgjedhje</i>”, e parashikuar nga nenet 328 i Kodit Penal 2. V.L, i akuzuar për veprën penale të “<i>Korrupsionit pasiv në zgjedhje</i>”, e parashikuar nga neni 328/b i Kodit Penal. Gjykimi i kësaj çështje po zhvillohet me procedurën e gjykimit të shkurtuar dhe ndodhet në fazën e paraqitjes së konkluzioneve përfundimtare nga ana e mbrojtjes. Seanca e rradhës është caktuar me datë 13.11.2025, ora 14:00. II. Po shqyrtohet në seancë paraprake dosja penale me nr. 159 regj.themeltar, datë regjistrimi 23.10.2025, që i përket procedimit penal nr. 49/1, të vitit 2025 (i ndarë nga procedimi penal nr. 49 i vitit 2025), me të pandehur: 1. K.Sh, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “<i>Korrupsioni aktiv në zgjedhje</i>”, parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal. Për këtë dosje akoma nuk është çelur	
--	--	---	--	---	--

		lutemi të na vihen në dispozicion fotokopje të anonimizuara të tyre (sa i takon identitetit të të pandehurve apo personave nën hetim).		shqyrtimi gjyqësor. Seanca e parë është caktuar me datë 11.11.2025, ora 09:30. III. Lidhur me kërkesat penale me objekt “<i>Ankim kundër vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal</i>”, parashikuar nga neni 291, pika 2 i K.Pr.Penale, të regjistruara pranë kësaj gjykate deri më datë 23.10.2025, për të cilat ka përfunduar shqyrtimi gjyqësor, ju bëjmë me dije se përveç vendimit për të cilin jeni informuar në përgjigjen tonë të datës 24.06.2025, rezulton se janë dhënë edhe 4 (katër) vendime, ku kallëzimet penale të ankuesve lidhen me zgjedhjet parlamentare të datës 11 Maj 2025. Nga këto vendime, në dy prej tyre është vendosur mospranimi i ankimit/rrëzimi i ankimit, ndërsa dy vendimet e tjera akoma nuk janë zbardhur nga ana e gjykatës. Sa i përket vënies në dispozicion të vendimeve mbi kërkesat penale me objekt “<i>Ankim kundër vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal</i>”, për të cilat gjykata ka vendosur mospranimin/rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal, gjykata mban të njëjtin qëndrim si në përgjigjen e datës 24.06.2025. Gjithashtu, sqarojmë se vendimi i gjykatës që ka vendosur mospranimin/rrëzimin e	
--	--	---	--	--	--

				ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal është një vendim i revokueshëm. Në rastet kur kallëzuesi paraqet para gjykatës të dhëna apo prova (burime të provave) të reja të afta për të përmbysuar situatën në favor të tij, gjykata mund të vendosë revokimin e vendimit të mosfillimit dhe të urdhërojë prokurorinë për regjistrimin e procedimit penal dhe kryerjen e hetimeve të nevojshme, pavarësisht se ka dhënë më parë vendim për mospranimin/rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal. Ky qëndrim mbështet edhe në praktikën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, konkretisht vendimeve nr. 801, datë 05.07.2022 dhe nr. 707, datë 23.06.2022. Në vendimin nr. 801, datë 05.07.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ndër të tjera arsyetohet: <i>13. Edhe përsa i përket aspektit ngushtësisht procedural, paraqitja e kallzimit (të njëjtë) prej kallzuesit K, para Prokurorit, në kushtet kur, ky i fundit, është prononcuar negativisht, dy herë, lidhur me kushtet (mungesën e kushteve, në thelb) e pranueshmërisë së</i>		
--	--	--	--	--	--	--

				<i>kallzimit të paraqitur, në funksion të verifikimit të rekuizitave të këtij kallzimi për të integruar cilësinë e njoftimit për veprën penale – notitia criminis – determinuese (prezenca e këtyre rekuizitave – thelbësisht e veprës penale) e aktivimit të regjistrimit, sipas përcaktimit të nenit 287/1, të K.Pr.Penale, të procedimit penal dhe fillimit të fazës së hetimeve paraprake, sikurse me të drejtë është prononcuar Prokurori (në vendimin e mosfillimit) dhe Gjykata e Apelit, konsiderohet në shkelje të përcaktimeve të nenit 329/c/1, të K.Pr.Penale, të cilat imponojnë, me pasojë papranueshmërie, verifikimin – zbulimin - e të dhënave, “provave”, të reja, pas vendimit të pushimit (mosfillimit, në rastin konkret) të çështjes, të cilat të jenë të afta për të treguar (bashkë me provat e administruara, më parë ose edhe të vetme), pabazueshmërinë e atij vendimi (të mosfillimit) në funksion të paraqitjes së kërkesës – para gjyqtarit të seancës paraprake – për revokimin e vendimit të pushimit – mosfillimit – të procedimit.</i> 14. Në terma të tjerë, kallzuesi, në kushtet e paraqitjes së kallzimit penal para	
--	--	--	--	---	--

				<i>Prokurorit dhe refuzimit të tij për ta regjistruar atë – për të mos filluar çështjen penale – vendim i cili, mbas (në eventualitetin) ankimit tek gjyqtari i seancës paraprake, ka marrë formë të prerë, nuk ka asnjë mundësi për të riparqitur atë kallzim (të njëjtin) pa paraqitur kërkesë tek ky i fundit – gjyqtari i seancës paraprake – për revokimin e vendimit të mosfillimit – në kushtet e përcaktuara rigorozisht në paragrafin e parë të nenit 329/c, të K.Pr.Penale – që implikojnë paraqitjen e detyrueshme të të dhënave apo të provave (burimeve të provave) të reja të afta për të përmbysur pozitivisht situatën provuese justifikuese të atij vendimi. Pamundësia e riparqitjes së një kallzimi, të papranuar për t'u regjistruar nga Prokurori, konfigurohet edhe në kushtet e verifikimit, sikurse në rastin konkret, të situatës procedurale që presupozon gjendjen jodefinitive (të gjësë së gjykuar) të gjykimit të procedimit lidhur me (vendimin) refuzimin e fillimit të procedimit - iterit procedural të trajtimit të tij – përse kohë që vetëm në kushtet e prezencës së një vendimi definitiv lidhur me këtë problematike,</i>	
--	--	--	--	--	--

				<i>mund të çmohet verifikimi i ndikueshmërisë së kushteve të reja të pretenduara mbi vendimin e mosfillimit, verifikim në kompetencë ekskluzive të gjyqtarit të seancës paraprake.</i> 15. Në situatën konkrete të verifikuar mbas paraqitjes, prej kallzuesit K., para Prokurorit, dy herë të të njëjtit kallzim, të refuzuar për të regjistruar, në të dy rastet, me verifikimin e formës së prerë të tyre, ky i fundit, në funksion të dhënies vlerë paraqitjes për herë të tretë, të këtij kallzimi para organit të procedimit penal – Prokurorit - dhe të aktivimit të tij për të filluar (regjistruar) çështjen penale, kishte detyrimin për t’u paraqitur para gjyqtarit të seancës paraprake, me të dhënat e reja të siguruara – për të kërkuar, mbi bazën e vlerës së tyre, revokimin e vendimit të Prokurorit për mosfillimin e procedimit dhe urdhërimin e këtij të fundit, prej Gjykatës, për të regjistruar procedimin penal. Në këto kushte, bazuar në nenin 17 pika 2, gërma “b” të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se: “2. E drejta e informimit kufizohet në rast se është e	
--	--	--	--	--	--

				<i>domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm: ... b) parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale.”, refuzojmë kërkesën tuaj për t’ju vënë në dispozicion vendimet e sipërcituara.</i>		
55.	03.11.2025	Kërkesë për informacion: Në redaksinë tonë janë adresuar shqetësime nga qytetarë që kërkojnë transparencë lidhur me komunikimet dhe kërkesat e tyre pranë institucionit tuaj. Në këtë kuadër, po ndjekim rastin e kërkesës së paraqitur nga z. Sh.S, e regjistruar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar më datë 28.10.2025, me objekt: “Kërkesë për lëshimin e një vërtetimi/dispozitivi të vendimit të datës 28.10.2025, ora 14:00.” Në bazë të dokumentacionit që disponojmë, kërkesa i është drejtuar z. E.B, Kryetar i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për	05.11.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 55, datë 03.11.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO), sipas ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju informojmë si më poshtë: Kërkuesi Sh.S me datë 29.10.2025 ka depozituar pranë gjykatës një kërkesë me lëndë “Kërkoj të lëshohet përmes një vërtetimi, dispozitivi i vendimit datë 28.10.2025, ora 14:00 të GJKKO-së”, protokolluar pranë kësaj gjykate me nr. 4937 prot., datë 29.10.2025. Ju informojmë se kërkesa e paraqitur nga z. Sh.S është një kërkesë e karakterit administrativ, së cilës do i kthehet përgjigje zyrtare nga ana e gjykatës brenda afateve ligjore. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se në zbatim të	Përfunduar E-mail	Nuk ka

		Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Do t'ju luteshim të na informoni, për qëllime informimi publik, nëse kjo kërkesë është shqyrtuar dhe në çfarë faze procedurale ndodhet aktualisht. Ky informacion do të përdoret vetëm për qëllime gazetareske dhe në respekt të plotë të ligjit “Për të drejtën e informimit”.		nenit 103, pika 1, 2 dhe 3 të K.Pr.Penale, ku nën titullin “Ndalimi i publikimit të aktit” parashikohet shprehimisht se: “1. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose dhe vetëm i përmbajtjes së tyre nëpërmjet shtypit ose informacionit masiv. 2. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve josekrete deri në përfundimin e hetimeve paraprake. 3. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve të shqyrtimit gjyqësor kur gjykimi bëhet me dyer të mbyllura. Ndalimi i publikimit hiqet kur plotësohen afatet e caktuara me ligj për arkivat e shtetit ose kur ka kaluar afati prej dhjetë vjetësh nga data që vendimi ka marrë formën e prerë, por me kusht që publikimi të jetë autorizuar nga Ministri i Drejtësisë.”, gjykata nuk i publikon në faqen zyrtare në internet dispozitivët e kërkesave penale me objekt “Ankim kundër vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal”, pasi janë kërkesa që i përkasin fazës së hetimeve paraprake dhe shqyrtohen nga gjykata në dhomë këshillimi, pra pa prezencën e palëve. Lidhur me këto kërkesa penale vendimmarrja e gjykatës ju komunikohet palëve zyrtarisht nëpërmjet komunikimit të vendimit përfundimtar me deftesë komunikimi, sapo këto vendime depozitohen të arsyetuara në	
--	--	--	--	---	--

				Kryesekretarinë e gjykatës, sipas parashikimit të nenit 386/2 të K.Pr.Penale. Përveç sa më sipër, në referim të nenit 291, pika 5 të K.Pr.Penale, i cili parashikon se: “Kundër vendimit palët mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit. Gjykata e apelit shqyrton ankimin në dhomë këshillimi brenda 30 ditëve nga data e marrjes së akteve.”, ju informojmë se afati i ankimit ndaj vendimeve të sipërcituara fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar. Ju komunikojmë se Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar garanton transparencë maksimale në çdo fazë të veprimtarisë së saj gjyqësore, si në raport me palët pjesëmarrëse në proces, ashtu edhe me publikun e gjerë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.		
56.	19.11.2025	Kërkesë për vënie në dispozicion kopje vendimi: Në bazë të ligjit nr. 119 dt. 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, neni 3, kërkojmë të na vendoset në dispozicion kopje e vendimit nr. 36, datë 09.10.2024, me	21.11.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 56, datë 19.11.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas ligjit nr. 119/2014, “<i>Për të drejtën e informimit</i>”, i ndryshuar dhe në zbatim të ligjit nr. 124, dt. 19.12.2024 “<i>Për mbrojtjen</i>	Përfunduar E-mail	Nuk ka

		kërkues “A...” sh.p.k. Në kushtet kur ka përfunduar hetimi lidhur me procedimin pasuror nr. 6 të vitit 2024, për pasuritë në zotërim të shtetasit O.B dhe familjarëve të tij, si dhe në faktin se me datë 18.11.2025 gjykata e deklaroi të pafajshëm shtetasin O.B për veprën penale pastrimi i produkteve të veprës penale, vlerësojmë se nuk ka ndonjë pengesë ligjore të vendoset në dispozicion.		<i>e të dhënave personale”, i cili ka hyrë në fuqi në muajin Shkurt të vitit 2025, për efekt të mbrojtjes së të dhënave personale, po ju dërgojmë të anonimizuar vendimin nr. 36, datë 09.10.2024, me kërkues “A...” sh.p.k.</i>		
57.	26.11.2025	Kërkesë për vënie në dispozicion kopje vendimi: Në bazë të ligjit nr.190 dt 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare,” neni 3, kërkojmë të informohemi dhe të na vihet në dispozicion dokumentet zyrtare, lidhur me një vendim të marë nga Gjykata e Krimeve të Rënda, kundër të pandehurit E. alias H.U. Kërkojmë nga ana juaj të na vihet në dispozicion një kopje e vendimit të dënimit të	27.11.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 57, datë 26.11.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në zbatim të ligjit nr. 119/2014, “<i>Për të drejtën e informimit</i>”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Pas verifikimeve të kryera në sistemin elektronik të kësaj gjykate dhe në Kryesekretarinë e gjykatës, rezulton se pranë kësaj gjykate nuk është dhënë asnjë vendim dënimi ndaj shtetasit E. alias H.U. Sa i përket procedimit penal nr. 85, të vitit	Përfunduar E-mail (Dërguar kërkesa Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë)	Nuk ka

		dhënë ndaj këtij personi E. alias H.U.		2019, të regjistruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda Tiranë, në ngarkim të shtetasit E.U, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “<i>Stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste</i>”, “<i>Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste</i>”, dhe “<i>Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit</i>”, të parashikuara nga nenet 232, 232/a dhe 278 të Kodit Penal, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda Tiranë, me vendimin e datës 18.12.2019 ka shpallur moskompetencën dhe i ka dërguar aktet Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në këto kushte, në zbatim të nenit 12, pika 2 të ligjit nr.119/2014, “<i>Për të drejtën e informimit</i>”, i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se: “<i>Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuar. Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar</i>”, kërkesa juaj për informacion i është dërguar ditën e sotme autoritetit publik kompetent, konkretisht Gjykatës së Shkallës së Parë të	
--	--	--	--	--	--

				Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Po ashtu, në referim të nenit 12, pika 3 të ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se: “Autoriteti publik, të cilit i është drejtuar kërkesa për informim, njofton kërkuuesin se kërkesa e tij i është dërguar një autoriteti tjetër, si dhe e informon atë për kontaktet e autoritetit ku është dërguar kërkesa.”, po ju dërgojmë email-in dhe numrin e telefonit të kontaktit për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Seksioni Penal, të publikuar në faqen zyrtare gjykata.gov.al. Email: info.penale@gjkata.gov.al Tel: +355 4 562 0109		
58.	02.12.2025	Kërkesë për informacion: Kërkojmë të informohemi nëse është ushtruar ankim ndaj vendimit: NR. 5/09 AKTI NR .7, datë 30.01.2023, me palë kërkuese Prokuroria e Posaçme, prokurorët E.N dhe E.K dhe subjekt A.I etj. Gjyqtari i çështjes është E.B.	02.12.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 58, datë 02.12.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Pas verifikimeve të kryera në Zyrën e Arkivës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, rezulton se ndaj vendimit nr. 7, dt. 30.01.2023 të kësaj gjykate, me objekt	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

				“Konfiskimin e pasurive të sekuestruara ndaj subjektit A.I dhe personave të tretë” nuk është ushtruar e drejta e ankimit nga palët. Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 13.04.2023.		
59.	09.12.2025	Kërkesë për informacion: Kërkoj informacion nga Gjykata e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar në lidhje me rastet kur GJKKO ka dhënë pafajësi për personat e dyshuar nga SPAK për kryerjen e veprave të ndryshme penale. Shifra më duhet nga periudha janar 2023-dhjetor 2025. Si dhe, nëse është e mundur të më vihen në dispozicion emrat e personave të dyshuar, të paraburgosur ose jo, ndaj të cilëve gjykata shpalli pafajësi në këtë periudhë. Do ju lutesha që statistikatat të ishin të ndara vit pas viti.	18.12.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 59, datë 09.12.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO), sipas ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, bashkëlidhur këtij email-i gjeni listën me emrat e personave të deklaruar të pafajshëm me vendimin nga kjo gjykatë, si dhe veprat penale për të cilat ata janë deklaruar të pafajshëm, për periudhën kohore Janar 2023 – 18 Dhjetor 2025.	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka
60.	09.12.2025	Kërkesë për informacion: 1. Sa çështje janë pushuar nga GJKKO, në totalin e të gjitha viteve (shifra të jetë edhe e	22.12.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 60, datë 09.12.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		ndarë sipas viteve përkatëse) 2. Sa çështje janë kthyer për plotësim provash, hetimesh, aktesh? 3. Cilat janë dosjet që janë pushuar hetimet apo është vendosur mosfillim?		Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO), sipas ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, dhe në zbatim të ligjit nr. 124, dt. 19.12.2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, bashkëlidhur këtij email-i gjeni informacionin e kërkuar. *Sqarim: Sa ju përket vendimeve për të cilat është shënuar vetëm numri i procedimit penal apo veprat penale, rezulton se nuk ka emra personash nën hetim të regjistruar, ndërsa për pjesën tjetër emrat janë anonimizuar për efekt të mbrojtjes së të dhënave personale, në zbatim të ligjit nr. 124, dt. 19.12.2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i cili ka hyrë në fuqi në muajin Shkurt të vitit 2025.		
61.	10.12.2025	Kërkesë për informacion: Në kuadër të Ligjit "Për të Drejtën e Informimit" kërkoj nga ana e institucionit tuaj informacionin si më poshtë: 1. Sa është numri i pasurive të sekuestruara (pasurive të përfituara nga korrupsioni) nga dhjetori 2019 e deri më sot? 2. Cilat jane qytetet ku janë sekuestruar/konfiskuar pasuritë e përfituara nga	18.12.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 61, datë 10.12.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO), sipas ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Në asnjë prej regjistrave fizikë apo elektronik të kësaj gjykate nuk rezultojnë të dhëna statistikore për: “Numrin e pasurive të sekuestruara, qytetet ku janë	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		korupsioni? 3. Në sa raste, gjykata nuk ka vendosur sekuestrimin e pasurive (të sjelle nga SPAKU) nga dhjetori 2019 e deri më sot? 4. Në sa raste është hequr masa e sekuestrimit të pasurive nga dhjetori 2019 e deri më sot? 5. Sa është numri i pasurive të konfiskuara (pasurive të përfituara nga korupsioni) nga dhjetori 2019 e deri më sot? Ju lutemi më bashkëngjisni vendimet e mësipërme.		sekuestruar/konfiskuar pasuritë, rastet që gjykata ka vendosur sekuestrimin e pasurive, rastet kur është hequr masa e sekuestrimit të pasurive dhe numri i pasurive të konfiskuara”, të specifikuara posaçërisht për pasuritë e përfituara nga veprat penale të korupsionit, siç citoni ju në kërkesën tuaj. Kjo gjykatë, gjatë analizës vjetore të punës, përpunon disa nga të dhënat e mësipërme, të ndara sipas objektit të kërkesave, konkretisht, sekuestro/konfiskime sipas ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, sekuestro/konfiskime sipas aktit normativ nr.1, datë 31.1.2020 “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizimit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”, sekuestro preventive (analiza e vitit 2024), konfiksime sipas vendimeve të themelit (analiza e vitit 2024), por pa i kategorizuar këto të dhënat për vepra penale specifike. Për sa më sipër, po ju dërgojmë analizat vjetore të punës të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korupsionin dhe Krimin e Organizuar për vitet 2021, 2022, 2023 dhe 2024, ku mund të gjeni të dhëna lidhur me pasuritë e		
--	--	---	--	--	--	--

				sekuestruara/konfiskuara me vendime të kësaj gjykate. (Për vitin 2020 për shkak të pandemisë Covid 2019 nuk është bërë analiza vjetore e punës, ndërsa për vitin 2025, analiza do të paraqitet në vitin 2026). Konkretisht të dhënat mbi pasuritë e sekuestruara/konfiskuara i gjeni: 1. Në faqet 53 – 56 të Analizës Vjetore të Punës për vitin 2021; 2. Në faqet 63 – 66 të Analizës Vjetore të Punës për vitin 2022; 3. Në faqet 44 – 49 të Analizës Vjetore të Punës për vitin 2023; 4. Në faqet 47 – 50 të Analizës Vjetore të Punës për vitin 2024;		
62.	18.12.2025	Kërkesë për kopje vendimi: Në bazë të ligjit nr. 119 dt. 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, neni 3, kërkojmë të na vendoset në dispozicion një kopje e vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar lidhur me kërkesën e Prokurorisë së Posaçme (SPAK), për konfiskimin e pasurive të	---	---	Në proces	---

		shtetasit E.M dhe personave të lidhur me të, që janë shoqëritë “Z...” sh.p.k., “L...” sh.p.k.” dhe 49% të kuotave të shoqërisë “M...” sh.p.k.; 8 apartamente në **** me sipërfaqe totale 592.38 m2; tre ngastra tokë-arë në ****, me sipërfaqe totale 10 mijë e 342 m2; truall dhe masiv pyjor në ****, secila pasuri me sipërfaqe 6026 m2; dy garazhe dhe një bodrum në ****; si dhe 9 automjete të markave të ndryshme. Të dhënat mund të dërgohen me CD me postë ose në variant të printuar ose me transferim elektronik (e-mail) sipas dëshirës suaj.				
63.	18.12.2025	Kërkesë për kopje vendimi: Kërkuesi J.M është duke u gjykuar në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në lidhje me procedimi penal nr. 287/2020. Ndërkohë në ngarkim të pasurive të tij dhe bashkëshortes është vendosur sekuestro preventive me vendim të Gjykatës së	23.12.2025	Ju informojmë se kërkesa e depozituar nga ana juaj pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me objekt “Kërkesë për vënie në dispozicion të një kopje të njehsuar me origjinalin të vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në çështjen penale/kërkesë për heqjen/revokimin e sekuestros mbi pasuritë në emër të shtetasit O.B dhe familjarëve të tij”, është protokolluar me nr. 5580	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		Posaçme të Shkallës së Parë. Me vendimin nr. 19, datë 03.05.2024 nga ana e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë është vendosur “sekuestrimi i pasurive në emër të subjektit nën hetim pasuror O.B dhe familjarëve të tij”. Nga disa media online, me burim B..., është publikuar përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në lidhje me revokimin e sekuestros mbi pasuritë në ngarkim të shtetasit O.B dhe familjarëve të tij. Me cilësinë e mbrojtësit të shtetasit J.M, kërkoj kopjen e vendimit mbi heqjen e sekuestros mbi pasuritë e shtetasit O.B dhe familjarëve të tij. Bazuar në nenin 11/b të ligjit nr. 55/2018 avokati ka të drejtë “të kërkojë të dhëna, shpjegime ose dokumente që kanë lidhje me çështjen ose klientët që përfaqësohen ose		protokolli, datë 16.12.2025. Gjithashtu, me datë 18.12.2025 kërkesa juaj është regjistruar me numër rendor 63, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar. Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë si më poshtë: Neni 13 i ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, parashikon shprehimisht se: “<i>Vendimi i gjykatës që vendos revokimin e sekuestrimit, sipas nenit 12/b, të këtij ligji, i përcillet Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, e cila njofton pronarin e pasurive të sekuestruara</i>”, duke përcaktuar qartë se vendimi i gjykatës i komunikohet Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, e cila më pas njofton pronarin e pasurive të sekuestruara. Gjithashtu, në nenin 28, pika 2 të po këtij ligji, parashikohet shprehimisht se: “2. <i>Vendimi i revokimit të masës së sekuestrimit</i>	
--	--	---	--	---	--

		<i>mbrohen prej tij, nga çdo institucion i administratës publike, gjykatat, prokuroritë, gjykatat e arbitrazhit, noterët, përmbaruesit, organet e Policisë së Shtetit, apo çdo ent tjetër publik ose subjekt privat, në përputhje me rregullat dhe afatet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi</i>". Bazuar në nenin 12 të ligjit nr. 55.2018 "Gjatë ushtrimit të profesionit të avokatit, çdo institucion i administratës publike, gjykatat, prokuroritë, gjykatat e arbitrazhit, noterët, përmbaruesit, organet e Policisë së Shtetit, apo çdo ent tjetër publik ose subjekt privat, janë të detyruara të plotësojnë kërkesat e ligjshme të avokatit në lidhje me: a) vënien në dispozicion të avokatit, brenda një afati të arsyeshëm, të informacioneve të kërkuara prej tij, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj të veçantë". Bazuar në nenin 3 të ligjit nr. 114/2014 "Për të drejtën e informimit", vendimi		<i>të pasurisë vihet në ekzekutim 15 ditë pas njoftimit të palëve të interesuara</i>". Për sa më sipër, shtetasi J.M apo ju, në cilësinë e mbrojtësit të tij, duke qenë se nuk jeni palë në proces, nuk legjitimoheni për të marrë kopje të njehsuar me origjinalin të vendimit nr. 36, datë 09.10.2024, me kërkesë "A..." sh.p.k, të dhënë kjo gjykatë. Në këto kushte, në zbatim të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 124, dt. 19.12.2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", për efekt të mbrojtjes së të dhënave personale, bashkëlidhur këtij email-i po ju dërgojmë të anonimizuar vendimin nr. 36, datë 09.10.2024, me kërkesë "A..." sh.p.k.		
--	--	---	--	--	--	--

		gjqësor i shpallur publikisht është publikuar në disa media, pra i është dhënë subjekteve të ndryshme të cilët kanë për objekt të veprimtarisë publikimin e të dhënave, për pasojë nuk ka pengesë për dhënien e vendimit kërkuesit. Bazuar në sa më lart, kërkohet vendosjen në dispozicion të një kopje të njehsuar me origjinalin të vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në çështjen penale/kërkesë për heqjen/revokimin e sekuestros mbi pasuritë në emër të shtetasit O.B dhe familjarëve të tij, duke marrë përsipër pagimin e shpenzimeve përkatëse.				
64.	29.12.2025	Kërkesë për kopje vendimi: Në bazë të ligjit nr. 119 dt. 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, neni 3, kërkohet të na vendoset në dispozicion një kopje e vendimit nr.422 datë	---	---	Në proces	---

		23.10.2023, për masën e sigurimit pasuror “Sekuestro preventive” të pasurive të të pandehurit P.Gj. Po ashtu, kërkojmë të na vendoset në dispozicion çdo vendim tjetër të disponuar nga Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë për sekuestrimin e pasurive të të pandehurit P.Gj (nëse ka). Sjellim në vëmendje se çështja është në gjykim dhe nuk ka cënim të sekretit hetimor, pasi palët në gjykim janë njohur me provat, që janë bërë publike dhe në seancat gjyqësore. Të dhënat mund të dërgohen me CD me postë ose në variant të printuar ose me transferim elektronik (e-mail) sipas dëshirës suaj.				
65.	29.12.2025	Kërkesë për informacion: Ju kontaktojmë në lidhje me një kërkesë për informacion mbi një çështje në gjykim. Duke parë kalendarin në lidhje me seancat gjyqësore, vumë re një seancë me gjyqtaren F.H, ku palët në	30.12.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 65, datë 29.12.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO), sipas ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		proces janë të pidentifikuar për publikun. Në vend që të shkruhet emrat, janë vetëm inicialet G. A S. Mund të na thoni cilët janë palët në këtë gjyq? Pse nuk janë të shënuar me emrat e tyre si të gjitha proceset e tjera? Cila është çështja që po shqyrtohet dhe çfarë vendimi është marrë?		me dije si më poshtë: Me datë 12.06.2024, pranë kësaj gjykatë është regjistruar me nr. 90 regjistri themeltar (aktualisht nr. 17 regjistri) kërkesa për pushim procedimi penal, e dërguar për kompetencë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, regjistruar për veprën penale “Shpërdorim detyrë”, e parashikuar nga neni 248 i K.Pr.Penale. Aktualisht, kjo kërkesë vijon të jetë në fazë hetimesh dhe akoma nuk është dhënë një vendim përfundimtar nga ana e gjykatës. Hetimet vijnë nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Në zbatim të nenit 329/b, pika 2 të K.Pr.Penale, i cili parashikon shprehimisht se: “Kërkesa shqyrtohet nga gjyqtari i seancës paraprake në seancë me dyer të mbyllura, në prani të palëve. ...”, si dhe faktit që kjo kërkesë ndodhet në fazë hetimesh, gjykata, përveç sa më sipër, nuk ka asnjë informacion tjetër për të ndarë me median dhe publikun lidhur me këtë kërkesë penale.		
66.	30.12.2025	Kërkesë për informacion në kuadër të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të	---	---	Në proces	---

		organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ligji (Anti-mafia) i ndryshuar. A janë zbatuar plotësisht dispozitat e këtij ligji? Në rast se ka hasur vështirësi, cilat kanë qenë ato? A mendoni që dispozitat e këtij ligji janë të plota dhe a ka nevojë për ndryshime/plotësime të këtij ligji? Nga ndryshimet e fundit që kanë ndodhur në vitin 2020, a janë nxjerrë në kohë të gjitha aktet nënligjore që parashikojnë nene në zbatim të këtij ligji? A është shtrirë zbatimi i këtij ligji dhe për rastet e palidhura me një procedim penal në rastin kur ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në indicie për veprat penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, “Trafikimi i narkotikëve”, “Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 283,				
--	--	--	--	--	--	--

		283/a, 284/a të Kodit Penal? A është shtrirë zbatimi i këtij ligji për rastet e palidhura me procedimin penal në çështjet kur ka pasur indicie për përfitim të paligjshëm pasuror për veprat penale të “Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë” neni 259 dhe 260 i Kodit Penal? Sa ka qenë numri i procedimeve penale për veprat penale të “Korrupsionit pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë” neni 259 dhe 260 të Kodit Penal? Po numri i dënimeve sa ka qenë? Çfarë ndikimi ka pasur ndryshimi i vitit 2017 tani që procedura për masat parandaluese rregullohet nga Kodi i Procedurës Penale, në				
--	--	---	--	--	--	--

		vend të Kodit të Procedurës Civile? A respektohen afatet kohore të nenit 23 për kohëzgjatjen e gjykimeve (3 muaj)? Sa është kohëzgjatja mesatare? A kanë qenë efektive ndryshimet e miratuara? Çfarë ka funksionuar, çfarë nuk ka funksionuar dhe pse? A kanë qenë të nevojshme këto ndryshime në ligj?				
--	--	--	--	--	--	--